



Konrad  
Adenauer  
Stiftung



Institute for Democracy  
Societas Civilis - Skopje

## MANUAL PËR ZGJEDHJET PRESIDENCALE NË REPUBLIKËN E MAQEDONISË 2014

edicioni i dytë i përditësuar

## MANUAL PËR ZGJEDHJET PRESIDENCALE NË REPUBLIKËN E MAQEDONISË 2014

edicioni i dytë i përditësuar

**POLITIKË**

# MANUAL PËR ZGJEDHJET PRESIDENCALE NË REPUBLIKËN E MAQEDONISË 2014

---

Ilina Mangova  
Jovan Bliznakovski  
Ivana Kiprijanovska

## Impresum

### Titulli:

Manual për zgjedhjet presidenciale në Republikën e Maqedonisë 2014

### Botues:

Fondacioni Konrad Adenauer në Republikën e Maqedonisë  
Instituti për Demokraci Societas Civilis - Shkup

### Autorë:

Ilina Mangova  
Jovan Bliznakovski  
Ivana Kiprijanovska

### Bashkërenditje:

Davor Pashoski

### Përktheu:

Blerina Starova Zllatku

### Dizajni dhe përgaditja:

Vinsent grafika

Publikimi mund të shkarkohet falas në:

<http://www.kas.de/macedonia>

<http://www.idscs.org.mk>

### Vërejtje:

Qëndrimet e prezantuara në këtë publikim nuk janë qëndrime të Fondacionit Konrad Adenauer dhe të Institutit për Demokraci "Societas Civilis", por janë pikëpamje personale të autorëve.

# Përmbatja:

|                                                                          |           |
|--------------------------------------------------------------------------|-----------|
| <b>1. Hyrje në zgjedhjet presidenciale të vitit 2014</b>                 | <b>8</b>  |
| Përgatitjet për Zgjedhjet Presidenciale                                  | 13        |
| Ndryshimet e fundit të legjislacionit zgjedhor                           | 15        |
| <b>2. Historiku i zgjedhjeve presidenciale në Maqedoni (1991 – 2009)</b> | <b>24</b> |
| Kiro Gligorov, Presidenti i parë i RM-së (1991-1999)                     | 25        |
| Boris Trajkovski, Presidenti i dytë i RM-së (1999-2004)                  | 26        |
| Branko Cërvenkovski, Presidenti i tretë i RM-së (2004-2009)              | 28        |
| Gjorge Ivanov, Presidenti i katërt i RM-së (2009-2014)                   | 29        |
| <b>3. Sistemi zgjedhor maqedonas për zgjedhjet presidenciale</b>         | <b>32</b> |
| Modeli zgjedhor për President                                            | 33        |
| Organet zgjedhore                                                        | 35        |
| E drejta dhe procedura për paraqitjen e kandidaturave për President      | 36        |
| Fushata zgjedhore                                                        | 38        |
| Roli i mjeteve të informimit publik                                      | 39        |
| Kufizime për funksionarët aktual                                         | 42        |
| Mandati i Presidentit                                                    | 43        |
| Monitorimi i zgjedhjeve                                                  | 45        |

|                                                                                                        |           |
|--------------------------------------------------------------------------------------------------------|-----------|
| <b>4. Pasqyra e kandidatëve për president</b>                                                          | <b>46</b> |
| Gjorge Ivanov                                                                                          | 47        |
| Iljaz Halimi                                                                                           | 48        |
| Stevo Pendarovski                                                                                      | 49        |
| Zoran Popovski                                                                                         | 50        |
| <b>5. Zgjedhjet presidenciale në Republikën e Maqedonisë 2014 - rezultatet, fushata dhe vlerësimet</b> | <b>52</b> |
| Lista e shkurtesave                                                                                    | 53        |
| Hyrje                                                                                                  | 54        |
| Fushata zgjedhore dhe financimi i kandidatëve për president                                            | 55        |
| Mediat                                                                                                 | 62        |
| Rezultatet e zgjedhjeve presidenciale                                                                  | 71        |
| Mbrojtja e të drejtës së zgjedhjes                                                                     | 74        |
| Vlerësimi i zgjedhjeve nga vëzhguesit                                                                  | 76        |
| Vlerësimi i zgjedhjeve nga partitë politike                                                            | 82        |
| Konkluzione                                                                                            | 87        |
| <b>6. Referenca</b>                                                                                    | <b>92</b> |



## **HYRJE NË ZGJEDHJET E PESTA PRESIDENCIALE NË REPUBLIKËN E MAQEDONISË**

### **HYRJE NË ZGJEDHJET E PESTA PRESIDENCIALE NË REPUBLIKËN E MAQEDONISË**

Më 13 prill të vitit 2014 do të mbahen zgjedhjet e përgjithshme presidenciale të pestat me radhë në Republikën e Maqedonisë. Për funksionin President të Republikës së Maqedonisë do të garojnë katër kandidatë: kandidati i partisë jashtëparlamentare Opsioni Qytetar për Maqedoni (OPQM/GROM) Zoran Popovski, kandidati i Partisë Demokratike Shqiptare (PDSH), e cila është në opozitë, Iljaz Halimi, kandidati i partisë opozitare të Lidhjes Socialdemokrate të Maqedonisë (LSDM), Stevo Pendarovski dhe Presidenti aktual i shtetit, si kandidat i partisë në pushtet VMRO-DPMNE, Gjorge Ivanov.

Zgjedhjet u shpallën më 1 shkurt të vitit 2014 kur Kryetari i Parlamentit, Trajko Veljanovski, në përputhje me autorizimet e tij kushtetuese dhe ligjore, e nënshkroi Vendimin për shpalljen e zgjedhjeve presidenciale. Sipas Vendimit, parashikohet që zgjedhjet të mbahen më 13 prill, ndërkaq rrethi i dytë eventual zgjedhor të mbahet dy javë më vonë – më 27 prill.<sup>1</sup> Votimi jashtë vendit, i cili mbahet në përfaqësitë diplomatike konsullore (PDK), është parashikuar të mbahet një ditë më herët, më 12 prill, varësisht nga përllogaritja e kohës në vendet përkatëse. Më 12 prill do të votojnë edhe personat e sëmure dhe të pamundur në shtëpitë e tyre, personat që e vuajnë dënimin me burgim apo të cilëve u është përcaktuar masa e paraburgimit në institucionet ndëshkuese-korrigjuese, personat të cilëve u është përcaktuar arrest shtëpiak në vendet ku e vuajnë masën e arrestit shtëpiak dhe personat e zhvendosur të brendshëm, të cilët votojnë në objektet kolektive ose në qendrat e pranimit. Në rast të mbajtjes së rrethit të dytë, këto kategori të zgjedhësve do të votojnë një ditë para mbajtjes së zgjedhjeve.

Procedura për mbledhjen e nënshkrimeve të pretendentëve për kandidatë presidencial filloi më 16 shkurt, ndërsa përfundoi më 2 mars. Mbështetje

<sup>1</sup> Vendim për shpalljen e zgjedhjes së Presidentit të Republikës së Maqedonisë nr. 08-608/1, 1 shkurt 2014 Shkup, i aksesshëm në: [http://www.sec.mk/index.php?option=com\\_content&view=article&id=214:resenie-za-izbor&catid=29&Itemid=1278&lang=mk](http://www.sec.mk/index.php?option=com_content&view=article&id=214:resenie-za-izbor&catid=29&Itemid=1278&lang=mk) (vizita e fundit: 13 mars 2014).

për kandidaturën e tij prej 10 000 nënshkrimeve të qytetarëve i pari e përmbushi anëtar i partisë jashtëparlamentare OPQM (GROM), Zoran Popovski, i cili më 17 mars përmes konferencës për shtyp e informoi publikun se procesi ka përfunduar me sukses.<sup>2</sup>

Presidenti aktual Gjorge Ivanov kandidaturën e tij po ashtu e siguroi përmes nënshkrimeve të qytetarëve. Ivanov këtë e bëri në 24 orët e fundit për mbledhjen e nënshkrimeve, në periudhën nga mbajtja e Konventës së partisë në pushtet VMRO-DPMNE më 1 mars, deri në përfundimin e afatit, më 2 mars. Presidenti aktual arriti të mbledhë më shumë se 60 000 nënshkrime për mbështetjen e kandidaturës së tij.<sup>3</sup> Paraprakisht, Ivanov e siguroi mbështetjen nga shumica e delegatëve të Konventës së VMRO-DPMNE-së. Në Konventë kandidatura të tyre paraqitën edhe profesori universitar Jove Kekenovski, avokati Stavre Gjikov dhe magjistri i arkitekturës dhe ndërtimtarisë Bozhidar Noçev. Ivanovi e fitoi mbështetjen e 1099 nga gjithsej 1234 delegatët e pranishëm, ndërsa konkurenti i tij më i afërt Jove Kekenovski fitoi 124 vota nga delegatët.<sup>4</sup>

Iljaz Halimi, ish-deputet dhe ish-nënkryetar i Kuvendit, për kandidat u promovua në konferencën për shtyp të PDSH-së më 26 shkurt,<sup>5</sup> ndërkaq nënshkrimet e nevojshme arriti t'i sigurojë deri më 1 mars.<sup>6</sup>

Në garë, për mbledhjen e nënshkrimeve për kandidaturë, hyri edhe kandidatja e pavarur Biljana Vankovska, profesoreshë universitare, si dhe kryetari i partisë jashtëparlamentare "Dinjiteti" ("Dostoinstvo"), Stojance

Angelov. Vankovska dhe Angelov-i nuk arritën t'i sigurojnë nënshkrimet e nevojshme brenda afatit të parashikuar. Profesoresha universitare fushatën e saj e zhvilloi kryesisht në hapësirën e Internetit dhe përmes rrjeteve sociale, prej ku akuzoi për një sërë jokonsekuecash në procesin, para së gjithash për pa përgatitjen e Komisionit Shtetëror të Zgjedhjeve (KSHZ) për organizimin e një procesi të këtillë, presion nga partitë e tjera politike mbi qytetarët dhe monopolizimin e njësive rajonale të KSHZ-së në ditën e fundit të grumbullimit të nënshkrimeve nga ana e aktivistëve të VMRO-DPMNE-së të cilët në mënyrë masive dolën t'i japin mbështetje Presidentit aktual Gjorge Ivanov.

Në garën presidenciale i fundit hyri kandidati i partisë më të madhe opozitare LSDM, Stevo Pendarovski, i cili u zgjodh në Kongresin partiak të mbajtur më datë 4 mars të vitit 2014. Kandidatura e tij u mbështet me nënshkrimin e 30 deputetëve të Kuvendit të Republikës së Maqedonisë, anëtarë të grupit parlamentar të LSDM-së dhe koalicionit. Në Kongres, Pendarovski ishte kandidati i vetëm i nominuar dhe si i këtillë u votua unanimisht nga gjithsej 588 delegatët e pranishëm.<sup>7</sup>

Dy partitë më të mëdha zgjodhën mënyra të ndryshme për nominimin e kandidatëve presidencial, ndërkaq zgjedhja u bë në kuadër të organeve më të mëdha të të dyja partive - VMRO-DPMNE këtë e bëri në Konventën në të cilën morën pjesë 1234 delegatë, ndërkaq LSDM në Kongres me 588 delegatë të organizatave komunale. Tek VMRO-DPMNE-ja nominimi i kandidatëve zhvillohej sipas parimit të vet nominimit të kandidatëve (paraqitjes së kandidaturave), ndërsa tek LSDM-ja propozimet për kandidatë i paraqisnin degët komunale të partisë, ndërsa Këshilli Ekzekutiv, në bazë të propozimeve të paraqitura, i përcaktoi kandidatët.

<sup>2</sup> Janë mbledhur 10.000 nënshkrime për kandidaturën e Zoran Popovski-t, TV "Telma", 17.02.2014, i aksesshëm në: <http://www.telma.com.mk/index.php?task=content&cat=1&rub=15&item=35041> (vizita e fundit: 10 mars 2014).

<sup>3</sup> Gjithsej 63.253 nënshkrime për Ivanov-in, "Telegraf", 04.03.2014, i aksesshëm në: <http://www.telegraf.mk/aktuelno/114187-vkupno-63-253-potpisi-za-ivanov> (vizita e fundit: 13 mars 2014).

<sup>4</sup> Gjorge Ivanov zgjidhet kandidat për President të Republikës së Maqedonisë nga VMRO-DPMNE, Ueb-faqja e VMRO-DPMNE-së, 01.03.2014, i aksesshëm në: <http://vmro-dpmne.org.mk/?p=21701> (vizita e fundit 13 mars 2014)

<sup>5</sup> Iljaz Halimi kandidat për President i PDSH-së, TV "Alfa", 26.02.2014, i aksesshëm në: <http://www.alfa.mk/News.aspx?ID=72039#.UxXuTM51DiA> (vizita e fundit: 10 mars 2014)

<sup>6</sup> PDSH e mblodhi numrin e nevojshëm të nënshkrimeve për Iljaz Halimin, TV "Telma", 01.03.2014, i aksesshëm në: <http://telma.com.mk/index.php?task=content&cat=1&rub=15&item=35438> (vizita e fundit: 10 mars 2014)

<sup>7</sup> Pendarovski zyrtarisht kandidat presidencial i LSDM-së, "Dojçe Vele" servisi në gjuhën maqedonase, 05.03.2014, i aksesshëm në: <http://www.dw.de/%D0%BF%D0%B5%D0%BD%D0%B4%D0%B0%D1%80%D0%BE%D0%B2%D1%81%D0%BA%D0%B8-%D0%BE%D1%84%D0%B8%D1%86%D0%B8%D1%98%D0%B0%D0%BB%D0%BD%D0%BE-%D0%BF%D1%80%D0%B5%D1%82%D1%81%D0%B5%D0%B4%D0%B0%D1%82%D0%B5%D0%BB%D1%81%D0%BA%D0%B8-%D0%BA%D0%B0%D0%BD%D0%B4%D0%B8%D0%B4%D0%B0%D1%82-%D0%BD%D0%B0-%D1%81%D0%B4%D1%81%D0%BC/a-17476530> (vizita e fundit: 10.03.2014).

Paraprakisht, partia më e madhe e shqiptarëve etnikë, Bashkimi Demokratik për Integrim (BDI), mori qëndrim para publikut se nuk do të promovojë kandidat të vetin për President dhe u angazhua për të a.q. "President konsensual", përkatësisht President të pranueshëm për të gjitha bashkësitë etnike në Maqedoni, i cili "do t'i përfaqësojë të gjithë qytetarët e Maqedonisë"<sup>8</sup>. Në këtë mënyrë, BDI-ja në periudhën parazgjedhore refuzoi ta jap mbështetjen për ndonjërin nga kandidatët e nominuar për President, përfshirë këtu edhe kandidatin e partnerit të koalicionit VMRO-DPMNE, Gjorge Ivanov.

Pasi që dy partnerët e koalicionit, VMRO-DPMNE dhe BDI, nuk arritën të gjejnë zgjidhje të përbashkët, sa i përket propozimit për "President konsensual" dhe pasi që tanimë u bë e qartë se VMRO-DPMNE do ta mbështesë Gjorge Ivanov për mandatin e dytë presidencial, grupi parlamentar i BDI-së më datë 1 mars në mënyrë formale në Kuvend ngriti nismë për shpërndarjen e Kuvendit dhe shpalljen e zgjedhjeve të parakohshme parlamentare.<sup>9</sup> Po atë ditë, në Konventën partiake për zgjedhjen e kandidatit presidencial, Kryeministri dhe Kryetari i VMRO-DPMNE-së, Nikolla Gruevski, para delegatëve, anëtarësisë dhe publikut të gjerë kumtoi se VMRO-DPMNE-ja e pranon propozimin e BDI-së dhe rrjedhimisht me këtë në Maqedoni do të mbahen zgjedhje të parakohshme parlamentare.<sup>10</sup>

Si rrjedhojë e këtyre ngjarjeve, më 5 mars të vitit 2014, Kuvendi i Republikës së Maqedonisë u vet-shpërnda, ndërkaq zgjedhjet e parakohshme parlamentare u caktuan për 27 prill, në ditën e njëjtë, me rrethin e dytë eventuale, të zgjedhjeve presidenciale. Kuvendi u shpërnda unanimisht me

<sup>8</sup> Deklarata e Sekretarit të Përgjithshëm të BDI-së, Abdylaqim Ademi: BDI decid: "President konsensual i shtetit", "24 Vesti", 09.01.2014, i aksesshëm në: <http://24vesti.mk/dui-decidni-konsenzualen-pretседател-na-drzhavata> (vizita e fundit: 10 mars 2014).

<sup>9</sup> BDI paraqiti propozim për zgjedhje të parakohshme, "Dojçe Vele" servisi në gjuhën maqedonase, 01.03.2014, i aksesshëm në: <http://www.dw.de/%D0%B4%D1%83%D0%B8-%D0%BF%D0%BE%D0%B4%D0%BD%D0%B5%D1%81%D0%B5-%D0%BF%D1%80%D0%B5%D0%B4%D0%BB%D0%BE%D0%B3-%D0%B7%D0%B0-%D0%BF%D1%80%D0%B5%D0%B4%D0%B2%D1%80%D0%B5%D0%BC%D0%B5%D0%BD%D0%B8-%D0%B8%D0%B7%D0%B1%D0%BE%D1%80%D0%B8/a-17466769> (vizita e fundit: 10 mars 2014).

<sup>10</sup> VMRO-DPMNE shkon në zgjedhje të parakohshme parlamentare, "Radio Evropa e Lirë" në gjuhën maqedonase, 04.03.2014, i aksesshëm në: <http://www.makdenes.org/archive/news/20140301/428/428.html?id=25281463> (vizita e fundit: 10 mars 2014).

117 vota "PRO" nga 117 deputetë të pranishëm. Së këtejmi, më 27 prill të vitit 2014, në Maqedoni do të mbahen zgjedhje parlamentare, të tetat me radhë, prej të cilave këto janë zgjedhjet e treta të parakohshme me radhë.

Kandidatët presidencial kandidaturat e tyre formale i paraqitën në KSHZ në afatin e parashikuar prej 30 ditësh para mbajtjes së zgjedhjeve – Zoran Popovski, Iljaz Halimi dhe Gjorge Ivanov këtë e bënë më 12 mars, ndërkaq Stevo Pendarovski këtë e bëri një ditë më vonë, më 13 mars.

## PËRGATITJET PËR ZGJEDHJET PRESIDENCIALE

Më 3 mars Komisioni Shtetëror i Zgjedhjeve (KSHZ)<sup>11</sup> e miratoi Kalendarin e afateve për kryerjen e veprimeve zgjedhore për zbatimin e zgjedhjeve për President.<sup>12</sup> Në vazhdimësi KSHZ-ja i plotëson komisionet komunale të zgjedhjeve (KKZ) me anëtarë në vendet e atyre të cilëve u ka pushuar mandati ose ka pasur kërkesa për shkarkim. Sipas Kalendarit të afateve KKZ-ja duhet t'i formojë këshillat zgjedhorë (KZ) më së voni deri më 22 shkurt të vitit 2014, ndërkaq deri në këtë termin KSHZ-ja duhet t'i formojë edhe KZ në PDK-të.

Këqyrja publike e Listës së Zgjedhësve në njësitë rajonale të KSHZ-së, në ueb-faqen <http://izbirackispisok.gov.mk/>, si dhe në PDK-të (për votim jashtë vendit) u hap në periudhën prej 16 shkurtit – deri më 7 mars të vitit 2014. Ata qytetarë të cilët brenda kësaj periudhe kohore do të konstatojnë se nuk figurojnë në Listën e Zgjedhësve, ndërkaq i plotësojnë kushtet për të drejtën e votës, mund të kërkojnë që të regjistrohen. Në periudhën nga shpallja e zgjedhjeve deri në përfundimin e këqyrjes publike të Listës së Zgjedhësve, shtetasit e Republikës së Maqedonisë të cilët jetojnë jashtë vendit dhe të cilët i plotësojnë kushtet për votim jashtë vendit mund të paraqiten që ta realizojnë këtë të drejtë të tyre.

<sup>11</sup> Për më shumë informacione në lidhje me organet zgjedhore, shih Kapitullin 3 – Sistemi zgjedhor i Maqedonisë për zgjedhje presidenciale, Kreu Organet zgjedhore.

<sup>12</sup> Kalendar i afateve për kryerjen e veprimeve zgjedhore për zbatimin e zgjedhjeve për President të Republikës së Maqedonisë, Komisioni Shtetëror i Zgjedhjeve, 13 prill 2014, i aksesshëm në: <http://sec.mk/images/izbori2014/rokovnik.pdf> (vizita e fundit: 10 mars 2014).



Sipas afateve të përcaktuara ligjore dhe sipas Kalendarit të afateve të KSHZ-së, për zbatimin e Zgjedhjeve Presidenciale 2014, fushata zgjedhore për këto zgjedhje zgjatë nga 24 marsi deri më 11 prill të vitit 2014.

Sipas Kalendarit të afateve, raportet financiare të organizatorëve të fushatës zgjedhore deri te KSHZ-ja, Enti Shtetëror i Revizionit (ESHR) dhe deri te Komisioni Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit (KSHPK), paraqiten në afatet si vijojnë:

- më 3 prill për të ardhurat dhe shpenzimet në 10 ditët e para të fushatës;
- më 12 prill nëse nuk mbahet rrethi i dytë i votimit ose më 26 prill nëse mbahet rrethi i dytë, për të ardhurat dhe shpenzimet nga pjesa e dytë e fushatës zgjedhore;
- raportet finale financiare paraqiten deri më 11 maj në rast se zgjedhjet mbahen vetëm me një rreth, ose deri më 25 maj në rast se mbahet edhe rrethi i dytë (deri më 30 ditë pas përfundimit të zgjedhjeve).

Nga 4 marsi, filloi periudha e parashikuar me nenin 8-a të Kodit Zgjedhor gjatë së cilës nuk mund të paguhen subvencione të cilat nuk janë pagesa të rregullta mujore, e as të mbahen ngjarje publike me rastin e fillimit të ndërtimit ose lëshimit në përdorim të objektit ose të infrastrukturës të financuar me mjete nga Buxheti, nga fondet publike, si dhe nga mjetet e ndërmarrjeve publike me kapital shtetëror.

Në përputhje me Kalendarin e afateve, kërkesat për monitorimin e zgjedhjeve nga vëzhgues të brendshëm dhe të jashtëm mund të paraqiten në periudhën kohore nga 1 shkurti deri më 2 prill të vitit 2014.

## NDRYSHIMET E FUNDIT TË LEGJISLACIONIT ZGJEDHOR<sup>13</sup>

Në takimin e zhvilluar ndërmjet Qeverisë dhe përfaqësuesve të partive politike, i cili u mbajt më 15 janar të vitit 2014, u arrit marrëveshje për ndryshime në Kodin Zgjedhor me të cilat do të inkorporohen vërejtjet e raporteve monitoruese të OSBE/ODIHR<sup>14</sup> dhe të opozitës. Ndryshimet e Kodit Zgjedhor u miratuan me procedurë të shkurtuar më 23 janar të vitit 2014 me mbështetjen e të gjitha partive politike, me përjashtim të PDSH-së. Ndryshimet u referoheshin të gjitha vërejtjeve kryesore të kuadrit normativ zgjedhor, me përjashtim të sistemit zgjedhor për votim dhe shpërndarjen e mandateve në njësitë zgjedhore jashtë vendit. Partitë politike për këtë çështje nuk arritën marrëveshje dhe prandaj ranë dakord që e njëjta të zgjidhet para zgjedhjeve të ardhshme parlamentare. Ndryshimet dhe plotësimet e Kodit Zgjedhor kanë të bëjnë me aspektet esenciale të procesit zgjedhor, si vijojnë:

### I Ndarja e shtetit nga partia

Me ndryshimet e sërishme<sup>15</sup> të nenit 8-à precizohet se nga dita e miratimit të vendimit për shpalljen e zgjedhjeve deri në përfundimin e zgjedhjes së Presidentit të Republikës së Maqedonisë (kjo ka të bëjë edhe me zgjedhjet e tjera), nuk mund:

“- të disponohet me mjete buxhetore të Republikës së Maqedonisë, mjete të buxheteve të komunave dhe Qytetit të Shkupit, fondeve publike, ndërmarrjeve publike, institucioneve publike ose personave juridikë të cilët kanë në dispozicion kapital shtetëror;

<sup>13</sup> Ligji për ndryshimin dhe plotësimin e Kodit Zgjedhor, "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë 14/2014. I aksesshëm në <http://www.pravo.org.mk/documentDetail.php?id=665> (vizita e fundit: 15 shkurt 2014).

<sup>14</sup> OSBE Zyra për Institucione Demokratike dhe të Drejtat e Njeriut. Republika e Maqedonisë, Zgjedhjet Lokale 24 mars dhe 7 prill 2013, Raporti Përfundimtar, Varshavë 9 korrik 2013. I aksesshëm në: <http://www.osce.org/mk/odihr/elections/103832> (vizita e fundit: 15 shkurt 2014).

<sup>15</sup> Paraprakisht, me ndryshimet e Ligjit të miratuara në muajin nëntor të vitit 2012 dhe shkurt të vitit 2013 u adresuan një pjesë e vërejtjeve të OSBE/ODIHR. Ligji për ndryshimin dhe plotësimin e Kodit Zgjedhor, "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 142/2012 dhe Ligji për plotësimin e Kodit Zgjedhor "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 31/2013.

-të fillojnë ndërtime me mjete të Buxhetit ose të fondeve publike, ndërmarrjeve publike dhe personave të tjerë juridikë të cilët kanë në dispozicion kapital shtetëror, të objekteve të reja në infrastrukturë, siç janë: rrugë, ujësjellës, linja të tensionit të lartë, kanalizime, fusha sporti dhe objekte të tjera ose objekte për veprimtari shoqërore-shkolla, kopshte dhe objekte të tjera, përveç nëse për këtë dedikim paraprakisht janë siguruar mjete nga Buxheti, përkatësisht bëhet fjalë për realizim të programit të miratuar në bazë të ligjit në vitin rrjedhës; dhe

-të bëhen pagesa të pagave, pensione, asistencës sociale ose pagesave të tjera dhe kompensimeve materiale me mjete buxhetore ose me mjete të fondeve publike, të cilat nuk janë pagesa të rregullta mujore, përkatësisht të gjitha transfertet dhe pagesat njëvjeçare ose transfertet e njëfishta me mjete buxhetore ose me mjete të fondeve publike dhe as të tjetërsohet kapitali shtetëror dhe as të nënshkruhen marrëveshje kolektive.”

Ndryshimi tjetër ka të bëjë me atë se në periudhën kohore 20 ditë para fillimit të fushatës zgjedhore dhe deri në përfundimin e zgjedhjeve nuk mund:

“- të paguhet subvencione të cilat nuk janë pagesa të rregullta mujore; dhe

- të mbahen ngjarje publike me rastin e fillimit të ndërtimit ose lëshimit në përdorim të objekteve me mjete nga Buxheti ose nga fondet publike, ose me mjete të ndërmarrjeve publike ose të personave të tjerë juridikë që kanë në dispozicion kapital shtetëror në infrastrukturë, siç janë: rrugë, ujësjellës, linja të tensionit të lartë, kanalizime, fusha sporti dhe objekte të tjera ose objekte për veprimtari shoqërore-shkolla, kopshte dhe objekte të tjera. Me ndalim të mbajtjes së ngjarjeve publike nuk nënkuptohet dhënia e deklaratës publike të bartësit të funksionit publik apo të kandidatit për bartës të funksionit publik në: miting, intervistë për media, debat në media ose përgjigje në pyetje gazetareske

Nga dita e miratimit të Vendimit për shpalljen e zgjedhjeve deri në përfundimin e zgjedhjes së Presidentit të Republikës së Maqedonisë (si edhe për zgjedhje të tjera), Ministria e Financave e ka për detyrë që të gjitha pagesat buxhetore, përveç pagave, pensione të rregullta dhe shpenzimeve komunale, t'i shpall publikisht në internet faqen në bazë të veçantë për shpenzime buxhetore në periudhën zgjedhore.

Ministria e Financave dy javë pas shpalljes së zgjedhjeve paraqet raport financiar parazgjedhor në të cilin do të përfshihet pasqyra e të gjitha të ardhurave dhe shpenzimeve të planifikuara dhe të realizuara nga Buxheti, sipas zërave, në periudhën nga fillimi i vitit fiskal deri ditën e paraqitjes së raportit i cili publikohet në ueb-faqen e Ministrisë së Financave.”<sup>16</sup>

Shkelja e këtyre rregullave penalizohet sipas Kodit Penal. Ministria e Financave i publikoi shpenzimet buxhetore në periudhën parazgjedhore dhe raportin financiar parazgjedhor në ueb-faqen e vet.<sup>17</sup>

## II Kundërshtime

Sa i përket vendimmarrjes për kundërshtimet, KSHZ-ja prej tani do të vendos vetëm në bazë të këqyrjes në materialin zgjedhor dhe në bazë të provave të tjera (neni 31 (2)), ndërsa është shlyer dispozita me të cilën KSHZ-ja kushtëzohej të pranojë së paku dy kundërshtime që të vendos sipas kundërshtimeve.

## III Organet e administratës zgjedhore

Sipas ndryshimeve të fundit, sa i përket organeve të administratës zgjedhore:

<sup>16</sup> Kodi Zgjedhor (Tekst i spastruar) “Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 32/2014.

<sup>17</sup> Ministria e Financave e Republikës së Maqedonisë, Raport financiar parazgjedhor, 17 shkurt 2014, i aksesshëm në: [http://www.finance.gov.mk/files/u12/Predizboren\\_finansiki\\_izvestaj.pdf](http://www.finance.gov.mk/files/u12/Predizboren_finansiki_izvestaj.pdf) (vizita e fundit: 13 mars 2014); Ministria e Financave e Republikës së Maqedonisë, shpenzime buxhetore në periudhën parazgjedhore, i aksesshëm në: <http://www.finance.gov.mk/trosoci> (vizita e fundit: 13 mars 2014).



- KSHZ-ja e ka për detyrë raportin e zgjedhjeve dhe pasqyrën financiare ta publikojë në Internet faqen e vet në afat prej 45 ditësh nga publikimi i rezultateve finale të zgjedhjeve.
- Anëtarët e këshillave zgjedhorë, të cilët emërohen me propozim të partive politike, mund të ndërrohen para të gjitha zgjedhjeve, përkatësisht partitë politike para të gjitha zgjedhjeve duhet të paraqesin propozime të reja për anëtarë të këshillave zgjedhorë dhe zëvendës të tyre.
- Janë bërë ndryshime në përbërjen e këshillave zgjedhorë në përfaqësitë diplomatike konsullore, përkatësisht kryetari i KZ-së zgjidhet nga radhët e diplomatëve, të punësuar në PDK-në përkatëse, sipas zgjedhjes së rastësishme në kohëzgjatje prej katër vitesh, ndërkaq për zëvendësin e tij dhe për anëtarët e tjerë dhe zëvendësit e tyre vlejné kushtet e njëjta sikur për anëtarët dhe zëvendësit e anëtarëve në KZ-të në Republikën e Maqedonisë.
- KSHZ-ja e ka për detyrë që Listën e verifikuar unike të kandidatëve për zgjedhje të Presidentit të Republikës, në vend të 30 ditëve, ta publikojë më së voni 25 ditë para ditës së mbajtjes së zgjedhjeve në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë".
- Nëse në KSHZ paraqitet kundërshtim për shkeljen e dispozitave ligjore në lidhje me kohëzgjatjen dhe format e fushatës zgjedhore, tani KSHZ-ja e ka për detyrë që të njëjtat t'i shqyrtojë dhe t'i procesuojë sipas kundërshtimit të paraqitur në afat prej 7 ditësh nga paraqitja e kundërshtimit.

#### IV Lista e Zgjedhësve

Me ndryshimet e fundit, përveç ekstrakteve të veçanta nga Lista e Zgjedhësve të cilët përpilohen për votim në PDK-të dhe në institucionet ndëshkuese-korrektuese, përpilohet edhe një ekstrakt i veçantë për

votim në Komisionin Shtetëror të Zgjedhjeve i cili shërben për votimin e anëtarëve të këshillave zgjedhorë për votim në PDK-të, përkatësisht në zyrat konsullore.

Ministria e Punëve të Brendshme dhe gjykatat themelore të cilat e kishin për detyrë që dy herë brenda vitit të paraqesin të dhëna pranë KSHZ-së për evidencën në Listën e Zgjedhësve, me ndryshimet e kanë për detyrë që këtë ta bëjnë katër herë në vit brenda periudhës kohore nga 1 deri më 10 shkurt, nga 1 deri më 10 maj, nga 1 deri më 10 shtator dhe nga 1 deri më 10 dhjetor.

Qytetarët, të cilët gjatë periudhës së zgjedhjeve gjenden me punë të përkohshme ose me qëndrim të përkohshëm jashtë vendit, të cilët nuk kanë paraqitur kërkesë për votim në PDK tanimë nuk shënohen me yll në Listën e Zgjedhësve por regjistrohen në ekstrakte të veçanta në Listën e Zgjedhësve për votim në Republikën e Maqedonisë.

Është inkorporuar sistemi elektronik për kontrollin e identitetit personal të votuesit në vendin zgjedhor, ndërsa pas identifikimit në vend që të shënohet me spërkatës votuesi shënohet me bojë të dukshme në gisht.

Me ndryshimet, anëtarëve të këshillave zgjedhorë për votim në PDK-të u mundësohet të votojnë në Komisionin Shtetëror të Zgjedhjeve tri ditë para ditës së mbajtjes së zgjedhjeve në Republikën e Maqedonisë.

Periudha e këqyrjes publike në Listën e Zgjedhësve është zgjatur dhe tani është 20 ditë në vend të 15 ditëve.

Gjithashtu, partive politike u është dhënë e drejta të bëjnë këqyrje dhe të kenë mundësi të paraqesin kërkesa për regjistrim, plotësim ose shlyerje të të dhënave në Listën e Zgjedhësve pas përfundimit të këqyrjes publike. KSHZ-ja e ka për detyrë që Listën e Zgjedhësve tua dërgojë partive politike në afat prej 5 ditësh pas përfundimit të këqyrjes publike. Partitë politike, nga ana tjetër, kanë afat prej 5 ditësh të paraqesin kërkesa të këtilla,

ndërkaq nëse e bëjnë këtë, KSHZ-ja në afat prej 3 ditësh duhet të vendos për të njëjtat. Pas kësaj, rrjedhin afatet prej 24 orësh kur partitë politike mund të paraqesin padi kundër aktvendimeve të KSHZ-së, ndërkaq për to vendos Gjykata Administrative.

## V Kandidatët

Me ndryshimet e fundit, kandidatët lirohen nga nevoja që të paraqesin deklaratë me shkrim, të vërtetuar në noter, në përputhje me ligjin se nuk kanë bashkëpunuar me organet e sigurisë shtetërore.

Listat e kandidatëve për President të Republikës, si dhe listat e kandidatëve për zgjedhje të tjera, në vend të 35 ditëve para zgjedhjeve, tani përfaqësuesit e autorizuar të propozuesve i paraqesin në KSHZ ose në komision tjetër kompetent, më së voni 30 ditë para ditës së mbajtjes së zgjedhjeve.

## VI Prezantimi mediatik

Obligimi i Servisit publik radiodifuziv dhe shoqërive tregtare radiodifuzive që të raportojnë në mënyrë të drejtë, të balancuar dhe të paanshme, si dhe pjesëmarrësve në fushatën zgjedhore t'u mundësojnë kushte të barabarta për qasje në të gjitha format e prezantimit mediatik, është inkorporuar në Kodin Zgjedhor, në vend të asaj siç ishte deri më tani, kur i njëjti rregullohej me Rregulloren e Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizive (ish Këshilli për Radiodifuzion).

Ndryshimet parashikojnë edhe rregulla për shmangien e të qenit i privilegjuar të ndonjë subjekti politik gjatë raportimeve të aktiviteteve të rregullta të organeve shtetërore dhe komunale të cilat i bëjnë persona që janë përfaqësues ose janë emëruar nga ai subjekt politik. Gjithashtu, redaktorëve, gazetarëve, moderatorëve të programeve dhe prezantuesve iu pamundësohet pjesëmarrje në aktivitete parazgjedhore dhe në fushata parazgjedhore. Nëse këta persona vendosin të marrin pjesë në aktivitete të

këtilla, atëherë angazhimi i tyre në programet e radiodifuzerëve duhet të pezullohet përkohësisht.

Radiodifuzerëve u imponohet obligimi që ta regjistrojnë sinjalin dalës të programit të tyre nga dita e shpalljes së zgjedhjeve deri në përfundimin e tyre dhe të njëjtin ta ruajnë më së paku 30 ditë pas përfundimit të zgjedhjeve, si dhe t'ia dërgojnë Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizive nëse një gjë e këtillë kërkohet.

Në periudhën nga dita e shpalljes së zgjedhjeve deri në fillimin e fushatës zgjedhore, radiodifuzerëve dhe mediave të shkruara u ndalohet të transmetojnë, përkatësisht të publikojnë reklamim të paguar politik, përveç konkurseve dhe njoftimeve për mbledhjen e nënshkrimeve për mbështetjen e kandidaturës të grupit të zgjedhësve. Me ndryshimet e fundit, janë përcaktuar rregullat për mënyrën dhe formën e shpalljes së konkurseve dhe njoftimeve për mbledhjen e nënshkrimeve për mbështetjen e kandidaturës.

Nga dita e shpalljes së zgjedhjeve e deri në përfundimin e tyre, radiodifuzerët dhe mediat e shkruara nuk guxojnë të transmetojnë dhe publikojnë reklama të financuara nga Buxheti i Republikës së Maqedonisë, nga buxhetet e komunave dhe të Qytetit të Shkupit dhe nga të gjithë personat e tjerë të cilëve me ligj u është besuar ushtrimi i autorizimeve publike.

Përveç Komisionit Shtetëror të Zgjedhjeve dhe Entit Shtetëror të Revizionit, mediat e shkruara e kanë për detyrë që Listat e çmimeve për reklamim të paguar politik tua dërgojnë edhe Komisionit Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit, radiodifuzerëve, Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizive, Komisionit Shtetëror të Zgjedhjeve, Entit Shtetëror të Revizionit dhe Komisionit Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit.

Në vazhdim precizohet kohëzgjatja dhe balancimi i kohës në të cilën radiodifuzeri publik raporton për partitë politike në pushtet dhe për partitë politike në opozitë në programet informative, ndërsa koha që i jepet çdo partie shpërndahet në mënyrë proporcionale me rezultatet e zgjedhjeve

të fundit parlamentare. Në detaje përcaktohet kur, sipas cilës radhitje dhe në cilën masë difuzeri publik do të transmetojë prezantim politik falas të pjesëmarrësve në procesin zgjedhor. Së këtejmi, prezantimi politik falas duhet shënohet në mënyrë përkatëse dhe të dukshme si “prezantim politik falas” gjatë gjithë kohës së transmetimit. Njëkohësisht, servisi publik radiodifuziv e ka për detyrë që të sigurojë informim të rregullt për procesin zgjedhor edhe për personat me dëgjim të dëmtuar.

Gjatë kohës së heshtjes zgjedhore mediat nuk guxojnë të publikojnë, transmetojnë kurrfarë informatash, fotografi, materiale audio dhe audiovizive që kanë të bëjnë me pjesëmarrësit e zgjedhjeve ose në të cilat marrin pjesë pjesëmarrësit e zgjedhjeve, kurrfarë forma të raportimit mediatik, të cilat në mënyrë të hapur ose të kamufluar janë në funksion të fushatës zgjedhore të dikujt dhe mund të ndikojnë mbi vendimin e zgjedhësve, të dhëna me të cilat e zbulojnë identitetin e subjekteve politike dhe/ose të individëve të përfshirë në incidente ose në parregullsi të tjera në ditën e votimit, si dhe deklarata të kandidatëve në procesin zgjedhor, pjesëmarrësve në fushatën zgjedhore, përfaqësuesve të partive politike dhe të bartësve të funksioneve në organet e pushtetit.

Është shtuar dispozitë me të cilën rregullohet shpallja e rezultateve nga sondazhet e opinionit publik, të realizuara në ditën e zgjedhjeve, me të cilën specifikohet se rezultate të këtilla nuk guxon të publikohen para orës 19:00, përkatësisht para mbylljes së vendeve zgjedhore.

Me ndryshimet është specifikuar se programet e dedikuara për të miturit nuk guxojnë të shfrytëzohen për prezantim zgjedhor mediatik.

Po ashtu, janë inkorporuar edhe dispozita për kundërvajtje dhe gjoba për shkeljen e këtyre rregullave, në vend të kryeredaktorit dhe redaktorit përgjegjës, përgjegjësia për respektimin dhe zbatimin e dispozitave të Kodit Zgjedhor fokusohet mbi personin përgjegjës të radiodifuzerit ose të medias së shkruar.

## **VII Financimi i fushatës zgjedhore**

Lartësia e donacioneve, të cilën mund ta japin personat juridikë për financimin e fushatës zgjedhore, ndryshohet prej 5% nga të ardhurat e përgjithshme në vitin paraprak në shumë prej 50.000 euro në kundërvlerë me denarë.

Inkorporohet edhe një dispozitë për pjesëmarrësit në fushatën zgjedhore që një ditë para mbajtjes së rrethit të dytë të votimit të paraqesin raport financiar për të ardhurat dhe shpenzimet në llogarinë e transaksionit për fushatën zgjedhore për rrethin e dytë të votimit.

## **VIII Kufizimi i madhësisë së vendit zgjedhor**

Me ndryshimet e Kodit Zgjedhor u inkorporua kufizimi i numrit të votuesve të regjistruar në një vend zgjedhor, i njëjti nuk guxon të jetë më i madh se 1 000. Me këtë ndryshim u formuan 504 vende zgjedhore të reja, me ç’rast nga 2 976 numri i tyre u rrit në 3 480.

## HISTORIKU I ZGJEDHJEVE PRESIDENCIALE NË MAQEDONI (1991-2009)

### HISTORIKU I ZGJEDHJEVE PRESIDENCIALE NË MAQEDONI (1991-2009)<sup>18</sup>

Presidenti i parë i Republikës së pavarur të Maqedonisë ishte Kiro Gligorov. Ai u zgjodh me votim të fshehtë në Kuvendin e Maqedonisë, më 27 janar 1991, me 114 vota të deputetëve "PËR" nga gjithsej 119 deputetë.<sup>19</sup> Të gjitha zgjedhjet e mëvonshme për president u zhvilluan në zgjedhje të përgjithshme dhe të drejtpërdrejta në të cilat patën mundësi të marrin pjesë të gjithë qytetarët me të drejtë vote të regjistruar në Listën e Zgjedhësve.

Zgjedhjet e para të drejtpërdrejta presidenciale në Maqedoni u mbajtën më 16 tetor 1994. Në zgjedhje morën pjesë vetëm dy kandidatë<sup>20</sup>, kështu që zgjedhjet u mbajtën vetëm në një rreth zgjedhor me rivotim në vende të caktuara zgjedhore për shkak të parregullsive të konstatuara.<sup>21</sup>

Presidenti i atëhershëm, Kiro Gligorov<sup>22</sup>, fitoi 52,55% (715.087 vota) nga votat e numrit të përgjithshëm të zgjedhësve të regjistruar në Listën e Zgjedhësve, ndërkaq kundërkandidati i tij, Lubisha Georgievski fitoi 14,49% (197.109 vota). Në zgjedhje votuan gjithsej 1.053.761 zgjedhës ose 77,44% e zgjedhësve të regjistruar në



**Kiro Gligorov,**  
**Presidenti i parë i**  
**RM-së (1991-1999)**

<sup>18</sup> Të gjitha fotot janë marrë nga ueb-faqja e Presidentit të Republikës së Maqedonisë: <http://www.president.gov.mk/> (vizita e fundit: 11 shkurt 2014).

<sup>19</sup> Shënime stenografike nga Seanca e Pestë e Kuvendit të Republikës Socialiste të Maqedonisë, e mbajtur më 27 janar 1991. Shkup, 27 janar 1991. I aksesshëm në: <http://sobranie.mk/WBStorage/Files/05sed27jan91god.pdf> (vizita e fundit: 11 shkurt 2014).

<sup>20</sup> Komisioni Republikan (Shtetëror) i Zgjedhjeve nuk i ka pranuar kandidaturat e: Habit Shaban dhe Gjorgjija Atanasovski për shkak të mospërmbljes së kushtit të cekur në nenin 6, paragrafi 1 nga Ligji i atëhershëm për zgjedhjen e Presidentit të Republikës së Maqedonisë, "Gazeta Zyrtare e RM"-së, nr 20/94. Ligji parashikonte mbështetje për kandidaturë prej më së paku 10 000 zgjedhësve ose më së paku 30 deputetëve.

<sup>21</sup> Rivotimi u mbajt më 30 tetor po atë vit në 7 njësi zgjedhore, në gjithsej 11 vendvotime.

<sup>22</sup> Kiro Gligorov në këto zgjedhje u propozua për President të Republikës së Maqedonisë nga Lidhja Socialdemokrate e Maqedonisë (LSDM)

Listën e Zgjedhësve.<sup>23</sup> Njëra nga specifikat e këtyre zgjedhjeve ishte se, Komisioni Shtetëror i Zgjedhjeve anuloi një numër të madh të fletëvotimeve –130.810 vota u shpallën si të pavlefshme (12,41% e fletëvotimeve). Për shkak të zhvillimit të këtillë të ngjarjeve, partia Organizata e Brendshme Revolucionare Maqedonase – Partia Demokratike e për Unitet Kombëtar Maqedonas (VMRO-DPMNE), e cila e propozoi Lubisha Georgievskin për president, paraqiti kundërshtim pranë Komisionit Shtetëror të Zgjedhjeve (KSHZ), me kërkesë që zgjedhjet të anulohen. Kundërshtimi u refuzua dhe kështu Kiro Gligorov u bë Presidenti i parë i Republikës së Maqedonisë i zgjedhur në zgjedhje të përgjithshme dhe të drejtpërdrejta. Kiro Gligorov e ushtroi funksionin shëf i shtetit deri më 19 nëntor të vitit 1999.<sup>24</sup>



**Boris Trajkovski,  
Presidenti i dytë i  
RM-së (1999-2004)**

Zgjedhjet e dyta me radhë të përgjithshme dhe të drejtpërdrejta presidenciale u mbajtën në vitin 1999. Në zgjedhje morën pjesë gjashtë kandidatë: Boris Trajkovski (VMRO-DPMNE), Vasil Tupurkovski nga Alternativa Demokratike (AD), Muarem Nexhipi nga Partia për Prosperitet Demokratik të Shqiptarëve (PPDSH), Muhamed Halili nga Partia për Prosperitet Demokratik (PPD), Stojan Andov nga Partia Liberal-Demokrate (PLD) dhe Tito Petkovski nga Lidhja Socialdemokrate e Maqedonisë (LSDM).<sup>25</sup>

Rrethi i parë u mbajt më 31 tetor, ndërsa rrethi i dytë më 14 nëntor të vitit 1999. Për shkak të parregullsive të konstatuara, procesi zgjedhor i rrethit të dytë u përsërit më 5 dhjetor të vitit 1999, në gjithsej 230 vendvotime. Për President të Republikës së Maqedonisë u

zgjedh Boris Trajkovski. Pas votimit të rrethit të parë, 32,71% e votave (343.606 vota) i takuan kandidatit Tito Petkovski, 20,85% (219.098 vota) Boris Trajkovskit, 15,54% (163.206 vota) Vasil Tupurkovskit, 14,85% (155.978 vota) Muarem Nexhipit, 10,66% (111.983 vota) Stojan Andovit dhe 4,35% (45.731 vota) Muhamed Halilit. Gjithsej 11.013 fletëvotime u shpallën të pavlefshme (0,68%). Në rrethin e parë në votim dolën 1.039.602 zgjedhës ose 64,44% nga zgjedhësit e regjistruar në Listën e zgjedhësve.<sup>26</sup> BNë rrethin e dytë të zgjedhjeve morën pjesë Tito Petkovski dhe Boris Trajkovski.

Pas mbajtjes së rrethit të dytë dhe pas rivotimit në disa vende zgjedhore, Boris Trajkovski fitoi 52,4% të votave (582.808 vota), ndërsa Tito Petkovski 46,18% (513.614 vota). Gjithsej 16.821 fletëvotime u shpallën si të pavlefshme (1,01%). Në rrethit e dytë, në votim dolën gjithsej 1.096.422 zgjedhës ose 68,08% nga votuesit e regjistruar.<sup>27</sup>

Boris Trajkovski e ushtroi funksionin President i Republikës së Maqedonisë nga 15 dhjetori i vitit 1999 deri më 26 shkurt të vitit 2004.<sup>28</sup>

<sup>26</sup> Sipas: OSBE Zyra për Institucione Demokratike dhe të Drejtat e Njeriut. Republika e Maqedonisë, Zgjedhjet Presidenciale, 31 tetor dhe 14 nëntor 1999, Raporti përfundimtar. Varshavë, 31 janar 2000. I aksesshëm në: <http://www.osce.org/mk/odihr/elections/fyrom/15910> (vizita e fundit: 11 shkurt 2014). Rezultatet janë marrë nga Raporti i OSBE-ODIHR, të cilët thirren në të dhënat zyrtare të shpallura nga KSHZ. Ueb-faqja e KSHZ nuk përmban të dhëna për rezultatet e Zgjedhjeve Presidenciale të vitit 1999.

<sup>27</sup> Ibid.

<sup>28</sup> Presidenti Boris Trajkovski e humbi jetën në fatkeqësi ajrore më 26 shkurt, 2004. Sipas Kushtetutës së Republikës të Maqedonisë, përkohësisht në periudhën kohore nga data 26 shkurt deri në 12 maj të vitit 2004, në krye të shtetit ishte Lupço Jordanovski, titullarë i atëhershëm i funksionit Kryetar i Kuvendit të RM-së.





**Branko Cërvenkovski,**  
**Presidenti i tretë i**  
**RM-së (2004-2009)**

Zgjedhjet presidenciale të vitit 2004 ishin zgjedhjet e treta me radhë presidenciale pas pavarësimit të Republikës së Maqedonisë. Qytetarët, në rrethin e parë zgjedhor, të mbajtur më 14 prill të vitit 2004, zgjidhnin midis katër kandidatëve të propozuar: Branko Cërvenkovski (LSDM), Gëzim Ostreni nga Bashkimi Demokratik për Integrim (BDI), Zudi Xhelili nga Partia Demokratike e Shqiptarëve (PDSH) dhe Sashko Kedev (VMRO-DPMNE). Në ditën e votimit në zgjedhje dolën 935.372 zgjedhës ose 55,2% e zgjedhësve të regjistruar në Listën e zgjedhësve. Sipas të dhënave, 42,47% e votave (385.347 vota) i fitoi Branko

Cërvenkovski, 34,07% (309.132 vota) i fitoi Sashko Kedev, 14,79% nga numri i përgjithshëm i votave, (134.208 vota) i takuan Gëzim Ostrenit, ndërsa 8,67% nga numri i përgjithshëm i votave të vlefshme (gjithsej 78.714) i fitoi Zudi Xhelili. Në rrethin e dytë zgjedhor, të mbajtur më 28 prill të vitit 2004, shumicën e votave i fitoi Branko Cërvenkovski, i cili u bë Presidenti i tretë me radhë i Republikës së Maqedonisë. Ai e fitoi besimin e 550.317 votuesve, përkatësisht 60,5% të numrit të përgjithshëm të votave, kundrejt Sashko Kedevit të cilin e mbështetën 329.179 votues, përkatësisht 36,2% nga numri i përgjithshëm i fletëvotimeve të vlefshme<sup>29</sup>. Në rrethin e dytë morën pjesë 909.289 zgjedhës ose 53,6% e zgjedhësve të regjistruar në Listën e Zgjedhësve.

Branko Cërvenkovski e ushtroi funksionin President i Republikës së Maqedonisë nga 12 maji 2004 deri më 12 maj të vitit 2009.

<sup>29</sup> Sipas: OSBE Zyra për Institucione Demokratike dhe për të Drejtat e Njeriut. Republika e Maqedonisë, Zgjedhjet Presidenciale, 14 dhe 28 prill 2004. Raporti përfundimtar. Varshavë, 13 korrik 2004. I aksesshëm në: <http://www.osce.org/mk/odihr/elections/fyrom/35248> (vizita e fundit: 11 shkurt 2014). Rezultatet janë marrë nga Raporti i OSBE-ODIHR, të cilët thirren në të dhënat e shpallura zyrtare nga KSHZ. Ueb-faqja e KSHZ nuk përmban të dhëna për zbatimin dhe rezultatet e Zgjedhjeve Presidenciale në vitin 2004.

Presidenti aktual i Republikës së Maqedonisë, Gjorge Ivanov u zgjodh në zgjedhjet e fundit presidenciale të mbajtura në vitin 2009. Në këto zgjedhje, në garë ishin shtatë kandidatë, të cilët i plotësonin kushtet për kandidaturën përkatëse. Në këtë cikël, për herë të parë në garën zgjedhore për president hyri edhe një kandidate, Mirushe Hoxha, e cila e kishte mbështetjen e PDSH-së. Pas rrethit të parë zgjedhor, të mbajtur më 22 mars të vitit 2009, në dy vendet e para u gjetën kandidati i mbështetur nga VMRO-DPMNE Gjorge Ivanov, i cili fitoi 35,04% nga numri i përgjithshëm i fletëvotimeve të vlefshme

(345.850 vota) dhe kandidati i mbështetur nga LSDM, Lubomir Danaillov Fërçkovski i cili fitoi 20,54% nga numri i përgjithshëm i fletëvotimeve të vlefshme (202.691 vota). Imer Selmani nga Demokracia e Re (DR) fitoi 14,95% të votave (147.547 vota), më pas vijuan Lube Boshkovski nga të Bashkuar për Maqedoninë (BM) me 14,88% (146.878 vota), Agron Buxhaku (BDI) me 7,46% (përkatësisht 73.629 vota), Nano Ruzhin (PLD) i cili fitoi 4,06% nga numri i përgjithshëm i fletëvotimeve të vlefshme (ose 40.042 vota), ndërsa Mirushe Hoxha (PDSH) u mbështet me 3,06% të votuesve (30.225 vota).<sup>30</sup> Në rrethin e parë, në zgjedhje dolën 1.019.258 e zgjedhësve ose 56,88% e numrit të përgjithshëm të zgjedhësve të regjistruar në Listën e zgjedhësve (1.792.028 qytetarë me të drejtë vote).

Rrethi i dytë i zgjedhjeve u mbajt më 5 prill të vitit 2009. Gjorge Ivanov fitoi 63,14%, përkatësisht 453.616 nga numri i përgjithshëm i fletëvotimeve të vlefshme, ndërsa kandidati për president Lubomir Danaillov Fërçkovski garën zgjedhore e përfundoi duke fituar 36,86% nga numri i përgjithshëm

<sup>30</sup> Komisioni Shtetëror i Zgjedhjeve. Zgjedhjet Presidenciale 2009. Komunikatë për rezultatet përmbledhëse nga votimi në rrethin e parë. I aksesshëm në: [http://www.sec.mk/arhiva/2009\\_pretsedatelskiIlokalni/2009/fajlovi/rezultati/konecni/PretsedatelDrzava.pdf](http://www.sec.mk/arhiva/2009_pretsedatelskiIlokalni/2009/fajlovi/rezultati/konecni/PretsedatelDrzava.pdf) (pasqyra e fundit më 11 shkurt 2014).



**Gjorge Ivanov,**  
**Presidenti i katërt i**  
**RM-së (2009-2014)**



i votave, përkatësisht 264.828 vota.<sup>31</sup> Në rrethin e dytë zgjedhor në votim dolën 764.039 zgjedhës, ose 42,63% e qytetarëve të regjistruar në Listën e Zgjedhësve.

---


<sup>31</sup> Komisioni Shtetëror i Zgjedhjeve. Zgjedhjet Presidenciale 2009. Komunikatë për rezultatet përmblledhëse nga votimi në rrethin e dytë. I aksesshëm në: [http://www.sec.mk/arhiva/2009\\_pretsedatelskiIlokalni/2009/fajlovi/rezultati2/konecnipret/Predsedatel\\_konecni.pdf](http://www.sec.mk/arhiva/2009_pretsedatelskiIlokalni/2009/fajlovi/rezultati2/konecnipret/Predsedatel_konecni.pdf) (pasqyra e fundit më 11 shkurt 2014).

## SISTEMI ZGJEDHOR I MAQEDONISË PËR ZGJEDHJE PRESIDENCIALE

## SISTEMI ZGJEDHOR I MAQEDONISË PËR ZGJEDHJE PRESIDENCIALE<sup>32</sup>

### MODELI ZGJEDHOR PËR PRESIDENT

Presidenti i Republikës së Maqedonisë zgjidhet në zgjedhje të përgjithshme të drejtpërdrejta dhe të lira, me votim të fshehtë për mandat prej 5 vitesh. Zgjedhja e Presidentit të Republikës së Maqedonisë është rregulluar me Kushtetutën e Republikës së Maqedonisë dhe me Kodin Zgjedhor. Së këtejmi, për ndryshimin e akteve normative, që kanë të bëjnë me zgjedhjen e Presidentit të shtetit, Kuvendi duhet të miratojë Vendim për ndryshimin e Kushtetutës, i cili duhet të ketë mbështetje nga dy të tretat e shumicës së votave nga numri i përgjithshëm i deputetëve.



Njësitë zgjedhore  
Burimi: Komisioni Shtetëror i Zgjedhjeve

<sup>32</sup> Ky Kapitull u hartua në bazë të dispozitave të Kushtetutës së Republikës të Maqedonisë me amendamentet prej I deri në XXXII, publikuar në: [www.sobranie.mk](http://www.sobranie.mk), Kodi Zgjedhor (tekst i spastruar), "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 32/2014 shpallur më 12 shkurt të vitit 2014 dhe Ligji për përcaktimin e kushtit për kufizimin e ushtrimit të funksionit publik, qasjes në dokumente dhe publikimin e bashkëpunimit me organet e sigurisë shtetërore, "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 86/2012 shpallur më 9 korrik të vitit 2012.

Me ndryshimet e Kodit Zgjedhor të vitit 2009, përveç në gjashtë njësitë zgjedhore në territorin e Republikës së Maqedonisë, votimi për President (dhe votimi për zgjedhje parlamentare) zhvillohet edhe në njësitë e formuara të reja zgjedhore jashtë vendit: njësia zgjedhore (NJZ) 7 - e cila ka të bëjë me Evropën dhe Afrikën, NJZ 8 - me Amerikën Veriore dhe Jugore dhe njësia zgjedhore 9 - me Australinë dhe Azinë, me ç'rast i tërë territori i Republikës së Maqedonisë, duke i përfshirë edhe njësitë zgjedhore 7, 8 dhe 9 trajtohen si një njësi zgjedhore, ndërsa Presidenti zgjidhet sipas modelit mazhoritar. Në rrethin e parë do të zgjidhet kandidati i cili do ta fitojë shumicën e votave nga numri i përgjithshëm i zgjedhësve të regjistruar në Listën e Zgjedhësve. Nëse ka vetëm një kandidat për President, ndërsa ajo/ai nuk e fiton shumicën e nevojshme të votave në rrethin e parë zgjedhor e tërë procedura do të përsëritet.

Nëse ka më shumë kandidatë, mirëpo asnjëri prej tyre nuk e fiton shumicën e kërkuar të votave nga numri i përgjithshëm i zgjedhësve, në afat prej 14 ditësh organizohet rrethi i dytë i zgjedhjeve në të cilin votohet vetëm për 2 kandidatët të cilët në rrethin e parë kanë fituar numër më të madh të votave. Në rrethin e dytë të zgjedhjeve do të zgjidhet ai kandidat i cili e ka fituar shumicën e votave nga ata që kanë votuar. Nëse përsëri asnjëri nga kandidatët nuk e fiton shumicën e domosdoshme të votave ose nëse dalja në votim është më e vogël se 40%, nga numri i përgjithshëm i votuesve të regjistruar, atëherë procedura zgjedhore do të përsëritet.

Zgjedhja e Presidentit duhet të përfundojë në 60 ditët e fundit të mandatit të Presidentit të mëparshëm, ndërkaq nëse për shkaqe të ndryshme para kohe i pushon mandati Presidentit, atëherë zgjedhja e Presidentit të ri bëhet brenda afatit prej 40 ditësh nga dita e pushimit të mandatit.

Deri në pushimin e mandatit të Presidentit mund të vijë sipas fuqisë së Kushtetutës ose në rast të vdekjes, dorëheqjes ose pamundësisë së përhershme për ta ushtruar funksionin. Se a janë krijuar kushtet për pushimin e mandatit mund ta verifikojë vetëm Gjykata Kushtetuese e RM-së sipas detyrës zyrtare. Kushtetuta nuk lejon krijimin e vakumit në

ushtrimin e funksionit President, kështu që në rast të pamundësisë së Presidentit për ta ushtruar funksionin, Kushtetuta parashikon që atë ta zëvendësojë Kryetari i Kuvendit, i cili në këtë periudhë mund të vazhdojë të marr pjesë në punimet e Kuvendit.

## ORGANET ZGJEDHORE

Komisioni Shtetëror i Zgjedhjeve (KSHZ), bashkë me komisionet komunale të zgjedhjeve (KKZ), këshillat zgjedhorë (KZ) për votim në vend dhe në përfaqësitë diplomatike konsullore (PDK) të Republikës së Maqedonisë janë organe zgjedhore të ngarkuara për zbatimin e zgjedhjeve presidenciale. Komisioni Shtetëror i Zgjedhjeve përbëhet nga shtatë anëtarë të cilët i zgjedh Kuvendi i Republikës së Maqedonisë me mandat katërvjeçar. Anëtarët e KSHZ-së zgjidhen në afat prej 60 ditësh nga mbajtja e seancës konstituive të Kuvendit. Kryetari i KSHZ-së dhe dy anëtarë të tjerë zgjidhen me propozim të partive politike nga opozita, ndërsa nënkryetari dhe tre anëtarë të KSHZ-së zgjidhen me propozim të partive politike në pushtet. KSHZ-ja ka në dispozicion shërbim profesional i cili i kryen punët profesionale-administrative dhe punët organizative-teknike.

Komisionet Komunale të Zgjedhjeve (KKZ) formohen në nivel të çdo komune dhe ngarkohen t'i zbatojnë zgjedhjet në territorin nën juridiksionin e tyre dhe të bëjnë mbikëqyrje mbi punën e këshillave zgjedhorë. Ata përbëhen nga pesë anëtarë, prej të cilëve njëri është kryetar, ndërsa secili anëtar ka edhe zëvendësin e tij. Anëtarët dhe zëvendësit e KKZ-ve zgjidhen nga radhët e të punësuarve në administratën shtetërore, publike dhe komunale, me arsim të lartë, për mandat prej pesë vitesh. Zgjedhjen e tyre e bën KSHZ-ja.

Këshilli zgjedhor është një organ i cili formohet për secilin vend zgjedhor, përbëhet nga pesë anëtarë, prej të cilëve njëri është kryetar, ndërkaq secili prej anëtarëve ka edhe zëvendësin e tij. Kryetari i këshillit zgjedhor

dhe zëvendësi i tij, dy anëtarë dhe zëvendësit e tyre zgjidhen nga radhët e të punësuarve në administratën shtetërore, publike dhe komunale, sipas zgjedhjes së rastësishme, për periudhë kohore prej katër vjetësh. Një anëtar të KZ dhe zëvendësin e tij e propozojnë partitë politike nga opozita, të cilat në zgjedhjet e fundit për deputetë kanë fituar më së shumti vota, ndërsa një anëtar tjetër dhe zëvendësin e tij e propozojnë partitë politike në pushtet, të cilat në zgjedhjet e fundit për deputetë kanë fituar numër më të madh të votave. Numri i vendeve zgjedhore në shtet për zgjedhjet presidenciale është 3480, përkatësisht ka 504 vende zgjedhore më shumë sesa në zgjedhjet paraprake. Për votim jashtë vendit janë parashikuar 47 vende zgjedhore në PDK-të, por zgjedhjet do të organizohen vetëm në ato PDK në të cilat janë paraqitur minimum 10 zgjedhës.

## **E DREJTA DHE PROCEDURA PËR PARAQITJEN E KANDIDATURAVE PËR PRESIDENT**

Personat që paraqesin kandidatura për President të Republikës së Maqedonisë duhet t'i plotësojnë kushtet si vijojnë:

- të jenë shtetas të Republikës së Maqedonisë;
- në ditën e zgjedhjeve të kenë mbushur më së paku 40 vjet;
- të jenë banorë të Republikës së Maqedonisë më së paku 10 vjet, në 15 vitet e fundit;
- të mos jenë zgjedhur paraprakisht dy herë në funksionin President;
- të mos kenë qenë bashkëpunëtorë të fshehtë, lidhje operative ose informatorë të fshehtë gjatë grumbullimit operativ të informatave dhe të dhënave në periudhën nga 2 gushti i vitit 1944 deri në ditën e fillimit të zbatimit të Ligjit për qasje të lirë në informata me karakter publik, siç është përcaktuar në Ligjin për përcaktimin e kushtit për kufizimin e ushtrimit të funksionit publik, qasjes në dokumente dhe publikimit të bashkëpunimit me organet e sigurisë shtetërore.

Kandidati për President duhet të propozohet nga më së paku 30 deputetë ose 10 000 votues. Së këtejmi, si parashtrues të listave të kandidatëve mund të paraqiten parti politike, koalicione të partive të cilat janë regjistruar në Komisionin Shtetëror të Zgjedhjeve, grup zgjedhësish dhe deputetë. Mbledhja e nënshkrimeve nga grupi i zgjedhësve zgjat 15 ditë. Një zgjedhës nënshkrimin e vet mund ta vë vetëm në një listë për kandidat për President të Republikës, ndërkaq nënshkrimet mbledhen në formular, në komuna dhe në njësitë rajonale të Komisionit Shtetëror të Zgjedhjeve, para personit zyrtar. Zgjedhësit, të cilët e paraqesin listën, duhet të kenë të drejtën e zgjedhjes dhe vendbanim të përhershëm në Republikën e Maqedonisë.

Kandidaturën për President të Republikës së Maqedonisë e paraqet propozuesi i autorizuar nga kandidati pranë Komisionit Shtetëror të Zgjedhjeve, i cili konstaton se a është paraqitur në afatin e parashikuar dhe në përputhje me aktet normative zgjedhore. Nëse konstaton parregullsi, KSHZ-ja do ta thërras përfaqësuesin e autorizuar të paraqitësit të listës në afat prej 48 orësh t'i korrigjojë të njëjtat. Kur lista do t'i përmbushë të gjitha aktet normative ose parregullsitë e konstatuara do të korrigjohen brenda afatit të përcaktuar, atëherë KSHZ-ja do ta verifikojë të njëjtën, ndërkaq nëse parregullsitë e konstatuara nuk korrigjohen brenda afatit të përcaktuar, atëherë në afat prej 24 orësh do ta hedhë poshtë. Në rastin kur kandidatura hidhet poshtë, përfaqësuesi i paraqitësit të listës, kundër vendimit të KSHZ-së mund të ngre padi pranë Gjykatës Administrative. Padia doemos duhet të paraqitet brenda afatit prej 24 orësh, ndërsa Gjykata Administrative e ka për detyrë të merr vendim në afat prej 24 orësh. Kandidati për kandidaturën e tij paraqet pëlqim (deklaratë) me shkrim, i cili është i përvokueshëm.

KSHZ-ja e ka për detyrë që listën e kandidatëve për President të Republikës ta publikojë në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë" më së voni 25 ditë para ditës së mbajtjes së zgjedhjeve.

## FUSHATA ZGJEDHORE

Fushata zgjedhore nënkupton prezantimin publik të kandidatëve të verifikuar nga organet kompetente zgjedhore dhe programeve të tyre në periudhën parazgjedhore, përkatësisht tubime publike dhe ngjarje të tjera publike të organizuara nga organizatori i fushatës, vendosjen publike të pllakateve, video prezantime në vende publike, prezantime zgjedhore mediatike dhe internet prezantime, si dhe shpërndarjen e materialeve të shtypura. Organizatori i fushatës zgjedhore mban përgjegjësi për zbatimin e të njëjtës dhe për ligjshmërinë e saj, si dhe për aktivitetet e fushatës të cilat do t'i zbatojnë persona të tjerë të cilët ajo/ai i ka autorizuar.

Fushata zgjedhore për zgjedhjen e Presidentit fillon 20 ditë para ditës së zgjedhjeve dhe zgjatë deri një ditë para zgjedhjeve. Dita para rrethit të parë dhe rrethit të dytë të zgjedhjeve është ditë e heshtjes zgjedhore, përkatësisht periudhë kur nuk guxon të zhvillohet fushatë zgjedhore.

Për qëllimet e fushatës zgjedhore, organizatorët e fushatës zgjedhore hapin llogari të veçantë bankare, ndërsa fushata guxon të financohet vetëm nga mjetet e kësaj llogarie. Si donatorë mund të paraqiten persona fizikë dhe juridikë nga Republika e Maqedonisë, me ç'rast personat fizikë mund të japin donacion në lartësi prej 5.000 euro, ndërkaq personat juridikë në lartësi prej 50.000 euro në kundërvlerë me denarë. Donacioni mund të jetë edhe në formë të parave, sendeve dhe shërbimeve, por megjithatë vlera e tyre nuk guxon t'i tejkalojë shumat e përcaktuara. Fushata zgjedhore mund të financohet edhe nga mjetet e anëtarësisë së partisë politike.

Fushata zgjedhore nuk guxon të financohet me mjete të ndërmarrjeve publike dhe institucioneve publike, shoqatave të qytetarëve, komuniteteve fetare, grupeve religjioze dhe fondacioneve, qeverive të huaja, institucioneve ndërkombëtare, organeve dhe organizatave të shteteve të huaja dhe personave të tjerë të huaj, ndërmarrjeve me kapital të përbashkët në të cilat dominon kapitali i huaj dhe nga burime të

paidentifikuara. Fushata zgjedhore po ashtu nuk guxon të financohet me mjete të Buxhetit të Republikës së Maqedonisë, të buxheteve të komunave dhe buxhetit të Qytetit të Shkupit, përveç nga kompensimet e shpenzimeve për zgjedhje të cilat i kanë organizatorët e fushatës zgjedhore. Në rastin kur kandidatura nuk realizohet, organizatorët e fushatës zgjedhore e kanë për detyrë që donacionet e pashpenzuara, në afat prej 60 ditësh, tua kthejnë donatorëve.

Të drejtën e kompensimit të shpenzimeve për zgjedhje e kanë organizatorët e fushatës zgjedhore nga lista e kandidatëve të të cilëve është zgjedhur kandidati për President të Republikës dhe organizatorët e fushatës zgjedhore nga lista e kandidatëve të të cilëve nuk është zgjedhur kandidati për President të Republikës nëse kanë fituar më së paku 1,5% nga numri i përgjithshëm i votave të qytetarëve të cilët kanë dalë në zgjedhje në nivel të Republikës. Kompensimi është në lartësi prej 15 denarë për një votë të fituar.

Nëse gjatë paraqitjeve ose njoftimeve publike shkelen të drejtat e ndonjërit nga kandidatët, të njëjtit kanë të drejtë menjëherë të ngrenë procedurë gjyqësore për mbrojtjen e të drejtave të tyre. Për padi të këtillë gjykata themelore kompetente vendos me afate urgjente, ndërsa vendimi shpallet në mjetet e informimit publik.

## ROLI I MJETEVE TË INFORMIMIT PUBLIK

Gjatë fushatës zgjedhore servisi publik radiodifuziv dhe tregtarët radiodifuzivë të cilët do të informojnë për zgjedhjet e kanë për detyrë që këtë ta bëjnë në mënyrë të drejtë, të balancuar dhe të paanshme.

Me Kodin Zgjedhor është përcaktuar se cilat përmbajtje konsiderohen si prezantim zgjedhor mediatik, cilat përmbajtje nuk guxojnë të transmetohen para fillimit të fushatës zgjedhore dhe mënyra e sjelljes së radiodifuzerëve nga dita e shpalljes së zgjedhjeve deri në ditën e përcaktuar për fillimin e fushatës zgjedhore.



Kodi Zgjedhor i obligon radiodifuzerët që të sigurojnë mbulim të balancuar të zgjedhjeve dhe ta zbatojnë parimin e barazisë në të gjitha format e prezantimit zgjedhor mediatik të kandidatëve për president në rrethin e parë dhe të dytë. Nga parimi i proporcionalitetit, përkatësisht barazisë, përjashtohet reklamimi i paguar politik.

Në afat prej 5 ditësh, nga dita e shpalljes së zgjedhjeve, radiodifuzerët dhe mediat e shkruara e kanë për detyrë të përcaktojnë lista të çmimeve për reklamim të paguar politik të pjesëmarrësve në procesin zgjedhor. Këto lista të çmimeve shpallen publikisht më së paku dy herë para fillimit të fushatës zgjedhore dhe nuk guxojnë të ndryshohen gjatë fushatës zgjedhore. Në rastet kur mediat ofrojnë ulje të çmimeve për reklamim politik, uljet konsiderohen për donacion të shprehur në vlerë monetare, por jo më të lartë se 50.000 euro në kundërvlerë me denarë.

Reklamimi i paguar politik doemos duhet, në mënyrë përkatëse dhe të dukshme, të shënohet si "reklamim i paguar politik", në mënyrë të qartë të shënohet porositësi i reklamimit dhe në mënyrë të qartë të veçohet nga përmbajtjet e tjera të medias. Reklamimi i paguar politik nuk guxon të transmetohet në kuadër të lajmeve, programeve të veçanta informative, programeve arsimore, programeve për fëmijë, transmetimit të ngjarjeve fetare, sportive, kulturore, zbavitëse dhe në kuadër të ngjarjeve të tjera. Në reklamimin e paguar politik nuk guxojnë të marrin pjesë persona të mitur.

Radiotelevizioni i Maqedonisë (RTVM) si servis publik radiodifuziv nuk guxon të transmetojë reklamim të paguar politik. RTVM-ja e ka për detyrë, në bashkëpunim me Komisionin Shtetëror të Zgjedhjeve, pa kompensim t'i informojë qytetarët për mënyrën dhe teknikën e votimit, si dhe të transmetojë informata të tjera në lidhje me procesin zgjedhor. Gjithashtu, ajo e ka për detyrë të transmetojë prezantim falas politik për pjesëmarrësit në procesin zgjedhor, në përputhje me Kodin Zgjedhor.

Agjencia për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizive (ASHMAA)<sup>33</sup> është organi i cili ka kompetencë ta monitorojë prezantimin zgjedhor mediatik dhe servisin programor nga dita e shpalljes së zgjedhjeve deri në përfundim të votimit në ditën e zgjedhjeve. Nëse ASHMAA konstaton parregullsi, atëherë duhet të ngre procedurë për kundërvajtje kundër radiodifuzerit i cili i ka shkelur rregullat. Organet e ASHMAA<sup>34</sup> janë Këshilli dhe drejtori. Këshilli përbëhet nga shtatë anëtarë, të cilët i emëron Kuvendi i RM-së, sipas propozimit të propozuesve të autorizuar. Propozues të autorizuar të anëtarëve të Këshillit janë: Shoqata Dominante e Gazetarëve, Konferenca Interuniversitare, Dhoma e Avokatisë e RM-së, Lidhja e Sindikatave të Maqedonisë, Komisioni për Çështje të Zgjedhjeve dhe Emërimeve pranë Kuvendit të RM-së dhe Bashkësia e Njësive të Vetëqeverisjes Lokale. Të gjithë propozuesit e autorizuar propozojnë nga një anëtarë të Agjencisë, përveç Komisionit për Çështje të Zgjedhjeve dhe Emërimeve pranë Kuvendit të RM-së, i cili propozon dy anëtarë. Anëtarët e Këshillit emërohen për një periudhë kohore prej shtatë vitesh, pa të drejtë riemërimi. Këshilli e zgjedh drejtorin e ASHMAA përmes konkursit publik. Mandati i drejtorit është shtatë vjet.

Gjatë publikimit të rezultateve nga sondazhi i opinionit publik mediat e kanë për detyrë t'i theksojnë të dhënat e emrit të porositësit dhe financuesit të sondazhit, institucionin që e ka realizuar sondazhin, metodologjinë e aplikuar, madhësinë dhe strukturën e formularit të sondazhit dhe periudhën brenda së cilës është zbatuar sondazhi. Të dhënat e këtilla nuk guxojnë të publikohen në pesë ditët e fundit para ditës së zgjedhjeve, të rrethit të parë dhe të dytë të votimit.

Pas përfundimit të procesit zgjedhor, më saktësisht në afat prej 15 ditësh nga përfundimi i fushatës, radiodifuzerët dhe mediat e shkruara e kanë për detyrë të paraqesin raport për hapësirën reklamuese të shfrytëzuar

<sup>33</sup> Paraprakisht, organ kompetent ishte Këshilli për Radiodifuzion, i cili me Ligjin për shërbime mediatike audio dhe audiovizive, "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë 184/2013 u riemërua në Agjenci për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizive

<sup>34</sup> Ligji për shërbime mediatike audio dhe audiovizive, "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr. 184/2013". I aksesshëm në: <http://www.avmu.mk/images/zakonot-MKD.pdf> (vizita e fundit: 26 mars 2014).

nga secili prej organizatorëve të fushatës zgjedhore dhe për mjetet e paguara ose të cilat duhet të arkëtohen mbi këtë bazë. Këtë raport ata e paraqesin deri te KSHZ-ja, Enti Shtetëror i Revizionit dhe Komisioni Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit, të cilët e kanë për obligim ta publikojnë në faqet e tyre të Internetit.

Për mosrespektimin e prezantimit mediatik dhe reklamimit politik, radiodifuzerëve dhe mediave të shkruara u shqiptohet dënim në para në shumë prej 1500 deri në 5000 euro, varësisht nga kundërvajtja. ASHMAA fillimisht e zbaton procedurën për barazim dhe nëse e njëjta nuk është e suksesshme, ngrehet procedurë për kundërvajtje para gjykatës themelore kompetente.

### **KUFIZIME PËR FUNKSIONARËT AKTUAL**

Nga dita e miratimit të vendimit për shpalljen e zgjedhjeve deri në përfundimin e zgjedhjeve, nuk guxon:

- të vihen në dispozicion mjete buxhetore të Republikës së Maqedonisë, mjete të buxheteve të komunave dhe Qytetit të Shkupit, fondeve publike, ndërmarrjeve publike, institucioneve publike ose personave juridikë të cilët kanë në dispozicion kapital shtetëror, përveç nëse kjo ndryshe nuk është përcaktuar me ligj me të cilin rregullohet financimi i fushatave zgjedhore të partive politike;
- të fillojnë ndërtime, me mjete të buxhetit, fondeve publike, ndërmarrjeve publike dhe personave të tjerë juridikë të cilët kanë në dispozicion kapital shtetëror, të objekteve të reja në infrastrukturë, siç janë: rrugë, ujësjellës, linja të tensionit të lartë, kanalizime, fusha sporti dhe objekte të tjera ose objekte për veprimtari shoqërore-shkolla, kopshte dhe objekte të tjera, përveç nëse për këtë dedikim paraprakisht janë siguruar mjete nga buxheti, përkatësisht bëhet fjalë për realizim të programit të miratuar në bazë të ligjit në vitin rrjedhës;

- të realizohen pagesa të jashtëzakonshme të pagave, pensione, asistencave sociale; ose
- të realizohen pagesa të tjera me mjete buxhetore, mjete të fondeve publike;
- të tjetërsohet kapitali shtetëror;
- të nënshkruhen marrëveshje kolektive.

Nëse ndonjë ministër ose zëvendësministër i shkelë këto rregulla atëherë do t'i shqiptohet gjobë në shumë prej 500 deri më 1000 euro në kundërvlerë me denarë.

Nëse dikush nga kandidatët për President të Republikës është pjesëtar i forcave të armatosura të Republikës së Maqedonisë, i pjesës së uniformuar të policisë, personave të autorizuar zyrtarë të Ministrisë së Punëve të Brendshme, Ministrisë së Mbrojtjes dhe Agjencisë për Zbulim nga dita kur do të verifikohet kandidatura e tij, marrëdhënia e punës përkohësisht do t'i pezullohet.

### **MANDATI I PRESIDENTIT**

Mandati i Presidentit të Republikës fillon me dhënien dhe nënshkrimin e Deklaratës solemne para Kuvendit të Republikës së Maqedonisë, që duhet të ndodhë në afat prej 10 ditësh pas shpalljes së rezultateve përfundimtare, por jo më herët nga dita e pushimit të mandatit të Presidentit të mëparshëm. Deklarata solemne është si vijon:

"Deklaroj se funksionin President të Republikës së Maqedonisë do ta ushtroj me ndërgjegje dhe me përgjegjësi, do ta respektoj Kushtetutën dhe ligjet dhe do ta mbrojë sovranitetin, integritetin territorial dhe pavarësinë e Republikës së Maqedonisë."

Pas hyrjes në funksion, Presidenti e merr mandatin:

- ta prezantojë Republikën;
- të jetë komandant suprem i Forcave të Armatosura të Maqedonisë;
- ta përcaktojë mandatarin për formimin e Qeverisë të Republikës së Maqedonisë;
- të emërojë dhe revokojë me dekret ambasadorë dhe përfaqësues të Republikës së Maqedonisë jashtë vendit;
- të pranojë letrat kredenciale dhe revokuese të përfaqësuesve të huaj diplomatikë;
- të propozojë dy gjyqtarë të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Maqedonisë;
- të propozojë dy anëtarë të Këshillit Gjyqësor të Republikës së Maqedonisë;
- të propozojë anëtarë të Këshillit për Marrëdhënie Ndëretnike;
- të emërojë dhe shkarkojë edhe bartës të tjerë të funksioneve shtetërore dhe publike të përcaktuara me Kushtetutë dhe me ligj;
- të ndajë dekorata dhe mirënjohje në përputhje me ligjin;
- të bëjë falje në përputhje me ligjin;
- të kryejë detyra të tjera të përcaktuara me Kushtetutë.

Së paku një herë në vit, më së shpeshti në muajin dhjetor, Presidenti i Republikës së Maqedonisë e njofton Kuvendin për çështje në kompetencë të tij.

Kuvendi mund të kërkojë nga Presidenti i Republikës të jap mendim për çështje në kompetencë të tij.

Funksioni President i Republikës nuk pajtohet me ushtrimin e funksionit tjetër publik, politik ose profesional. Presidenti gëzon imunitet gjatë

ushtrimit të funksionit të tij, por nëse e shkel Kushtetutën ose ligjet gjatë ushtrimit të detyrës së tij për të njëjtën duhet të përgjigjet. Procedurën për përcaktimin e përgjegjësisë duhet ta ngre Kuvendi me shumicën e dy të tretave të votave nga numri i përgjithshëm i deputetëve, por i njëjti nuk ka të drejtë të vendos për përgjegjësinë e Presidentit. Për përgjegjësinë e Presidentit vendos Gjykata Kushtetuese me shumicën e dy të tretave të votave nga numri i përgjithshëm i gjyqtarëve, e cila po ashtu me shumicën e dy të tretave të votave, nga numri i përgjithshëm i gjyqtarëve, mund të vendos që t'ia heq imunitetin.

## MONITORIMI I ZGJEDHJEVE

Të drejtën e monitorimit të zgjedhjeve e kanë monitoruesit e akredituar, me ç'rast KSHZ-ja lëshon autorizime. Akreditim për monitorimin e zgjedhjeve mund të fitojnë organizatat civile vendase të cilat janë të regjistruara së paku një vit para mbajtjes së zgjedhjeve, ndërsa në statutin e tyre e kanë inkorporuar parimin për mbrojtjen e të drejtave të njeriut. Organizatat ndërkombëtare dhe përfaqësuesit e vendeve të huaja gjithashtu mund t'i monitorojnë zgjedhjet. Përfaqësuesit e autorizuar të paraqitësve të listave kanë të drejtë të caktojnë përfaqësuesin e tyre i cili do ta monitorojë punën e organeve zgjedhore.

## PJESËMARRËSIT E ZGJEDHJEVE PRESIDENCIALE 2014

### PJESËMARRËSIT E ZGJEDHJEVE PRESIDENCIALE 2014

#### Gjorge Ivanov<sup>35</sup>



Gjorge Ivanov është President aktual i Republikës së Maqedonisë, i zgjedhur në Zgjedhjet Presidenciale të vitit 2009. Në këto zgjedhje presidenciale ai, për herë të dytë, do ta kërkojë verditin e qytetarëve maqedonas, si kandidat i partisë në pushtet VMRO-DPMNE.

Para marrjes së funksionit President, Gjorge Ivanov në publikun maqedonas njihet si profesor universitar. Nga viti 2004 deri në vitin 2008 ishte Prodekan në Fakultetin Juridik pranë Universitetit "Shën Cirili e Metodi" dhe udhëheqës i studimeve politike, ndërsa paraprakisht edhe profesor i studimeve politike. Në Fakultetin Juridik në Shkup ka filluar të punojë si asistent në vitin 1995, ndërsa në vitin 1998 u zgjodh për Docent. Para angazhimit të tij si profesor, ka punuar si gazetarë dhe redaktor i Programit të tretë të Radiotelevizionit të Maqedonisë (1988-1995). Në vitin 2000 bëhet ligjërues në Master Programin për Studime Evropiane Juglindore në Universitetin në Athinë.

Gjorge Ivanov arsimin e tij e ka kryer në Fakultetin Juridik "Justiniani I" në Shkup ku edhe ka diplomuar në fushën e shkencave juridike, ndërkaq magjistroi dhe doktoroi në fushën e shkencave politike. Ka magjistruar në vitin 1994 në temën: "Shoqëria civile – kontradiktat e reja të çështjes së vjetër", ndërsa ka doktoruar në vitin 1998 në temën: "Demokracia në shoqëritë e ndara: modeli maqedonas".

<sup>35</sup> Fotografia është shkarkuar nga: <http://www.president.gov.mk/mk/galerija/dekembri-2012/1799.html> (i aksesshëm në 11.03.2014).

Në pjesën e angazhimit të tij akademik, Gjorge Ivanov është autor i dy librave, bashkautorë i tre librave të tjerë, si dhe i një numri të madh të punimeve shkencore nga fusha e shkencave politike. Ai është themelues dhe kryetar i njëres nga qendrat e para analitike nga fusha e shkencave shoqërore në Republikën e Maqedonisë, Instituti për Demokraci, Solidaritet dhe Shoqëri Civile. Përveç kësaj, ai është njëri nga themeluesit e revistës për shkenca politike: "Opinion i politik", e cila botohet më shumë se 10 vjet.

Gjorge Ivanov aktualisht ka 53 vjet, ka lindur më 2 maj të vitit 1960 në Valandovë. Është i martuar me Maja Ivanova dhe ka një djalë.

### Iljaz Halimi<sup>36</sup>



Iljaz Halimi është profesor i diplomuar i filozofisë, themelues, anëtar dhe funksionar shumëvjeçar i PDSH-së. Në Zgjedhjet Presidenciale të vitit 2014 ai do të merr pjesë nga pozita e shqiptarit të vetëm etnik në garën presidenciale.

Ai është ish-zëvendësministër i Mbrojtjes në Qeverinë e Republikës së Maqedonisë (2006-2008) dhe deputet në Kuvendin e Republikës së Maqedonisë në dy legjislatura (1998-2002 dhe 2002-2006). Në kuadër të legjislaturës së parë si deputet (1998-2002) e ushtronte funksionin e Nënkrëtarit të institucionit ligjvënës. Ka qenë edhe anëtarë i Këshillit të Sigurisë të Republikës së Maqedonisë në periudhën kohore nga viti 1998 deri në vitin 2001. Paraprakisht (1979-1998), ka punuar si profesor i sociologjisë dhe zëvendës drejtor në Gjimnazin "Kiril Pejçinoviq" në Tetovë. Në periudhën kohore nga viti 2009 deri në vitin 2013 punon si udhëheqës i Sektorit për Veprimtari Publike në Komunën e Tetovës.

<sup>36</sup> Fotografia është shkarkuar nga: <http://www.novini.mk/read/650169/ilijaz-halimi-pret-sedatelski-kandidat-na-dpa> (i aksesshëm në: 11.03.2014).

Nga viti 1990 deri në vitin 1997, Iljaz Halimi është kryetar i Partisë Demokratike Popullore (PDP), e cila në vitin 1997 u bashkua me Partinë për Prosperitet Demokratik të Shqiptarëve (PPDSH), dhe më këtë u formua PDSH-ja. Në periudhën kohore nga viti 1997 deri në vitin 2007, Halimi e kryen funksionin e nënkryetarit të PDSH-së. Nga viti 2011 është anëtar i Kryesisë Qendrore të PDSH-së.

Iljaz Halimi studimet universitare për filozofi i ka kryer në Fakultetin Filozofik pranë Universitetit të Prishtinës. Aktualisht, ka 60 vjet, ka lindur më 7 shkurt të vitit 1954 në fshatin Sushiq, Kosovë. Është i martuar me Zejna Halimi dhe ka një djalë.

### Stevo Pendarovski<sup>37</sup>



Stevo Pendarovski është profesor universitar, punon në Fakultetin e Shkencave Politike pranë Universitetit "Amerikan Koleh" në Shkup (UAKSH), si profesor inordiner në lëndët: Siguria Ndërkombëtare, Politika e Jashtme dhe Globalizimi. Në

Zgjedhjet Presidenciale të vitit 2014 do të merr pjesë si kandidat i partisë opozitare LSDM.

Në periudhën kohore nga viti 2001 deri në vitin 2004, Stevo Pendarovski punon si këshilltar për siguri kombëtare në Kabinetin e Presidentit Boris Trajkovski, ndërsa në periudhën kohore nga viti 2005 deri në vitin 2009 e ushtron funksionin e këshilltarit për politikë të jashtme në Kabinetin e Presidentit Branko Cërvenkovski. Ka qenë edhe Kryetar i Komisionit Shtetëror të Zgjedhjeve, në periudhën kohore nga viti 2004 deri në vitin

<sup>37</sup> Fotografia është shkarkuar nga: <http://www.makdenes.org/content/article/25286074.html> (i aksesshëm në: 11.03.2014).



2005. Paraprakisht, nga viti 1998 deri në vitin 2001, punon si ndihmës ministër në Ministrinë e Punëve të Brendshme dhe si kryeshef i Drejtorisë për Analitikë dhe Kërkime në kuadër të Ministrisë së njëjtë.

Stevo Pendarovski është doktor i filozofisë, magjistroi dhe doktoroi në Institutin për Kërkime Sociologjike dhe Juridike - Politike, pranë Universitetit "Shën Cirili e Metodi" – Shkup. Ka magjistruar në temën: "Gjeopolitika e re e Republikës së Maqedonisë: Kontradiktat e matricave komuniste dhe të tranzicionit", ndërkaq ka doktoruar në temën: "Politika e jashtme dhe e sigurisë e BE-së dhe shteteve të vogla: kuadri i diskursit kombëtar". Ka diplomuar në Fakultetin Juridik në Shkup në fushën e shkencave juridike.

Ai është autor i më shumë librave dhe punimeve shkencore të publikuara në Maqedoni dhe më gjerë, si dhe pjesëmarrës në shumë konferenca shkencore, debate dhe diskutime publike.

Stevo Pendarovski aktualisht ka 51 vjet, ka lindur më 3 prill të vitit 1963 në Shkup. Është i martuar me Elizabeta Gjorgievska dhe ka një djalë.

### Zoran Popovski<sup>38</sup>



Zoran Popovski është profesor universitar udhëheqës i Katedrës për Biokimi dhe Inxhinieri Gjenetike pranë Fakultetit të Shkencave Bujqësore dhe Ushqim. Është anëtar i Këshillit të Komunës Karposh, pasi që u zgjodh në Zgjedhjet Lokale të vitit 2013. Në Zgjedhjet Presidenciale të vitit 2014 ai do të merr pjesë si kandidat i OPQM (GROM), parti e cila pas formimit të saj në vitin 2013, për të parën herë merr pjesë në zgjedhje të përgjithshme dhe të drejtpërdrejta.

<sup>38</sup> Fotografia është shkarkuar nga: <http://grom.mk/wp-content/uploads/2013/12/sovet-nik-dr-zoran-popovski.jpg> (i aksesshëm në 11.03.2014).

Në periudhën kohore nga viti 2002 deri në vitin 2006 ka punuar si Sekretar shtetëror në Ministrinë e Arsimit. Në Fakultetin e Shkencave Bujqësore dhe Ushqim punon nga viti 1992, ndërsa përveç kësaj ligjëron edhe në Fakultetin Teknologjik-Metalurgjik dhe në Fakultetin e Farmacisë në Shkup.

Zoran Popovski ka diplomuar për biologji në Fakultetin e Shkencave të Natyrës në Shkup. Titullin magjistër i biokimisë e ka fituar në fakultetin e njëjtë në vitin 1999, ndërsa në vitin 2002 ka doktoruar në aplikimin e metodave bashkëkohore të ADN-së në bio-teknologjinë animale në Fakultetin e Shkencave Bujqësore dhe Ushqim.

Ka marrë pjesë në më shumë komisione dhe trupa punues internacional dhe nacional të ngarkuara për politikrat dhe reformat arsimore. Ka marrë pjesë në hartimin e Programit nacional për zhvillimin e arsimit nga viti 2005 deri në vitin 2015 dhe në Programin nacional për zhvillimin e veprimtarisë kërkimore – shkencore nga viti 2006 deri në vitin 2010. Është autor i më shumë se 100 punimeve shkencore dhe publikimeve profesionale, ndërsa ka marrë pjesë në një numër të madh të konferencave dhe tubimeve vendase dhe ndërkombëtare.

Zoran Popovski, aktualisht ka 51 vjet, ka lindur më 08 shtator të vitit 1962 në Shkup. Është i martuar me Zlatka Stamboliska Popovska dhe është baba i dy fëmijëve – djalit dhe vajzës.





## **ZGJEDHJET PRESIDENCIALE NË REPUBLIKËN E MAQEDONISË 2014 - REZULTATET, FUSHATA DHE VLERËSIMET**

## **ZGJEDHJE PRESIDENCIALE NË REPUBLIKËN E MAQEDONISË 2014 – REZULTATE, FUSHATA, VLERËSIME**

### **LISTA E SHKURTESAVE**

Agjencia për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizive - ASHMAA

Organizata e Brendshme Revolucionare Maqedonase – Partia Demokratike për Unitet Kombëtar Maqedonas -VMRO-DPMNE

Opsioni Qytetar për Maqedoni – OPQM (GROM)

Partia Demokratike Shqiptare - PDSH

Bashkimi Demokratik për Integrim - BDI

Enti Shtetëror i Revizionit - ESHR

Komisioni Shtetëror i Zgjedhjeve - KSHZ

Komisioni Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit - KSHPK

Radiotelevizioni i Maqedonisë - RTVM

Komisioni Komunal i Zgjedhjeve - KKZ

Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë/Zyra për Institucione Demokrati dhe të Drejtat e Njeriut – OSBE/ODIHR

Lidhja Socialdemokrate e Maqedonisë - LSDM

## HYRJE

Më 13 dhe 27 prill të vitit 2014 u mbajt rrethi i parë, përkatësisht rrethi i dytë i zgjedhjeve të pesta të përgjithshme presidenciale në Republikën e Maqedonisë. Në të dy rrethet e zgjedhjeve fitoi kandidati i partisë në pushtet Organizata e Brendshme Revolucionare Maqedonase - Partia Demokratike për Unitet Kombëtar Maqedonas (VMRO-DPMNE) dhe Presidenti aktual i Republikës së Maqedonisë Gjorge Ivanov. Në rrethin e parë të zgjedhjeve në garë ishte edhe Stevo Pendarovski, kandidat i partisë opozitare Lidhjes Socialdemokrate të Maqedonisë (LSDM), Iljaz Halimi, kandidat i partisë opozitare Partisë Demokratike Shqiptare (PDSH) dhe Zoran Popovski, kandidat i partisë jashtëparlamentare Aleanca Qytetare për Maqedoni (OPQM). Në rrethin e dytë hynë vetëm kandidatët Gjorge Ivanov dhe Stevo Pendarovski. Në zgjedhjet e pesta presidenciale gjithsej për votim u regjistruan 1 779 572 votues. Në rrethin e parë dolën të votojnë 869.617 (48,86%), ndërsa në rrethin e dytë dolën të votojnë 967.676 (54,38%) votues.

Zgjedhjet presidenciale u shpallën më 1 shkurt 2014, ndërkaq fushata zgjedhore filloi më 24 mars 2014. Gjatë periudhës parazgjedhore të zgjedhjeve presidenciale, për shkak të mosmarrëveshjeve midis partnerëve të koalicionit VMRO-DPMNE dhe BDI-së për nominimin e kandidatit të përbashkët konsensual për President të Republikës së Maqedonisë, BDI paraqiti nismë për vet-shpërndarjen e Kuvendit dhe për shpalljen e zgjedhjeve të parakohshme parlamentare, e cila u pranua nga të gjithë deputetët e pranishëm në Kuvend. Si rezultat i këtyre ngjarjeve politike më 27 prill 2014, në ditën e njëjtë me rrethin e dytë të zgjedhjet presidenciale u caktuan dhe u mbajtën zgjedhjet e parakohshme parlamentare. Fushata e zgjedhjeve parlamentare filloi më 5 prill dhe zhvillohej paralelisht me fushatën e zgjedhjeve presidenciale. BDI, e cila nuk nominoi kandidat presidencial, në mesin e popullsisë etnike shqiptare zhvilloi fushatë dhe apelonte deri te qytetarët që të mos dalin të votojnë në zgjedhjet presidenciale. Fushata e këtillë shkaktoi reduktim të

konsiderueshëm të jehonës për zgjedhjet presidenciale në komunat në të cilat në shumicë jeton popullsia etnike shqiptare.

Zgjedhjet presidenciale në rrethin e parë i monitoruan gjithsej 9 917 vëzhgues vendor dhe 489 vëzhgues të huaj, përkatësisht 10 013 vëzhgues vendor dhe 610 vëzhgues të huaj në rrethin e dytë të zgjedhjeve. Vlerësimi i përgjithshëm për zgjedhjet presidenciale ishte se ato u zbatuan në mënyrë efikase, kandidatët lirshëm e kanë zhvilluar fushatën e tyre, ndërkaq retorika dhe fushata është acaruar në gjysmën e dytë të fushatës, përkatësisht me fillimin e fushatës për zgjedhjet e parakohshme parlamentare. Vërejtjet kryesore të vëzhguesve në të vërtetë u shkaktuan nga sjelljet e partive politike gjatë fushatës për zgjedhjet parlamentare. Në vazhdim të këtij Manuali bëhet një vështrim i hollësishëm mbi fushatën zgjedhore, mbi të ardhurat dhe shpenzimet e fushatave presidenciale, raportimet e medieve, rezultatet e zgjedhjeve, respektimin e të drejtave të zgjedhësve, vlerësimin e zgjedhjeve nga vëzhguesit dhe partitë politike dhe prezantohen konkluzione të përmbledhura lidhur me ciklin e përgjithshëm të zgjedhjeve.

## FUSHATA ZGJEDHORE DHE FINANCIMI I KANDIDATËVE PËR PRESIDENT

Fushata për zgjedhjen e Presidentit filloi më 24 mars dhe në masë të madhe u karakterizua me një promovim pozitiv të kandidatëve, mirëpo edhe me sulme me të cilat kundërkandidatët u përpoqën të prezantohen si antipodë të oponentëve të tyre kryesorë. Të gjithë kandidatët në masë më të madhe ose më të vogël si forma kryesore të fushatës organizuan mitingje dhe takime me qytetarë, promovuan reklama televizive dhe zbatuan fushatë interneti. Në të katër fushatat për president u organizuan gjithsej 62 mitingje dhe 8 takime me qytetarë. Fushata ishte e qetë, ndërsa MPB konstatoi se në krahasim me ciklet paraprake zgjedhore, kësaj radhe është regjistruar numër më i vogël i incidenteve dhe prishjes së rendit dhe qetësisë publike, përkatësisht vetëm 9 incidente dhe prishje

të rendit dhe qetësisë publike në të cilat është shkaktuar dëm i vogël dhe i pakonsiderueshëm material.<sup>39</sup>

Presidenti aktual dhe kandidat i VMRO-DPMNE-së, Gjorge Ivanov fushatën e zhvilloi me sloganin "Shteti para së gjithash". Si slogan shoqërues gjatë fushatës dërgoheshin edhe këto mesazhe: "Gjorge Ivanov për President", "Fuqishëm mbi rrënjët tua", "Fuqishëm dhe sigurt", "Vlera dhe tradita", "Krenar dhe me dinjitet". Fushata e Ivanovit u iniciua nga një grup i personave të njohur të cilët u vetëquajtën "Ekipi Maqedoni" dhe bashkë me VMRO-DPMNE i zhvilluan aktivitetet elektorale. Më 14 mars, Ivanov e publikoi "Llogaridhënien e Presidentit Gjorge Ivanov 2009-2014", e cila nënkupton një pasqyrë të asaj që është realizuar nga ana e tij gjatë mandatit të parë. Kjo, nga ana e KSHZ-së, u vlerësua si fillim i parakohshëm të fushatës zgjedhore, ndërsa KSHZ-ja mori vendim që të ngre procedurë për kundërvajtje kundër organizatorit të fushatës zgjedhore.<sup>40</sup> Epilogu i kësaj procedure akoma nuk është i njohur, mirëpo nëse konstatohet faji, organizatori i fushatës zgjedhore të Ivanovit do të duhet të paguajë gjobë nga 3000-5000 euro në kundërvlerë me denarë. Ivanov, në fjalimet e tij, theksoi se midis institucioneve të shtetit duhet të ketë bashkëpunim dhe unitet, gjë që siç e sqaronte ai është treguar në punën e tij dhe punën e Qeverisë dhe se e njëjta ka dhënë rezultate. Ai theksonte se nuk do ta pranojë ndryshimin e Kushtetutës me qëllim që të ndryshohet emri kushtetues i vendit ose propozime të tjera të cilat do ta rrezikonin identitetin kombëtar maqedonas. Gjithashtu, theksonte se gjatë mandatit të parë janë realizuar të gjitha projektet e parashikuara dhe se do të vazhdojë me zbatimin e projekteve për bashkëpunim me biznes komunitetin, transparencë ndaj qytetarëve, promovimin e shkencës, arsimit dhe sportit.

Fushatën e Internetit, Ivanov e zhvillonte përmes dy ueb-faqeve të veçanta Ivanov.mk dhe timmakedonija.mk, si dhe përmes ueb-faqes së

VMRO-DPMNE. Para rrethit të parë të zgjedhjeve presidenciale, Ivanov në Fejsbuk profilin e tij, në të cilin promovohet në mënyrë aktive, kishte 90.171 ithtarë, ndërkaq deri në rrethin e dytë ky numër arriti deri në 100.517.<sup>41</sup> Në këto zgjedhje, për dallim prej Zgjedhjeve Presidenciale të vitit 2009,<sup>42</sup> Ivanov nuk kishte profil të tij në Twitter.

Fushata e kandidatit të LSDM-së, Stevo Pendarovski u zhvillua me sloganin "Maqedonia meriton President". Fushata kishte tre aspekte kryesore. Së pari, ta prezantojë Pendarovskin si kandidat i cili është i ndryshëm nga Presidenti aktual Ivanov, përkatësisht të prezantohet si President i cili do të bëjë një kundërbalancë të politikave të Qeverisë, i cili do të kishte rol aktiv në skenën politike. Së dyti, me sloganin shoqërues "Stevo Presidenti Im" fushata përpiquej ta afrojë kandidatin deri te qytetarët. Aspekti i tretë kryesor i fushatës ishte trajtimi i të rinjve dhe votuesve nga bashkësitë e tjera etnike, me fokus më të madh mbi bashkësinë etnike shqiptare. Pendarovski theksonte se sa i përket çështjes së emrit ai angazhohet për qëndrim shtetëror dhe për konsensus të të gjithë aktorëve relevantë politik lidhur me këtë çështje, me ç'rast nuk guxon të cenohet asnjë komponentë vitale e identitetit kombëtar. Deri në fillimin e fushatës së zgjedhjeve parlamentare, Pendarovski në mitingje dhe takimet me qytetarë nuk shoqërohej nga udhëheqësia dhe lideri i LSDM-së Zoran Zaev, ndërsa me fillimin e fushatës së zgjedhjeve të parakohshme parlamentare filluan aktivitetet t'i zbatojnë bashkërisht.

Pendarovski kishte fushatë aktive në Internet, përmes Fejsbukut ku deri në fund të rrethit të parë kishte 64.823 ithtarë, ndërsa deri në fund të rrethit të dytë ky numër u rrit në 67.445 persona.<sup>43</sup> Profili i tij Twitter, deri në fund të rrethit të dytë kishte 1.945 ithtarë.<sup>44</sup> Pendarovski nuk kishte ueb-faqe të veçantë për fushatën, ndërkaq video-regjistrimet nga fushata promovoheshin përmes Kanalit Yutub dhe ueb-faqes së LSDM-së.

<sup>39</sup> Ministria e Punëve të Brendshme e Republikës së Maqedonisë, 25.04.2014 Shtabi Operativ pranë MPB për nevojat e zgjedhjeve, Krahësuar me ciklet paraprak zgjedhorë deri më tani numër më i vogël i incidenteve dhe prishjes së RQP <http://www.mvr.gov.mk/Show-Announcements.aspx?ItemID=13451&mid=1367&tabId=358&tabindex=0> (vizituar më 25 prill 2014)

<sup>40</sup> Komisioni Shtetëror i Zgjedhjeve, Komunikatë nga Seanca e 78 e Komisionit Shtetëror të Zgjedhjeve <http://217.16.84.23/index.php?limitstart=32&lang=mk>

<sup>41</sup> GJORGE IVANOV, PRESIDENT I REPUBLIKËS SË MAQEDONISË, <https://www.facebook.com/macedonianpresident> (vizituar më 11 prill 2014 dhe 27 prill 2014)

<sup>42</sup> <https://twitter.com/gjorgeivanov> (vizituar më 11 prill 2014)

<sup>43</sup> Stevo Pendarovski <https://www.facebook.com/SPendarovski> (vizituar më 11 prill 2014 dhe 27 prill 2014)

<sup>44</sup> <https://twitter.com/SPendarovski> (vizituar më 27 prill 2014)

Kandidati i vetëm etnik shqiptar për President, Iljaz Halimi, i cili u nominua nga PDSH, në përgjithësi fushatën e mbështeti në drejtim të përfitimit të votuesve në bazë etnike. Në këtë drejtim, mesazhi i tij ishte “Për President Shqiptar”, ndërkaq mesazhi shoqërues ishte “Voto për numrin 2”. Fushata e Halimit zhvillohej në gjuhën shqipe, edhe pse kandidati e bënte me dije se nëse zgjidhet për President, ai do të ishte Presidenti i qytetarëve të të gjitha bashkësive etnike. Sa i përket çështjes së emrit, kandidati presidencial Halimi vuri në pah se do të zhvillojë politikë aktive për zgjidhjen e kësaj çështjeje, me ç’rast do t’i përfshijë të gjitha partitë politike dhe do të angazhohet për kompromis i cili nuk do ta rrezikojë identitetin e bashkësive etnike që jetojnë në Maqedoni. Në këtë fushatë vend kryesor kishte lideri i PDSH-së Menduh Thaçi i cili bashkë me Halimin kishin rol qendror në mitingjet e PDSH-së.

Halimi kishte një prezencë më të dobët në Internet dhe vetëm në Fejsbuk kishte profil të dedikuar për fushatën presidenciale. Në këtë profil, deri në rrethin e parë të zgjedhjeve, Halimi kishte 2.281 ithtarë.<sup>45</sup> Prezenca tjetër në Internet e këtij kandidati realizohej përmes ueb-faqes, kanalit Yutub dhe faqes Fejsbuk të PDSH-së.

Kandidati i OPQM Zoran Popovski fushatën e zhvilloi me sloganin “Njeri i guximshëm, shtet krenar” dhe “Guximshëm për Maqedoninë”, e që ishte edhe slogani i partisë për zgjedhjet parlamentare. Popovski prezantohej si profil i Presidentit i cili nuk do të lejojë shpenzime të papërgjegjshme të parave të popullit, se do të promovojë kushte më të mira për bizneset vendorë dhe për të rinjtë, se do të jetë avokat i qytetarëve. Sa i përket çështjes së emrit, Popovski, vuri në pah se nuk do të hiqte dorë nga linjat e kuqe të cilat tanimë janë të përcaktuara në publik, përkatësisht se nuk do të heq dorë nga emri kushtetues dhe identiteti kombëtar i qytetarëve, mirëpo duhet të shqyrtohet përdorimi i formulës së dyfishtë dhe lobimi për fillimin e negociatave për anëtarësim në Bashkimin Evropian pa zgjidhjen e çështjes së emrit.

<sup>45</sup> Iljaz Halimi Për President <https://www.facebook.com/iljazhalimiofficial> (vizituar më 11 prill 2014)

Përmes profilit në Fejsbuk, Zoran Popovski fitoi 1.600 ithtarë,<sup>46</sup> ndërsa në Twitter 333 ithtarë.<sup>47</sup> Video-regjistrimet nga fushata e Popovskit u transmetuan në Kanalin Yutub të OPQM-së.

Paralelisht me fushatat zgjedhore presidenciale, me sloganin “Jo Presidentit të Njëanshëm”, BDI-ja zhvillonte fushatë në mesin e shqiptarëve etnikë që të mos dalin të votojnë në zgjedhjet presidenciale. Takimet dhe tubimet me qytetarët shqiptarë etnik, të cilët BDI i organizonte që tua shpjegojë qëllimin e fushatës filluan në Kërçovë. BDI-ja e promovonte idenë se Presidenti i shtetit duhet të zgjidhet në Dhomën Ligjvënëse dhe ta ketë mbështetjen e të gjitha partive politike të të gjitha bashkësive etnike në vend. Fushata e BDI-së ishte e suksesshme në mesin e simpatizantëve të tyre, dhe së këtejmi në ditën e zgjedhjeve në vendet e votimit, në të cilat dominonte popullsia etnike shqiptare, një numër i madh i qytetarëve nuk dolën të votojnë.

Sa u përket shpenzimeve të kandidatëve në fushatën zgjedhore ata e kanë për detyrë të paraqesin gjithsej tre raporte financiare, nëse kanë marrë pjesë vetëm në rrethin e parë të zgjedhjeve ose gjithsej 4 raport financiare nëse kanë marrë pjesë edhe në rrethin e dytë të votimit. Raporti i parë, i cili ka të bëjë me dhjetë ditët e para të fushatës, kandidatët e kishin për detyrë ta paraqesin në ditën e 11-të të fushatës, përkatësisht më 3 prill. Raportin e dytë, kandidatët e kishin për detyrë ta paraqesin një ditë pas përfundimit të fushatës, më 12 prill dhe ai ka të bëjë me gjysmën e dytë të fushatës. Të gjithë kandidatët i paraqitën me kohë dy raportet e para financiare.

Kandidatët Ivanov dhe Pendarovski, të cilët garuan në rrethin e dytë, po ashtu e kishin për detyrë që më 26 prill, një ditë para mbajtjes së rrethit të dytë, ta paraqesin raportin e tretë financiar që ka të bëjë me fushatën zgjedhore për rrethin e dytë të votimit.<sup>48</sup> Të dy kandidatët i paraqitën me

<sup>46</sup> Zoran Popovski – Kandidat për President të Maqedonisë <http://goo.gl/VN2yMa> (vizituar më 11 prill 2014)

<sup>47</sup> <https://twitter.com/popovskiz> (vizituar më 11 prill 2014)

<sup>48</sup> Komisioni Shtetëror i Zgjedhjeve, Zgjedhje Presidenciale 2014, Raporte financiare të kandidatëve për President të Republikës së Maqedonisë [http://217.16.84.23/index.php?option=com\\_content&view=article&id=305:fin\\_izv&catid=29&Itemid=1278&lang=mk](http://217.16.84.23/index.php?option=com_content&view=article&id=305:fin_izv&catid=29&Itemid=1278&lang=mk) (vizituar më 27 prill 2014)

kohë këto raporte financiare. Raportin e fundit të përgjithshëm financiar, të gjithë kandidatët e kanë për detyrë ta paraqesin menjëherë ose më së voni deri më 25 maj të vitit 2014, përkatësisht 30 ditë pas rrethit të dytë të votimit. Të gjitha raportet financiare paraqiten pranë Komisionit Shtetëror të Zgjedhjeve, Komisionit Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit dhe Entit Shtetëror të Revizionit, ndërsa raporti i përgjithshëm financiar paraqitet edhe në Kuvendin e Republikës së Maqedonisë. Çdo organizator i fushatës zgjedhore ka të drejtë të shpenzojë nga 180 denarë për një votues të regjistruar, përkatësisht gjithsej 320.322.960 denarë për fushatën e tij zgjedhore (5,164,340 euro).<sup>49</sup> Çdo organizator i fushatës zgjedhore, kandidati i të cilit ka fituar më së paku 1,5% nga numri i përgjithshëm i votave, prej atyre që kanë votuar, ka të drejtë kompensimi prej 15 denarë për një votë të fituar, që kompensohet nga Buxheti i Republikës së Maqedonisë.<sup>50</sup> Nëse organizatori i fushatës zgjedhore ka grumbulluar më shumë mjete prej mjeteve të shpenzuara atëherë i njëjti e ka për detyrë që tepicën e mjeteve t'i dhurojë për qëllime bamirësie.

Sipas raporteve të paraqitura financiare, fushatë më të kushtueshme zgjedhore ka zbatuar kandidati Ivanov, i cili deri në fund të rrethit të dytë ka shpenzuar 47.394.082 denarë (766.895 euro). Në periudhën deri më 26 prill, ai ka grumbulluar më pak mjete sesa mjetet e shpenzuara, përkatësisht ka grumbulluar 29.832.462 denarë (482.726 euro). Që të kompensohen këto dallime, kandidatët mund t'i grumbullojnë donacionet më së voni deri në 30 ditë, pas rrethit të dytë, përkatësisht deri më 25 maj, kur edhe duhet ta paraqesin raportin e përgjithshëm financiar.

Oponenti i tij Stevo Pendarovski deri në fund të rrethit të dytë gjithsej ka shpenzuar 9.392.108 denarë (151.976 euro), ndërsa në periudhën e njëjtë ka grumbulluar 9.880.742 (159.883), përkatësisht 488.634 denarë (7.907 euro) më shumë sesa që ka shpenzuar.

Të dy kandidatët, të cilët nuk hynë në rrethin e dytë, Halimi dhe Popovski, kanë shpenzuar më pak mjete sesa të dy pretendetët kryesorë për

funksionin President, Ivanov dhe Pendarovski. Halimi ka paraqitur se ka shpenzuar 509.226 denarë (8.240 euro), ndërsa deri më 12 prill ka grumbulluar më pak donacione sesa mjetet e shpenzuara. Të ardhurat e fushatës së tij kapin shifrën prej 200.000 denarë (3.236 euro), me ç'rast deri në fund të rrethit të parë ka pasur 309.226 denarë (5.004 euro) më pak të ardhura sesa shpenzime.

Kandidati i vetëm i cili ka paraqitur se ka grumbulluar pothuajse shumë të njëjtë të mjeteve sa edhe ka shpenzuar është kandidati Zoran Popovski. Popovski ka paraqitur se deri më 25 prill ka pasur shpenzime në lartësi prej 830.000 denarë (13.430 euro), ndërkaq shpenzime në shumë prej 830.030 denarë (13.431 euro).<sup>51</sup>

| Raporte financiare të kandidatëve për President të Republikës së Maqedonisë <sup>52</sup> |               |            |              |           |                   |           |                |           |
|-------------------------------------------------------------------------------------------|---------------|------------|--------------|-----------|-------------------|-----------|----------------|-----------|
|                                                                                           | Gjorge Ivanov |            | Iljaz Halimi |           | Stevo Pendarovski |           | Zoran Popovski |           |
|                                                                                           | Të ardhura    | Shpenzime  | Të ardhura   | Shpenzime | Të ardhura        | Shpenzime | Të ardhura     | Shpenzime |
| Raporti i parë, datë-24 mars-2 prill (afati 3 prill)                                      | 14.306.396    | 31.149.203 | 0            | 0         | 6.129.211         | 5.663.790 | 500.000        | 500.000   |
| Raporti i dytë 3-11 prill (afati 12 prill)                                                | 15.031.526    | 10.229.668 | 200.000      | 509.226   | 509.198           | 487.829   | 0              | 0         |
| Gjithsej në rrethin e parë                                                                | 29.337.922    | 41.378.871 | 200.000      | 509.226   | 6.638.409         | 6.151.619 | 500.000        | 500.000   |
| Raporti i tretë: 14 deri 25 prill (afati 26 prill)                                        | 494.540       | 6.015.211  | /            | /         | 3.242.333         | 3.240.489 | 330.030        | 330.000   |
| Gjithsej (denarë)                                                                         | 29.832.462    | 47.394.082 | 200.000      | 509.226   | 9.880.742         | 9.392.108 | 830.030        | 830.000   |
| Gjithsej (euro)                                                                           | 482.726       | 766.895    | 3.236        | 8240      | 159.883           | 151.976   | 13.431         | 13.430    |
| Dallimi (denarë)                                                                          | -17.561.620   |            | -309.226     |           | 488.634           |           | 30             |           |
| Dallimi (euro)                                                                            | -284.168      |            | - 5.004      |           | 7.907             |           | 0,485436893    |           |

<sup>51</sup> Më 25 prill 2014 organizatori i fushatës zgjedhore të Zoran Popovskit ka paraqitur raport financiar për periudhën kohore nga data 12 deri më 25 prill, edhe pse këtë nuk e ka pasur për detyrë sepse kandidati nuk ka zhvilluar fushatë në rrethin e dytë.

<sup>52</sup> Pasqyra e Raportit financiar është përpiluar në bazë të raporteve financiare të cilat organizatorët e fushatave i kanë paraqitur deri te organet kompetente shtetërore, përfundimisht me datë 8 maj 2014. Deri në këtë datë nuk ishin paraqitur raportet e përgjithshme financiare për fushatat e zgjedhjeve presidenciale dhe për këtë shkak pasqyra nuk ka të bëjë me donacionet dhe shpenzimet e përgjithshme të fushatës.

<sup>49</sup> Përlllogaritjet në euro janë bërë sipas kursit të mesëm prej 61,8

<sup>50</sup> Kodi Zgjedhor i Republikës së Maqedonisë (tekst i spastruar) 2014, Komisioni Shtetëror i Zgjedhjeve <http://217.16.84.23/files/IzborenzakonikzaWEB1.pdf> (vizituar më 10 prill 2014)



## MEDIAT

Monitorimi i zbatuar mbi mediat nga OSBE/ODIHR<sup>53</sup> gjatë fushatës së zgjedhjeve presidenciale, në rrethin e parë dhe të dytë, vuri në dukje "mungesë të analizës dhe raporte të pavarura" lidhur me aktivitetet e kandidatëve presidencial. Në përgjithësi, Misioni i OSBE/ODIHR përmes raporteve nënvizoi se nga aspekti kuantitativ, mediat i respektojnë përcaktimet ligjore, ndërsa nga aspekti kualitativ situata është e kundërt. Në masë të caktuar kjo ka të bëjë me atë se mediat më të mëdha janë "nën kontroll të tërthortë të partisë në pushtet për shkak të pozitës së qeverisë, si porositësi më i madh i reklamave".<sup>54</sup>

Në raporte është nënvizuar dukuria e auto-censurës tek subjektet mediatike, njëanshmëri e qartë ndaj kandidatit Gjorge Ivanov dhe Koalicionit të VMRO-DPMNE, si dhe raporte negative ndaj kandidatit presidencial, Stevo Pendarovski dhe partisë opozitare LSDM. Në mënyrë plotësuese, servisi publik TVM 1 ka raportuar për aktivitetet e partisë në pushtet VMRO-DPMNE dhe kandidatin Gjorge Ivanov me tone pozitive, për dalim nga tonet neutrale të cilat janë përdorur për partitë dhe kandidatët e tjerë. Në mënyrë të ngjashme, servisi publik TVM 2, i cili transmeton program në gjuhët e bashkësive jo shumicë, ka raportuar në mënyrë afirmative për bojkotimin e zgjedhjeve presidenciale të partnerit të koalicionit në qeveri, BDI. Monitorimi i OSBE/ODIHR i përfshiu mediat elektronike: RTVM 1, RTVM 2, TV Sitel, TV Kanal 5, TV Alfa, TV Telma dhe TV Alsat-M dhe mediat e shkruara: Dnevnik, Nova Makedonia, Sloboden pečat dhe Koha.

OSBE/ODIHR u bëjnë vërejtje edhe raporteve të monitorimit të mediave të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audovizive (ASHMAA),

<sup>53</sup> Shih: Deklaratat e OSBE/ODIHR me të dhënat dhe konkluzionet preliminare të zgjedhjeve: OSBE/ODIHR, Misioni Monitorues Ndërkombëtar për Zgjedhjet në Republikën e Maqedonisë, Zgjedhjet Presidenciale 13 prill 2014. (2014) Deklaratë për të dhënat dhe konkluzionet preliminare. Shkup, prill, i aksesshëm në: <http://www.osce.org/mk/odihr/elections/117647?download=true> (vizituar më 13 maj 2014); dhe OSBE/ODIHR, Misioni Ndërkombëtar Monitorues për Zgjedhjet në Republikën e Maqedonisë, Zgjedhje Presidenciale dhe Zgjedhje të Parakohshme Parlamentare, 27 prill 2014 (2014). Deklaratë për të dhënat dhe konkluzionet preliminare. Shkup, prill, i aksesshëm në: <http://www.osce.org/mk/odihr/elections/fyrom/118079?download=true> (vizituar më 13 maj 2014)

<sup>54</sup> Citati është marrë nga deklarata me të dhëna dhe konkluzione preliminare për rrethin e parë të zgjedhjeve presidenciale nga OSBE/ODIHR, f. 10.

organ kompetent për monitorimin e raportimeve mediatike në periudhën zgjedhore. Raportet e ASHMAA më shumë kanë qenë të fokusuar mbi aspektet kuantitative të raportimeve mediatike, me ç'rast janë anashkaluar aspektet kualitative dhe kjo e pamundëson Agjencinë që të "konstatojë shkelje potenciale të përcaktimeve ligjore, që të gjithë difuzerët publikë të sigurojnë mbulim të drejtë dhe të paanshëm".<sup>55</sup>

Sipas Kodit Zgjedhor, mediat e kanë për detyrë të raportojnë për kandidatët në zgjedhjet presidenciale në mënyrë të drejtë, të balancuar dhe të paanshme. Në mënyrë plotësuese, me ndryshimet e fundit të Kodit Zgjedhor, nga muaji shkurt i vitit 2014, u inkorporuan rregulla të reja për raportim mediatik në lajmet e servisit publik radiodifuziv, Radiotelevizioni Maqedonas (RTVM). Sipas ndryshimeve, servisi publik radiodifuziv e ka për detyrë ta shpërndajë kohën e raportimit në këtë mënyrë: një e treta e kohës dedikohet për raportimin e ngjarjeve ditore nga vendi dhe bota; një e treta e kohës i dedikohet raportimit të aktiviteteve nga fushata e kandidatëve të partive politike në pushtet dhe një e treta e kohës i dedikohet raportimit për aktivitetet nga fushata e kandidatëve të partive politike në opozitë. Koha e përcaktuar për çdo kandidat varet nga rezultatet dhe mandatet e fituara në zgjedhjet e fundit parlamentare. Siç është theksuar në Deklaratën e të dhënave dhe konkluzioneve preliminare të zgjedhjeve presidenciale dhe të zgjedhjeve të parakohshme parlamentare të OSBE/ODIHR, kjo mënyrë e shpërndarjes së kohës nuk korrespondon me paragrafin 7.8 të Dokumentit të Kopenhagës të OSBE, meqë krijon pengesa për ndarjen e kohës për raportimin mediatik të kandidatëve të partive jashtëparlamentare. Megjithatë RTVM ndau kohë jashtë nga një të tretat e kohës së parashikuar edhe për përfaqësuesit e partive jashtëparlamentare, në bazë të rekomandimit të ASHMAA.

Për rrethin e parë dhe në bazë të ndryshimeve të fundit të Kodit Zgjedhor, koha e raportimit të RTVM u shpërnda në këtë mënyrë: një e treta e kohës i dedikohet raportimeve të aktiviteteve të kandidatit të VMRO-DPMNE Gjorge Ivanov (partia në pushtet BDI nuk kishte kandidat të vet presidencial), ndërsa një e treta e kohës tjetër iu dedikua aktiviteteve

<sup>55</sup> Shih: Deklaratën e OSBE/ODIHR për rrethin e dytë të Zgjedhjeve Presidenciale dhe Zgjedhjeve të Parakohshme Parlamentare, f. 10

të kandidatëve të partive opozitare LSDM dhe PDSH, Stevo Pendarovski dhe Iljaz Halimi, me ç'rast kandidatit të LSDM-së i takon përqindje më e madhe e kohës. Kandidati i OPQM, Zoran Popovski ishte i përfaqësuar në emisionet informative jashtë një të tretës së kohës së parashikuar për raportim, të dedikuara për partitë parlamentare.

Sa i përket rrethit të dytë të zgjedhjeve presidenciale, kandidatët e VMRO-DPMNE dhe LSDM, Gjorge Ivanov dhe Stevo Pendarovski, kishin kohë të barabartë për prezantim në emisionet informative të TVM, secili në kuadër të një të tretës së kohës së vet në të cilën prezantoheshin aktivitetet e tyre personale, por edhe aktivitetet e partive politike në pushtet dhe në opozitë për shkak të mbivendosjes së rrethit të dytë të zgjedhjeve presidenciale me zgjedhjet e parakohshme parlamentare.

ASHMAA, si organ kompetent për monitorimin e raportimeve të mediave në periudhën zgjedhore, në raportin e saj përfundimtar publikoi se servisi publik radiodifuziv, sa i përket raportimit në rrethin e parë, ka mundësuar mbulim mediatik në emisionet informative të kandidatëve, në kuadër të obligimeve ligjore. Sipas raportit, është respektuar edhe ndarja e një të tretës së kohës ndërmjet raportimeve nga vendi dhe bota, raportimeve për kandidatët e pushtetit dhe raportimeve për kandidatët e opozitës. Njëherësh, në kuadër të një të tretës së kohës, kandidatët janë prezantuar konform rezultateve në zgjedhjet e fundit parlamentare. RTVM ka ndarë kohë edhe për raportime mediatike për kandidatin presidencial të OPQM.<sup>56</sup>

Sa i përket rrethit të dytë të zgjedhjeve presidenciale fushata e së cilës zhvillohej paralelisht me fushatën e zgjedhjeve të parakohshme parlamentare, ASHMAA po ashtu konstatoi raportime konform përcaktimeve ligjore për aktivitetet e Gjorge Ivanovit dhe Stevo Pendarovskit. Këto konkluzione nga raporti i ASHMAA, të cilat i mbulojnë të dy rrethet e zgjedhjeve presidenciale, kanë të bëjnë me të gjitha mediat në kuadër të

servisit publik radiodifuziv: RTVM 1, RTVM 2 – programi në gjuhën shqipe, RTVM 2 – programi në gjuhën turke dhe serviset programore të Radios maqedonase. RTVM mundësoi edhe prezantim politik falas për kandidatët në kuadër të obligimeve ligjore.

Monitorimi i ASHMAA e përfshin edhe kohën e ndarë për prezantime të drejtpërdrejta të kandidatëve presidencial në emisionet informative në servisin publik. Në rrethin e parë më shumë kohë i është dedikuar prezantimit të Gjorge Ivanovit dhe Stevo Pendarovskit. Iljaz Halimi, në aspektin kohor, ka qenë më i përfaqësuar në servisin RTVM 2 dhe Radion Maqedonase 3, të cilët transmetojnë programe në gjuhën shqipe. Gjorge Ivanov, në masë të konsiderueshme, është prezantuar me fjalime të drejtpërdrejta edhe në serviset në gjuhën shqipe, për dallim nga Stevo Pendarovski, i cili në këto servise është prezantuar dukshëm më pak. Iljaz Halimi dhe Zoran Popovski kanë qenë në masë të konsiderueshme më pak të prezantuar në RTVM 1, në krahasim me prezantimin e Gjorge Ivanovit dhe Stevo Pendarovskit. Sa i përket prezantimit të përgjithshëm të kandidatëve në serviset programore në RTVM, gjatë rrethit të parë, më i përfaqësuar ka qenë Gjorge Ivanov me 74 prezantime të drejtpërdrejta, në kohëzgjatje prej 1 orë, 22 minuta dhe 35 sekonda, ndërkaq Stevo Pendarovski është përfaqësuar gjithsej me 66 prezantime në kohëzgjatje prej 57 minuta dhe 31 sekonda. Iljaz Halimi në mënyrë të drejtpërdrejtë u është drejtuar votuesve përmes servisit publik radiodifuziv gjithsej 69 herë, në kohëzgjatje prej 51 minuta dhe 21 sekonda (45 minuta dhe 59 sekonda prej këtyre prezantimeve janë transmetuar në serviset në gjuhën shqipe). Zoran Popovski është prezantuar më së paku në krahasim me kandidatët e tjerë, dhe sa u përket prezantimeve të drejtpërdrejta – 56 herë, në kohëzgjatje të përgjithshme prej 24 minuta dhe 29 sekonda (shih: Tabelën 1).

<sup>56</sup> Agjencia për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizive (2014 Raport nga monitorimi i mbulimit mediatik për zgjedhjet Presidenciale dhe Zgjedhjet e Parakohshme Parlamentare. Shkup, maj, i aksesshëm në: [http://www.avmu.mk/images/Finalen\\_Izvestaj\\_Iz-bori\\_2014\\_-\\_nacionalni\\_mediumi.pdf](http://www.avmu.mk/images/Finalen_Izvestaj_Iz-bori_2014_-_nacionalni_mediumi.pdf) (vizituar më 13 maj 2014)

| <b>Tabela 1:</b> Prezantime të drejtpërdrejta të kandidatëve presidencial në emisionet informative në servis publik (rrethi i parë). Burimi: Agjencia për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizive (2014) |                      |                |                          |                |                     |                |                       |                |
|-----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|----------------------|----------------|--------------------------|----------------|---------------------|----------------|-----------------------|----------------|
|                                                                                                                                                                                                           | <b>Gjorge Ivanov</b> |                | <b>Stevo Pendarovski</b> |                | <b>Iljaz Halimi</b> |                | <b>Zoran Popovski</b> |                |
| <b>Media</b>                                                                                                                                                                                              | Prezantime           | Koha           | Prezantime               | Koha           | Prezantime          | Koha           | Prezantime            | Koha           |
| RTVM 1                                                                                                                                                                                                    | 18                   | 0:13:50        | 19                       | 0:19:40        | 14                  | 0:02:22        | 12                    | 0:01:58        |
| RTVM 2                                                                                                                                                                                                    | 18                   | 0:27:47        | 12                       | 0:07:29        | 18                  | 0:25:08        | 12                    | 0:07:29        |
| Radio Maqedonase 1                                                                                                                                                                                        | 20                   | 0:24:26        | 18                       | 0:22:07        | 19                  | 0:03:00        | 18                    | 0:10:04        |
| Radio Maqedonase 3 – në gjuhën shqipe                                                                                                                                                                     | 18                   | 0:16:32        | 16                       | 0:08:15        | 18                  | 0:20:51        | 14                    | 0:04:58        |
| <b>Gjithsej</b>                                                                                                                                                                                           | <b>74</b>            | <b>1:22:35</b> | <b>65</b>                | <b>0:57:31</b> | <b>69</b>           | <b>0:51:21</b> | <b>56</b>             | <b>0:24:29</b> |

Në rrethin e dytë koha e dedikuar për prezantimin e kandidatëve presidencial, si dhe numri i prezantimeve në masë të konsiderueshme ishte i reduktuar, ndërkaq kjo para së gjithash ka të bëjë me zhvillimin e njëkohshëm të fushatës për zgjedhjet e parakohshme parlamentare. Si në rrethin e parë ashtu edhe në rrethin e dytë, kandidati Gjorge Ivanov përsëri ka qenë më i përfaqësuar tek mediat në gjuhën shqipe. Sa i përket numrit të përgjithshëm të prezantimeve të drejtpërdrejta dhe kohëzgjatjes së tyre, Gjorge Ivanov ka qenë i përfaqësuar gjithsej me 32 prezantime me kohëzgjatje prej 13 minuta dhe 25 sekonda, ndërsa Stevo Pendarovski me gjithsej 24 prezantime me kohëzgjatje prej 10 minuta dhe 32 sekonda.

| <b>Tabela 2:</b> Prezantime të drejtpërdrejta të kandidatëve presidencial në emisionet informative në servis publik (rrethi i dytë). Burimi: Agjencia për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizive (2014) |                      |                |                          |                |
|-----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|----------------------|----------------|--------------------------|----------------|
|                                                                                                                                                                                                           | <b>Gjorge Ivanov</b> |                | <b>Stevo Pendarovski</b> |                |
| <b>Media</b>                                                                                                                                                                                              | Prezantime           | Koha           | Prezantime               | Koha           |
| RTVM 1                                                                                                                                                                                                    | 4                    | 0:00:37        | 7                        | 0:03:12        |
| RTVM 2                                                                                                                                                                                                    | 8                    | 0:02:55        | 5                        | 0:01:40        |
| Radio Maqedonase 1                                                                                                                                                                                        | 10                   | 0:05:53        | 7                        | 0:04:10        |
| Radio Maqedonase 3 – në gjuhën shqipe                                                                                                                                                                     | 10                   | 0:04:00        | 5                        | 0:01:30        |
| <b>Gjithsej</b>                                                                                                                                                                                           | <b>32</b>            | <b>0:13:25</b> | <b>24</b>                | <b>0:10:32</b> |

Sa u përket mediave komerciale, raporti i ASHMAA konstaton raportim "relativisht të balancuar për aktivitetet e kandidatëve presidencial, me fokus të veçantë mbi kandidatët e dy partive më të mëdha gjatë fushatës në rrethin e parë. Kandidatët janë prezantuar në mënyrë të balancuar edhe sa u përket prezantimeve të drejtpërdrejta. Megjithatë ASHMAA ka konstatuar dukuri të qëndrimeve negative të raportimeve mediatike për kandidatë të caktuar në media të caktuara (p.sh. TV Alfa disa herë gjatë raportimeve për kandidatin Pendarovski dhe për LSDM), si dhe raportime eksplicite negative për aktivitetet e subjekteve politike (p.sh.: TV Sitel për kandidatin Pendarovski dhe për LSDM). Raportimet negative mediatike kryesisht kanë qenë të orientuara kah partia opozitare LSDM dhe kandidatin të saj presidencial. Monitorimi i ASHMAA përfshiu gjashtë televizione komerciale: TV 24 Vesti, TV Alsat-M, TV Alfa, TV Kanal 5, TV Sitel dhe TV Telma.

Gjatë kohë së fushatës, në rrethin e parë, shumica e mediave komerciale të monitoruara, më së shumti kohë i kanë dedikuar raportimeve për aktivitetet e kandidatëve të dy partive më të mëdha, Gjorge Ivanov dhe Stevo Pendarovski. TV Alsat – M më shumë kohë u ka dedikuar raportimeve të aktivitetëve të Iljaz Halimit, në krahasim me kandidatët e tjerë. TV Sitel më shumë kohë, në mënyrë të pabalancuar, i ka kushtuar prezantimit të aktivitetëve të Gjorge Ivanov në krahasim me kandidatët e tjerë. Ai është prezantuar plotë një orë më shumë, me aktivitetet e tij në emisionet informative, në krahasim me kandidatin Stevo Pendarovski. TV Telma më shumë kohë u ka dedikuar aktivitetëve të Stevo Pendarovskit, në krahasim me kandidatët e tjerë. Marrë në përgjithësi, gjatë fushatës, në rrethin e parë, Gjorge Ivanov është prezantuar 3 orë, 43 minuta dhe 51 sekonda në gjashtë mediat komerciale, Stevo Pendarovski 3 orë, 41 minuta dhe 11 sekonda, Iljaz Halimi 2 orë, 31 minuta dhe 44 sekonda dhe Zoran Popovski 2 orë, 18 minuta dhe 47 sekonda (shih: Tabelën 3).

**Tabela 3:** Raportime për kandidatët në emisionet informative në 6 mediat komerciale (rrethi i parë). Burimi: Agjencia për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizive (2014)

| Media           | Gjorge Ivanov  | Stevo Pendarovski | Iljaz Halimi   | Zoran Popovski |
|-----------------|----------------|-------------------|----------------|----------------|
| TV 24 Vesti     | 0:44:16        | 0:47:36           | 0:29:15        | 0:32:15        |
| TV Alsat-M      | 0:36:59        | 0:39:29           | 0:49:10        | 0:32:58        |
| TV Alfa         | 0:28:28        | 0:27:20           | 0:14:41        | 0:12:37        |
| TV Kanal 5      | 0:57:26        | 0:38:08           | 0:20:50        | 0:23:48        |
| TV Sitel        | 1:33:58        | 0:32:32           | 0:20:22        | 0:20:46        |
| TV Telma        | 0:25:44        | 0:36:06           | 0:17:26        | 0:16:23        |
| <b>Gjithsej</b> | <b>3:43:51</b> | <b>3:41:11</b>    | <b>2:31:44</b> | <b>2:18:47</b> |

Në rrethin e dytë, përsëri, shumica e mediave komerciale të monitoruara kanë dedikuar kohë të njëjtë për të dy kandidatët, me përjashtim të TV Kanal 5 e cila ka ndarë dyfish më shumë kohë për Gjorge Ivanov dhe TV Sitel i cili ka ndarë 1 orë, 2 minuta dhe 52 sekonda për Gjorge Ivanov, ndërsa vetëm 8 minuta dhe 41 sekonda raportim për aktivitetet e Stevo Pendarovskit. Gjithashtu, edhe TV Alfa ka ndarë diç më shumë kohë për prezantimin e Gjorge Ivanov. Marrë në përgjithësi, aktivitetet e Gjorge Ivanov janë transmetuar nga mediat komerciale në kohëzgjatje prej gjithsej 1 orë, 39 minuta dhe 25 sekonda, ndërsa aktivitetet e Stevo Pendarovskit në kohëzgjatje prej 1 orë, 17 minuta dhe 31 sekonda (shih: Tabelën 4)

**Tabela 4:** Raportime për kandidatët në emisionet informative në 6 mediat komerciale (rrethi i dytë). Burimi: Agjencia për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizive (2014)

| Media           | Gjorge Ivanov  | Stevo Pendarovski |
|-----------------|----------------|-------------------|
| TV 24 Vesti     | 0:14:04        | 0:14:08           |
| TV Alsat-M      | 0:21:29        | 0:17:57           |
| TV Alfa         | 0:15:55        | 0:09:42           |
| TV Kanal 5      | 0:34:20        | 0:15:13           |
| TV Sitel        | 1:02:52        | 0:08:41           |
| TV Telma        | 0:10:45        | 0:11:50           |
| <b>Gjithsej</b> | <b>1:39:25</b> | <b>1:17:31</b>    |

Sa i përket përfaqësimit të kandidatëve në mediat komerciale me prezantime të drejtpërdrejta në emisione informative gjatë fushatës në rrethin e parë, disbalancë më e madhe vërehet gjatë raportimeve në TV Sitel në favor të Gjorge Ivanovit. Mediat e tjera në përgjithësi kanë manifestuar një qasje të balancuar ndaj të gjithë kandidatëve, sa u përket prezantimeve të drejtpërdrejta. Marrë në përgjithësi, Gjorge Ivanov është përfaqësuar në mediat komerciale me 169 prezantime në kohëzgjatje prej 1 orë, 52 minuta dhe 13 sekonda, Stevo Pendarovski me 146 prezantime, në kohëzgjatje prej 1 orë, 41 minuta dhe 57 sekonda, Iljaz Halimi me 135 prezantime në kohëzgjatje prej 1 orë, 9 minuta dhe 27 sekonda, ndërsa Zoran Popovski me 124 prezantime në kohëzgjatje prej 1 orë, 4 minuta dhe 53 sekonda.

**Tabela 5:** Prezantime të drejtpërdrejta të kandidatëve presidencial në emisionet informative në 6 mediat komerciale (rrethi i parë). Burimi: Agjencia për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizive (2014)

|                 | Gjorge Ivanov |                | Stevo Pendarovski |                | Iljaz Halimi |                | Zoran Popovski |                |
|-----------------|---------------|----------------|-------------------|----------------|--------------|----------------|----------------|----------------|
| Media           | Prezantime    | Koha           | Prezantime        | Koha           | Prezantime   | Koha           | Prezantime     | Koha           |
| TV 24 Vesti     | 24            | 0:16:32        | 20                | 0:18:19        | 21           | 0:13:02        | 20             | 0:12:05        |
| TV Alsat-M      | 33            | 0:16:20        | 32                | 0:19:45        | 35           | 0:20:51        | 27             | 0:14:27        |
| TV Alfa         | 26            | 0:13:36        | 27                | 0:15:15        | 19           | 0:07:10        | 16             | 0:06:41        |
| TV Kanal 5      | 39            | 0:21:07        | 36                | 0:20:24        | 26           | 0:12:25        | 31             | 0:12:14        |
| TV Sitel        | 30            | 0:30:29        | 15                | 0:07:30        | 19           | 0:05:58        | 15             | 0:06:20        |
| TV Telma        | 17            | 0:14:09        | 16                | 0:20:44        | 15           | 0:10:01        | 15             | 0:13:10        |
| <b>Gjithsej</b> | <b>169</b>    | <b>1:52:13</b> | <b>146</b>        | <b>1:41:57</b> | <b>135</b>   | <b>1:09:27</b> | <b>124</b>     | <b>1:04:53</b> |

Sa i përket fushatës, në rrethin e dytë, mediat komerciale i kanë transmetuar prezantimet e drejtpërdrejta të kandidatëve, kryesisht në mënyrë të balancuar me përjashtim të TV Sitel, i cili ka ndarë 19 minuta dhe 41 sekonda për prezantimet e Gjorge Ivanov, ndërsa 1 minutë e 3 sekonda për Stevo Pendarovskin. Marrë në përgjithësi, Gjorge Ivanov ka qenë i përfaqësuar me gjithsej 60 prezantime në kohëzgjatje prej 54 minuta dhe 21 sekonda, ndërkaq Stevo Pendarovski me 52 prezantime në kohëzgjatje prej 29 minuta dhe 14 sekonda (shih: Tabelën 6). Raporti

i ASHMAA nuk përmban të dhëna për numrin e prezantimeve në TV Alfa dhe TV Sitel, megjithatë përmban të dhëna për kohëzgjatjen e atyre prezantimeve.

| <b>Tabela 6:</b> Prezantime të drejtpërdrejta të kandidatëve presidencial në emisionet informative në 6 mediat komerciale (rrethi i dytë). Burimi: Agjencia për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizive (2014) |                                     |                |                                     |                |
|-----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|-------------------------------------|----------------|-------------------------------------|----------------|
|                                                                                                                                                                                                                 | <b>Gjorge Ivanov</b>                |                | <b>Stevo Pendarovski</b>            |                |
| <b>Media</b>                                                                                                                                                                                                    | Обраќања                            | Време          | Обраќања                            | Време          |
| TV 24 Vesti                                                                                                                                                                                                     | 15                                  | 0:07:49        | 13                                  | 0:06:59        |
| TV Alsat-M                                                                                                                                                                                                      | 20                                  | 0:10:30        | 14                                  | 0:06:52        |
| TV Alfa                                                                                                                                                                                                         | /                                   | 0:03:46        | /                                   | 0:02:55        |
| TV Kanal 5                                                                                                                                                                                                      | 16                                  | 0:07:48        | 15                                  | 0:06:15        |
| TV Sitel                                                                                                                                                                                                        | /                                   | 0:19:41        | /                                   | 0:01:03        |
| TV Telma                                                                                                                                                                                                        | 9                                   | 0:04:47        | 10                                  | 0:05:10        |
| <b>Gjithsej</b>                                                                                                                                                                                                 | <b>60</b> (pa TV Alfa dhe TV Sitel) | <b>0:54:21</b> | <b>52</b> (pa TV Alfa dhe TV Sitel) | <b>0:29:14</b> |

Ia vlen të theksohet se gjatë fushatës në rrethin e parë, më 5 prill, u transmetua debati i vetëm në të cilin morën pjesë të gjithë kandidatët presidencial. Debati u transmetua në RTVM 1 si i incizuar. Më 10 prill, TV 24 Vesti transmetoi edhe një debat midis kandidatëve presidencial, në të cilin morën pjesë të gjithë kandidatët, përveç kandidatit të VMRO-DPMNE, Gjorge Ivanov. Shumica e televizioneve komerciale transmetonin edhe intervista të veçanta me kandidatët presidencial.

\*\*\*\*\*

Gjatë fushatës zgjedhore ASHMAA pranoi 60 kundërshtime nga LSDM në lidhje me mediat, të cilat janë hedhur poshtë si të pabaza. Agjencia ka ngritur 12 procedura për kundërvajtje kundër 8 radiodifuzerëve, kryesisht për shkak të së rregullave për reklamim të paguar politik.<sup>57</sup>

<sup>57</sup> OSBE/ODIHR, Misioni Monitorues Ndërkombëtar për Zgjedhjet në Republikën e Maqedonisë, Zgjedhjet Presidenciale dhe Zgjedhjet e Parakohshme Parlamentare 27 prill 2014. (2014) Deklaratë për të dhënat dhe konkluzionet preliminare. Shkup, prill, f. 11 i ak-sesshëm në: <http://www.osce.org/mk/odihr/elections/117647?download=true> (vizituar më 13 maj 2014)

## REZULTATET E ZGJEDHJEVE PRESIDENCIALE

Kandidati i VMRO-DPMNE dhe Presidenti aktual, Gjorge Ivanov, fitoi më së shumti vota në të dy rrethet e zgjedhjeve dhe i fitoi Zgjedhjet Presidenciale 2014. Në rrethin e parë të zgjedhjeve presidenciale, Ivanov fitoi 449.442 vota, përkatësisht 51,69% të votave, ndërsa kandidati i LSDM-së, Stevo Pendarovski, fitoi 326.164 vota, përkatësisht 37,51% të votave. Në rrethin e parë asnjëri nga kandidatët nuk e fitoi shumicën e votave të zgjedhësve të regjistruar, përkatësisht Ivanov fitoi 25,26%, ndërsa Pendarovski 18,33% nga numri i përgjithshëm i zgjedhësve të regjistruar në Listën e Zgjedhësve, me ç'rast u mbajt rrethi i dytë i zgjedhjeve presidenciale.

Kandidati i PDSH-së dhe OPQM-së (GROM) nuk hynë në rrethin e dytë. Kandidati i PDSH-së, Iljaz Halimi, fitoi 38.966 vota, përkatësisht 4,48% të votave, ndërsa kandidati i OPQM-së, Zoran Popovski, fitoi 31.368 vota, përkatësisht 3,61% të votave. Numri i votuesve të cilët në rrethin e parë i bënë të pavlefshme votat e tyre është 23.677, përkatësisht 2,72% të votuesve e kanë bërë këtë. Në rrethin e parë të zgjedhjeve presidenciale në votim dolën më pak se gjysma e zgjedhësve të regjistruar, përkatësisht 869.617 qytetarë që është 48,86% nga gjithsej 1.779.572 qytetarë me të drejtë vote.

| <b>Rrethi i parë<sup>58</sup></b>          | <b>Gjorge Ivanov</b> | <b>Iljaz Halimi</b> | <b>Stevo Pendarovski</b> | <b>Zoran Popovski</b> | <b>Fletëvotime të pavlefshme</b> | <b>Gjithsej</b> |
|--------------------------------------------|----------------------|---------------------|--------------------------|-----------------------|----------------------------------|-----------------|
| <b>Zgjedhës të regjistruar</b>             |                      |                     |                          |                       |                                  | 1.779.572       |
| <b>Zgjedhës të cilët kanë votuar</b>       | 449.442              | 38.966              | 326.164                  | 31.368                | 23.677                           | 869.617         |
| <b>% e zgjedhësve të cilët kanë votuar</b> | 51,69%               | 4,48%               | 37,51%                   | 3,61%                 | 2,72%                            | 100%            |
| <b>% e zgjedhësve të regjistruar</b>       | 25,26%               | 2,19%               | 18,33%                   | 1,76%                 | 1,33%                            | 48,86%          |

<sup>58</sup> Komisioni Shtetëror i Zgjedhjeve, Zgjedhje Presidenciale dhe Zgjedhje të Parakohshme Parlamentare 2014, Zgjedhje Presidenciale – rrethi i parë <http://rezultati.sec.mk/President/Results?cs=mk-MK&r=1&rd=r&eu=All&m=All&ps=All> (vizita e fundit: 15 prill 2014)




Ivanov në rrethin e dytë të zgjedhjeve fitoi 534.910 vota, përkatësisht 55,28% të votave, kandidati i LSDM-së Stevo Pendarovski fitoi 389.077 vota, përkatësisht 41,14% të votave. Në rrethin e dytë 34.707 votues i bënë të pavlefshme votat e tyre, përkatësisht 3,58% të votave. Numri i përgjithshëm i votuesve të cilët votuan në rrethin e dytë është 54,38%, përkatësisht gjithsej votuan 967.676 nga gjithsej 1.779.572 votues të regjistruar. Mbajtja e njëkohshme e zgjedhjeve të parakohshme parlamentare me rrethin e dytë të zgjedhjeve presidenciale kontribuoi që rreth 100 mijë votues më shumë të votojnë në rrethin e dytë sesa në rrethin e parë.

| Rrethi i dytë <sup>59</sup>         | Gjorge Ivanov | Stevo Pendarovski | Fletëvotime të pavlefshme | Gjithsej  |
|-------------------------------------|---------------|-------------------|---------------------------|-----------|
| Zgjedhës të regjistruar             |               |                   |                           | 1.779.572 |
| Zgjedhës të cilët kanë votuar       | 534.910       | 398.077           | 34.707                    | 967.676   |
| % e zgjedhësve të cilët kanë votuar | 55,28%        | 41,14%            | 3,58 %                    | 100%      |
| % e zgjedhësve të regjistruar       | 30,06%        | 22,37%            | 1,95%                     | 54,38%    |

Interesimi i votuesve për të votuar në zgjedhjet presidenciale reduktohet në çdo cikël zgjedhor. Kështu që, përderisa në zgjedhjet e para presidenciale të cilat u mbajtën në vitin 1994, kanë votuar 77,44% e votuesve, në zgjedhjet e vitit 2014 votuan rreth tridhjetë përlind votues më pak në krahasim me zgjedhjet e vitit 1994, më saktësisht 48,86% nga numri i përgjithshëm i votuesve të regjistruar. Mbajtja e njëkohshme e zgjedhjeve presidenciale me zgjedhje të tjera, siç ishte rasti në vitin 2009, kur njëkohësisht u mbajtën edhe zgjedhjet lokale, ashtu sikurse edhe në këtë vit kur rrethi i dytë i zgjedhjeve presidenciale u mbajt bashkë me zgjedhjet e parakohshme parlamentare, kontribuon për një jehonë më të madhe të zgjedhjeve presidenciale.

<sup>59</sup> Komisioni Shtetëror i Zgjedhjeve, Zgjedhje Presidenciale dhe Zgjedhje të Parakohshme Parlamentare 2014, Zgjedhje Presidenciale – rrethi i dytë [http://rezultati.sec.mk/President/Results\\_R2?cs=mk-MK&r=3&rd=r&eu=All&m=All&ps=All](http://rezultati.sec.mk/President/Results_R2?cs=mk-MK&r=3&rd=r&eu=All&m=All&ps=All) (vizita e fundit: 29 prill 2014)



Jehona e Zgjedhjeve Presidenciale në Maqedoni nga viti 1994 deri në vitin 2014<sup>60</sup>

Qytetarët e Republikës së Maqedonisë jashtë vendit për të parën herë patën mundësi ta japin votën e tyre për Zgjedhjet Presidenciale. Megjithatë, për votim jashtë vendit, nuk u manifestua interesim i madh dhe u paraqitën vetëm 8.332 votues. Në rrethin e parë dolën të votojnë më pak se gjysma e tyre, më saktësisht 3.062 votues, që është 44,01% nga votuesit e paraqitur. Në rrethin e dytë dolën të votojnë 4.683 nga votuesit e paraqitur jashtë vendit, përkatësisht 52,42%.

<sup>60</sup> Komisioni Shtetëror i Zgjedhjeve i Republikës së Maqedonisë <http://217.16.84.23/index.php?lang=mk>

## MBROJTJA E TË DREJTËS SË ZGJEDHJES

Kodi Zgjedhor ua garanton mbrojtjen e të drejtës së zgjedhjes, zgjedhësve dhe paraqitësve të listave të kandidatëve për President. Korniza ligjore përcakton mekanizma sipas të cilëve zgjedhësit dhe paraqitësit e listave mund të mbrohen nga shkeljet e të drejtës së zgjedhjes, si dhe sanksione për kundërvajtësit.

Përfaqësuesit e paraqitësve të listave në vendet zgjedhore kanë të drejtë të reagojnë lidhur me parregullsitë eventuale gjatë përgatitjeve si dhe gjatë votimit, me qëllim që të njëjtat të shmangen. Në rastet e këtilla, të gjitha vërejtjet e paraqitësve duhet të evidentohen në procesverbal, me ç'rast ato janë bazë për procedurën e mëtutjeshme në rast të shkeljes së të drejtës së zgjedhjes. Nëse vërejtjet nuk evidentohen në procesverbal, paraqitësit kanë të drejtë t'i paraqesin vërejtjet e njëjta deri te komisionet komunale të zgjedhjeve (KKZ) në afat prej 5 orësh pas nënshkrimit të procesverbalit. Përfaqësuesit e paraqitësve të listave në vendet zgjedhore mund të reagojnë në rast të parregullsive gjatë dorëzimit dhe evidentimit të materialit zgjedhor, gjatë përcaktimit të gjendjes në vendin zgjedhor para fillimit të votimit, si dhe lidhur me punën e këshillave zgjedhore gjatë votimit. Përfaqësuesit e paraqitësve të listave në KKZ kanë të drejtë të paraqesin vërejtje lidhur me parregullsitë gjatë përmbledhjes dhe përcaktimit të rezultateve nga vendet zgjedhore. Këto vërejtje evidentohen në procesverbalin e KKZ dhe janë bazë për procedurën e mëtutjeshme eventuale kundër shkeljes së të drejtës së zgjedhjes.

Procedura për mbrojtjen e të drejtës së zgjedhjes është urgjente. Çdo paraqitës i listës mund të paraqesë kundërshtim deri te Komisioni Shtetëror i Zgjedhjeve (KSHZ) lidhur me procedurat e votimit, përmbledhjen dhe përcaktimin e rezultateve në afat prej 48 orësh pas përfundimit të votimit, përkatësisht publikimit të rezultateve zgjedhore. KSHZ në afat prej 48 orësh, pas pranimi të kundërshtimit, duhet të miratojë vendim, ndërkaq paraqitësi në afat prej 48 orësh mund të ngre padi kundër vendimit të KSHZ deri te Gjykata Administrative.

Zgjedhësit mund të paraqesin kundërshtim deri te KSHZ për shkeljen e të drejtës së zgjedhjes gjatë procedurës së votimit në afat prej 24 orësh pas përfundimit të votimit. KSHZ e ka për detyrë që për këto kundërshtime të vendosë në afat prej 4 orësh pas pranimi të tyre. Zgjedhësi ka të drejtë të ngre padi kundër vendimit të KSHZ deri te Gjykata Administrative në afat prej 24 orësh pas pranimi të aktvendimit. Në rast se zgjedhësi paraqet kundërshtim ndaj veprimeve të këshillit zgjedhor në kohën kur votimi është në rrjedh e sipër dhe nëse KSHZ e konfirmon kundërshtimin, zgjedhësit do t'i mundësohet ta realizojë të drejtën e zgjedhjes.

Gjykata Administrative është instanca e fundit e cila vendos lidhur me kundërshtimin për mbrojtjen e të drejtës së zgjedhjes. Gjykata e miraton vendimin në afat prej 48 orësh pas pranimi të padisë.

Në afatin ligjor prej 48 orësh për paraqitjen e kundërshtimeve nga paraqitësit e listave për kandidat për President, edhe në rrethin e parë edhe në rrethin e dytë deri te KSHZ nuk u paraqit asnjë kundërshtim. Gjithashtu, në afatin ligjor prej 24 orësh për paraqitjen e kundërshtimeve nga ana e zgjedhësve, edhe në rrethin e parë edhe në rrethin e dytë të zgjedhjeve presidenciale deri te KSHZ nuk u paraqit asnjë kundërshtim për shkelje të të drejtës së zgjedhjes.<sup>61</sup>

<sup>61</sup> Deri te KSHZ nuk janë paraqitur kundërshtime për rrethin e parë të zgjedhjeve "Radio Evropa e Lirë" në gjuhën maqedonase, 16 prill 2014 (vizituar më 7 maj 2014) Ivanov edhe zyrtarisht e mori mandatin e dytë presidencial RTM1, 30 prill 2014, (vizituar më 7 maj 2014).

## VLERËSIMI I ZGJEDHJEVE NGA VËZHguesIT

Në rrethin e parë të zgjedhjeve presidenciale u akredituan gjithsej 9.197 vëzhgues vendas dhe 489 vëzhgues të huaj, ndërsa në rrethin e dytë të zgjedhjeve presidenciale, të cilat u mbajtën njëkohësisht me zgjedhjet e parakohshme parlamentare, numri i vëzhguesve vendas u rrit në 10.013, ndërkajsh numri i vëzhguesve të huaj u rrit në 610.<sup>62</sup>

Shoqata për Aktivitete Humanitare SINERGJIA në të dy rrethet i monitoroi zgjedhjet me një numër më të madh të vëzhguesve, 4.970 në rrethin e parë dhe 5.090 në rrethin e dytë. Pas tyre, në rrethin e parë pason Shoqata Qytetare për Demokraci dhe Ngritje të Vetëdijes Kolektive "Lëvizja VEPRO" – Strugë, të cilët në të dy rrethet kishin nga 2321 vëzhgues. Asociacioni Qytetar MOST në rrethin e parë kishte 1.815 vëzhgues, ndërsa në rrethin e dytë kishte misionin vëzhgues, të dytin për nga madhësia, me 2.413 vëzhgues. CIVIL – Qendra për Liri në rrethin e parë kishte 76 vëzhgues, ndërsa në rrethin e dytë 113 vëzhgues. Me një numër të vogël vëzhguesish, në rrethin e dytë, morën pjesë Shoqata PLLOSHTAT SLOBODA me 33 vëzhgues, Instituti për Strategji Ekonomike dhe Marrëdhënie ndërkombëtare OHRID nga Shkupi me 28 vëzhgues, ndërsa Shoqata Qytetare Qendra për Zhvillimin e Mediave Shkup kishte nga 9 vëzhgues në të dy rrethet, Qendra Maqedonase për Kulturë nga 6 vëzhgues në të dy rrethet.

Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë/Zyra për Institucione Demokratike dhe të Drejtat e Njeriut (OSBE/ODIHR), në rrethin e parë kishte 202 vëzhgues, ndërsa 252 vëzhgues në rrethin e dytë, në bashkëpunim me Asamblenë Parlamentare të Këshillit të Evropës, e cila kishte 21 vëzhgues në rrethin e parë dhe 27 në rrethin e dytë e zbatuan misionin vëzhgues më të madh të huaj. Misioni i OSBE-së në Shkup ndaras kishte 91 vëzhgues shtesë në rrethin e parë dhe 103 vëzhgues në rrethin e dytë, ambasadat e: SHBA, Sllovenisë, Suedisë, Bullgarisë,

<sup>62</sup> Shih: Komisioni Shtetëror i Zgjedhjeve, Zgjedhje Presidenciale 2014, Zgjedhje të Parakohshme Parlamentare 2014 [http://217.16.84.23/files/izbori2014/2\\_tabela\\_akreditirani\\_nabljuduvaci.pdf](http://217.16.84.23/files/izbori2014/2_tabela_akreditirani_nabljuduvaci.pdf) dhe [http://217.16.84.23/files/izbori2014/21Tabela\\_na\\_akreditirani\\_nabljuduvaci.pdf](http://217.16.84.23/files/izbori2014/21Tabela_na_akreditirani_nabljuduvaci.pdf) (Vizituar më 24 prill 2014)

Kosovës, Kroacisë, Polonisë, Mbretërisë së Holandës, Serbisë, Malit të Zi, Greqisë, Kinës, Sllovakisë, Gjermanisë, Austrisë, Turqisë, Katarit, Spanjës, Italisë, Francës, Suedisë dhe Delegacioni i Bashkimit Evropian në Maqedoni, gjithashtu i vëzhguan zgjedhjet me një numër më të vogël vëzhguesish. Në rrethin e dytë numri i vëzhguesve nga shtete të tjera u plotësua me përfaqësues të: Ambasadës së Federatës Ruse, Zyrës së NATO-s, Komisionit Qendror të Zgjedhjeve të Gjeorgjisë, Komisionit për Ankesa dhe Parashtresa të Zgjedhjeve të Republikës së Kosovës, Komisionit Qendror të Zgjedhjeve të Republikës së Kosovës, Ambasadës së Shqipërisë dhe Komisionit Qendror të Zgjedhjeve të Republikës së Shqipërisë. Vetëm në rrethin e parë një mision më të vogël vëzhgues me 31 vëzhgues kishte edhe Organizata e Danimarkës SILBA në bashkëpunim me Asociacionin për Progres, Edukim dhe Lobim NEL - Shkup.

Rrethin e parë të zgjedhjeve e ndoqën edhe 28 gazetarë të huaj, përkatësisht gazetarë të Agjencisë "Fokus" dhe Radio "Fokus" nga Bullgaria, "Al Xhezaira – Ballkan", Radio Televizioni i Turqisë "Turk", Radio e Gjermanisë "ARD" dhe TV "Rojters"-Serbi. Në rrethin e dytë numri i gazetarëve u rrit në 42, përkatësisht në mënyrë shtesë u akredituan gazetarë nga "Top Chanel" – Tiranë, Radio Televizioni i Turqisë, Agjencia "Franc Press", "Asoshietet Press", Televizioni "Koha Vizion" – Prishtinë dhe Radio Televizioni i Serbisë.

Vlerësimi i përgjithshëm i Misionit të OSBE/ODIHR, për të dy rrethet e zgjedhjeve presidenciale<sup>63</sup> është se zgjedhjet u zbatuan në mënyrë efikase, ndërsa kandidatët në mënyrë të lirshme kanë mundur ta zhvillojnë fushatën e tyre. Në konferencën për shtyp, të cilën e mbajti Misioni Vëzhgues i OSBE/ODIHR, pas rrethit të dytë të zgjedhjeve presidenciale dhe zgjedhjeve të parakohshme parlamentare, përfaqësuesit e Misionit vunë në pah se bojkoti, të cilin e paralajmëroi opozita fill pas përfundimit

<sup>63</sup> Shih: Dy raportet e Misionit të OSBE/ODIHR: Misioni Ndërkombëtar Vëzhgues për Zgjedhjet në Ish-Republikën Jugosllave të Maqedonisë, Zgjedhje Presidenciale, 13 prill 2014. Deklaratë për të dhënat dhe konstatimet preliminare. (Vizituar më 14 prill 2014) <http://www.osce.org/mk/odihr/elections/117647?download=true> dhe: Misioni Ndërkombëtar Vëzhgues për Zgjedhjet në Ish-Republikën Jugosllave të Maqedonisë (MNVZ), Zgjedhje Presidenciale dhe Zgjedhje të Parakohshme Parlamentare, 27 prill 2014. Deklaratë për të dhënat dhe konstatimet preliminare. <http://www.osce.org/mk/odihr/elections/fyrom/118079?download=true> (Vizituar më 28 prill 2014);

të zgjedhjeve, nuk është instrument demokratik dhe se partitë politike duhet të përdorin mjete politike.<sup>64</sup>

Dita e votimit nga ana e OSBE/ODIHR u vlerësua si pozitive dhe mirë e organizuar, si për rrethin e parë ashtu edhe për rrethin e dytë të zgjedhjeve presidenciale, për ato vendvotime të cilat i kanë vëzhguar. Në Raportin e OSBE/ODIHR është theksuar se, në rrethin e parë, në të gjitha komunat e vizituara votimi dhe përmbledhja e votave është zhvilluar mirë dhe në mënyrë transparente, përveç në Komunën e Shuto Orizarës në të cilën janë vërejtur një numër i madh i parregullsive. Në Raportin për rrethin e dytë është theksuar se parregullsi kryesore që është vërejtur ka qenë votimi grupor. Gjithashtu, theksohet se në rrethin e dytë këshillat zgjedhorë nuk i kanë përcjellë instruksionet e KSHZ-së që tua bëjnë me dije votuesve se mund të votojnë për njërën prej zgjedhjeve ose për të dyja zgjedhjet, ndërsa në zonat, në të cilat jetojnë kryesisht shqiptarë etnikë, këshillat zgjedhorë u kanë sugjeruar votuesve të mos e marrin fletëvotimin për zgjedhjet presidenciale. OSBE/ODIHR ka potencuar se në të dy rrethet ka pasur raste kur disa të burgosur edhe pse kanë pasur letërnjoftime të vlefshme nuk kanë qenë të përfshirë në Listën e Zgjedhësve dhe për këtë shkak nuk kanë mundur të votojnë.

MOST<sup>65</sup> vlerësoi se dita e votimit, në të dy rrethet, ka kaluar qetë dhe se ka përmirësime në mënyrën se si zbatohen procedurat e hapjes së vendeve të votimit, procedurat e votimit dhe numërimit të votave. Për votimin në rrethin e parë MOST vë në pah përsëritjen e praktikës së këshillave zgjedhorë që me zë t'i lexojnë emrat e votuesve, me çka cenohet fshehtësia e votës, prezencën e personave të cilët i kanë evidentuar votuesit para objekteve në të cilat janë vendosur vendet e votimit, por edhe se ka pasur një numër më të vogël të rasteve të votimit familjar,

<sup>64</sup> Radio Evropa e Lirë, OSBE - Zgjedhje të zbatuara në mënyrë efikase, por problemet mbeten, e mërkurë 30 prill 2014 <http://www.makdenes.org/content/article/25365682.html> (Vizituar më 28 prill 2014)

<sup>65</sup> Shih: Dy deklaratat preliminare të MOST: Deklarata preliminare - 12.30 - 14.04.2014 <http://www.most.org.mk/index.php/mk/ongoing-projects/-2014/307--1230-14042014> (Vizituar më 14 prill 2014) Asociacioni Qytetar MOST, Zgjedhje Presidenciale dhe Zgjedhje të Parakohshme Parlamentare 2014, Deklarata preliminare 28.04.2014, Shkup [http://most.org.mk/images/MOST/Preliminarna%20izjava\\_vtor%20krug\\_28%2004%202014\\_MKD.pdf](http://most.org.mk/images/MOST/Preliminarna%20izjava_vtor%20krug_28%2004%202014_MKD.pdf) (Vizituar më 28 prill 2014)

në krahasim me zgjedhjet paraprake. MOST ka vërejtur se në rrethin e parë 1.268 persona nuk kanë mundur ta gjejnë vetveten në Listën e Zgjedhësve. Në rrethin e dytë MOST ka vërejtur se, në krahasim me rrethin e parë, ka pasur më shumë raste të votimit grupor dhe familjar, ka pasur presion mbi votuesit që të dalin të votojnë, si dhe ka pasur agjitime dhe evidentim të votuesve. Ashtu si edhe OSBE/ODIHR edhe MOST ka vërejtur se në rrethin e dytë këshillat zgjedhorë kanë ndikuar tek votuesit se për cilat zgjedhje të votojnë.

Misioni i OSBE/ODIHR fushatën e vlerësoi si aktive dhe inkluzive. Vërejtja kryesore ndaj fushatës së kandidatit presidencial Ivanov është se ka pasur mbështetje të qartë dhe të dukshme nga Qeveria, me ç'rast është shkelur paragrafi 5.4 nga Dokumenti i Kopenhagës të OSBE nga viti 1990, si dhe standardet e Këshillit të Evropës me të cilat kërkohet ndarja e partisë nga shteti. Në raport gjithashtu, apostrofohet se të gjitha fushatat kanë qenë të orientuara kah votuesit e bashkësive të tyre etnike, me përjashtim të fushatës së kandidatit presidencial Pendarovski, e cila ka qenë e orientuar edhe në drejtim të bashkësisë etnike shqiptare, ndërkaq nëpër mitingje, në mesin e të pranishmëve, kryesisht kanë dominuar burra. Gjuha e përdorur në fushatë u vlerësua si e matur dhe e civilizuar, me rritjen e toneve negativ kah fundi i fushatës. Misioni i OSBE/ODIHR ka evidentuar një numër të caktuar të konstatimeve për presion mbi të punësuarit në administratën publike që të marrin pjesë në ngjarjet e fushatës, premtime ose kërcënime për punësim, kërkesa nga nëpunësit shtetërorë të sigurojnë listë të votuesve të cilët kanë votuar për partinë në pushtet dhe ngjashëm, të cilat Misioni i konsideron si të besueshme.

MOST si vërejtje kryesore negative të fushatës e ka potencuar fushatën e filluar para kohe dhe se në fushatat e të gjitha subjekteve politike janë keqpërdorur të miturit. Si vërejte pozitive, në rrethin e parë të zgjedhjeve presidenciale, Raporti thekson një intensitet më të vogël të fushatës negative dhe përdorim më të vogël të automjeteve zyrtare. Për fushatën e cila u zhvillua në rrethin e dytë, MOST e apostrofon përdorimin e automjeteve zyrtare nëpër mitingje, acarimin e fushatës, zhvillimin e

fushatës negative, mobilizimin e votuesve në baza etnike, demolimin e katër shtabeve partiake dhe incidente midis aktivistëve partiak.

Punën e Komisionit Shtetëror të zgjedhjeve Misioni i OSBE/ODIHR e vlerësoi si efikase dhe transparente, mirëpo në disa raste janë mbajtur seanca në të cila KSHZ-ja nuk i ka ftuar të marrin pjesë mediat dhe vëzhguesit. Vërejtja kryesore është se ka pasur ndarje të dukshme midis anëtarëve të KSHZ-së të partive të ndryshme politike dhe votim në baza partiake për të gjitha çështjet me peshë politike, gjë të cilën e ka vërejtur edhe MOST, e cila gjithashtu ka theksuar se në këtë cikël zgjedhor KSHZ-ja ka qenë më pak transparente sesa paraprakisht. Raporti i OSBE/ODIHR e kritikon edhe komunikimin e dobët të KSHZ-së me komisionet komunale të zgjedhjeve në të dy rrethet zgjedhore, e që ka çuar në konfuzion sa u përket procedurave. MOST vëmendje të veçantë i përkushton asaj se KSHZ-ja nuk i ka publikuar të dhënat e këqyrjes publike mbi Listën e Zgjedhësve për të dy ciklet zgjedhore, dhe prandaj MOST ka paraqitur kërkesë për qasje në informatat me karakter publik, por deri në publikimin e Raportit nuk kanë marrë përgjigje.

Monitorimi i mediave nga ana e OSBE/ODIHR ka treguar se ka dallim midis informimit kuantitativ dhe kualitativ të pjesëmarrësve të fushatës zgjedhore nga ana e mediave, mungesë të analizës, mungesë të informimit të pavarur dhe njëanshmëri kah VMRO-DPMNE në pushtet dhe kandidatit Ivanov, qëndrim negativ ndaj LSDM-së dhe kandidatit Pendarovski, ndërsa midis mediave në gjuhën shqipe njëanshmëri kah BDI. Ata kanë konkluduar se servisi publik, përmes programeve të veta RTVM 1 dhe RTVM 2, ka qenë i njëanshëm kah kandidati Ivanov, ndërkaq neutral kah kandidatët e tjerë, ndërsa në programin e RTVM 2 i është dhënë hapësirë e gjerë aktiviteteve të BDI-së dhe fushatës së tyre për të mos votuar. Raporti, gjithashtu, vlerëson se televizionet: "Sitel", "Kanal 5" dhe "Alfa" kanë pasur qëndrim pozitiv ose neutral gjatë raportimeve për Ivanovin, ndërsa qëndrim negativ gjatë raportimeve për kandidatin Pendarovski. Po ashtu, është apostrofuar se këto tri media publikojnë tema të caktuara me përmbajtje të ngjashme kundër LSDM-së dhe kjo

interpretohet se të njëjtat janë rezultat i burimeve të pidentifikuara ose anonime. Televizionet "Telma", "Vesti 24" dhe Alsat M" u vlerësuan se kanë raportuar në mënyrë të balancuar, neutrale dhe me një proporcion të ngjashëm për kundër-kandidatët kryesorë.

Delegacioni i Bashkimit Evropian dhe Ambasada e SHBA-së në Republikën e Maqedonisë dolën me deklaratë të përbashkët me vlerësim dhe koment për zgjedhjet.<sup>66</sup> Deklarata përmban mirënjohje për qytetarët të cilët e shfrytëzuan të drejtën e tyre të votës dhe e përsëritën vlerësimin e OSBE/ODIHR lidhur me efikasitetin e zgjedhjeve, njëanshmërisë mediatike, bashkimit të aktiviteteve shtetërore dhe partiake. Përfaqësuesit e BE-së dhe SHBA-së shpresojnë se qeveria e ardhshme do t'i adresojë këto vërejtje, si dhe shpresojnë se të gjithë liderët politikë do të kenë qasje konstruktive sa u përket reformave lidhur me integrimin euroatlantik të vendit.

<sup>66</sup> Ambasada e Shteteve të Bashkuara të Amerikës, Shkup, Komunikatë për media 2014, Deklaratë e përbashkët e Delegacionit të BE-së dhe Ambasadës së SHBA-së, 29 prill 2014. <http://photos.state.gov/libraries/macedonia/8573/ArchivePDFsApril2014/pr04292014mac.pdf> (Vizituar më 2 maj 2014)



## VLERËSIMI I ZGJEDHJEVE NGA PARTITË POLITIKE

Sa i përket mbajtjes së rrethit të parë të zgjedhjeve presidenciale, partitë politike të cilat garuan, si dhe vet kandidatët dolën para publikut me vlerësime të ndryshme lidhur me zbatimin e zgjedhjeve në ditën e zgjedhjeve dhe periudhën parazgjedhore. Partia në pushtet, VMRO-DPMNE, i vlerësoi zgjedhjet si të qeta, të ndershme dhe demokratike, ndërsa partia opozitare LSDM akuzoi për "vjedhje sistematike të votave". PDSH-ja e kritikoi daljen e dobët të elektoratit shqiptar, duke e paraqitur këtë si presion mbi votuesit nga partia më e madhe e shqiptarëve etnik, BDI. Partia OPQM (GROM), e cila për të parën herë mori pjesë në zgjedhje, rrethin e parë e vlerësoi si "relativisht të ndershëm dhe demokratik", por shprehu dyshime për ekzistimin e një numri të madh të fletëvotimeve të pavlefshme.

VMRO-DPMNE zgjedhjet e rrethit të parë i vlerësoi si të qeta, të ndershme dhe demokratike. Partia shprehu kënaqësi për rezultatet e realizuara dhe i thirri qytetarët për një mbështetje akoma më të madhe në rrethin e dytë. Lideri i VMRO-DPMNE, Nikolla Gruevski, pas mbylljes së vendvotimeve, deklaroi se rezultati i zgjedhjeve të rrethit të parë jep shpresë se më 27 prill, përveç fitores të zgjedhjeve presidenciale në rrethin e dytë, partia do të arrijë të fitojë 62 mandate të deputetëve në kuadër të Zgjedhjeve të Parakohshme Parlamentare.<sup>67</sup> Presidenti aktual i Republikës së Maqedonisë dhe kandidat në zgjedhje, i mbështetur nga VMRO-DPMNE, Gjorge Ivanov, u shprehu falënderime votuesve dhe porosi se pas rrethit të parë zgjedhor "Maqedonia është fituesi më i madh". Në konferencën e mbajtur për shtyp, Ivanov potencoi se zgjedhjet ishin të qeta, të ndershme dhe demokratike.<sup>68</sup>

Nga ana tjetër, LSDM-ja opozitare zgjedhjet e rrethit të parë i vlerësoi si jo të ndershme dhe jodemokratike. Lideri Zoran Zaev deklaroi se rezultati i zgjedhjeve, sipas partisë por edhe sipas mendimit të shumicës së

qytetarëve është i papritur, si dhe se është zbatuar "vjedhje sistematike e votave".<sup>69</sup> Kandidati presidencial, Stevo Pendarovski deklaroi se është i bindur se edhe në kushte të presioneve sistematike dhe kërcënimeve sistematike e shantazheve mund të arrihet deri në fitore në rrethin e dytë.<sup>70</sup> Partia më e madhe opozitare dërgoi mesazh deri te qytetarët për vazhdimin e luftës kundër pushtetit aktual në rrethin e dytë të zgjedhjeve presidenciale.

PDSH-ja, e cila në garën presidenciale e mbështeti kandidatin e vetëm etnik shqiptar, Iljaz Halimin, shprehu kënaqësi nga numri i votave të fituara, por e kritikoi jehonën e dobët të elektoratit shqiptar. Lideri i PDSH-së, Menduh Thaçi, daljen e dobët e shpjegoi me presionet e BDI-së mbi votuesit shqiptarë që të mos dalin në zgjedhje, duke deklaruar se "dalja zero" në vende të caktuara zgjedhore është "pasqyrë e diktaturës". Kandidati presidencial, Iljaz Halimi, deklaroi se i respekton edhe ata votues shqiptarë të cilët nuk kanë dalë të votojnë dhe solidarizohet me të njëjtit "me arsyet e tyre dhe me çdo gjë që është bërë mbi ta".<sup>71</sup>

Partia OPQM (GROM), e cila e mbështeti kandidatin Zoran Popovski, menjëherë pas përfundimit të ditës së zgjedhjeve të rrethit të parë, zgjedhjet i vlerësoi si "relativisht të ndershme dhe demokratike".<sup>72</sup> Lideri i OPQM-së, Stevçe Jakimovski, fushatën zgjedhore e vlerësoi si "korrekte", por reagoi për numrin e madh të fletëvotimeve të pavlefshme, në të cilat, siç tha ai, ishte rrethuar kandidati i tyre.<sup>73</sup> Ndërkaq, kandidati

<sup>69</sup> Zaev: Ky nuk është vullneti i popullit, do ta kuptojnë këtë më 27 prill. Deklaratë, 13 prill 2014, i aksesshëm në ueb – faqen e LSDM: <http://sdsm.org.mk/default.aspx?mId=55&gId=5&articleId=10456> (vizituar më 7 maj 2014)

<sup>70</sup> Pendarovski: Lufta nuk ka përfunduar. Deklaratë për media, 13 prill 2014, i aksesshëm në ueb-faqen e LSDM: <http://sdsm.org.mk/default.aspx?mId=55&gId=5&articleId=10455> (vizituar më 7 maj 2014)

<sup>71</sup> Thaçi: Zero dalje në disa vende është pasqyrë e diktaturës. "Utrinski vesnik", 13 prill 2014, <http://www.utrinski.mk/default.asp?ItemID=A18BD7D10D49B6458CE36841CBFE657B> (vizituar më 7 maj 2014); PDSH: Vazhdojmë me aktivitetet për fitore në zgjedhjet parlamentare. RTVM1, 14 prill 2014, <http://www.mrt.com.mk/node/7569> (vizituar më 7 maj 2014).

<sup>72</sup> OPQM (GROM): Zgjedhjet relativisht të ndershme dhe demokratike. TV "Alfa", 13 prill 2014, <http://www.alfa.mk/News.aspx?ID=74995#.U2oJD1cj7To> (vizituar më 7 maj 2014).

<sup>73</sup> OPQM (GROM): Njollë e zgjedhjeve janë fletëvotimet e pavlefshme. Lokalno.mk, 14.04.2014, <http://lokalno.mk/grom-damka-na-izborite-se-nevazhechkite-livchinja/> (vizituar më 7 maj 2014).

<sup>67</sup> Gruevski: Populli tregoi se cilat vlera i mbështet, RTVM1, 13 prill 2014, <http://www.mrt.com.mk/node/7544> (vizituar më 7 maj 2014).

<sup>68</sup> Ivanov: Maqedonia është fituesja më e madhe. Ueb – faqja e Gjorge Ivanovit për zgjedhje, 14 prill 2014: <http://ivanov.mk/web/?p=949> (vizituar më 7 maj 2014)

Zonan Popovski, deklaroi se përmes zgjedhjeve presidenciale, OPQM-ja ka dëshmuar se është faktor në skenën politike.<sup>74</sup> Partia dhe lideri e përgëzuan Ivanovin dhe Pendarovskin për suksesin e tyre në rrethin e parë të zgjedhjeve presidenciale.<sup>75</sup>

Dy partitë më të mëdha, VMRO-DPMNE dhe LSDM, kandidatët e të cilëve garuan në rrethin e dytë të zgjedhjeve presidenciale, në publikë dolën me vlerësime radikalisht të kundërta edhe për pjesën e dytë të garës zgjedhore. Mbivendosja e rrethit të dytë të zgjedhjeve presidenciale me ato parlamentare mundësoi që vlerësimet e partive, në masë të madhe, të mbivendose mbi dy fushat e veçanta të garës. Për Koalicionin qeveritar "Për Maqedoni më të Mirë" i udhëhequr nga VMRO-DPMNE dhe për kandidatin presidencial Gjorge Ivanov zgjedhjet ishin të qeta, të ndershme dhe demokratike. Nga ana tjetër, për LSDM dhe opozitën e bashkuar, si dhe për kandidatin Stevo Pendarovski, zgjedhjet ishin të pandershme, jodemokratike dhe "kriminale". Partitë e tjera në përgjithësi u përmbajtën nga komentet për procesin zgjedhor të rrethit të dytë të zgjedhjeve presidenciale.<sup>76</sup>

Konferenca për shtyp, menjëherë pas përfundimit të zgjedhjeve në ditën e mbajtjes së zgjedhjeve të rrethit të dytë, mbajtën edhe VMRO-DPMNE edhe LSDM. Presidenti aktual dhe kandidati presidencial Gjorge Ivanov mbajti konferencë për shtyp po atë natë, pas përfundimit të ditës zgjedhore, ndërsa kandidati Stevo Pendarovski konferencën për shtyp e mbajti të nesërmen, më 28 prill.

Në konferencën për shtyp, të mbajtur menjëherë pas përfundimit të zgjedhjeve, në ditën e mbajtjes së zgjedhjeve, më 27 prill, kandidati për deputet dhe bartës i listës së VMRO-DPMNE, Antonio Milloshoski

procesin zgjedhor e kualifikoi si proces zgjedhor të qetë, të ndershëm dhe demokratik. Milloshoski deklaroi se "qytetarët treguan se kanë vetëdije demokratike dhe konfirmuan me vepër se dinë të përcaktojnë se çka është interes i tyre dhe interes i shtetit. Gjithashtu, Milloshoski deklaroi se LSDM-ja dhe lideri Zaev kanë bërë përpjekje për fabrikimin e skenarit për parregullsi zgjedhore, të cilën qytetarët e kanë identifikuar si të tillë.<sup>77</sup>

Më vonë, më 27 prill, në një konferencë të veçantë për shtyp, publikut iu drejtua lideri i VMRO-DPMNE, Nikolla Gruevski dhe kandidati presidencial Gjorge Ivanov. Gruevski potencoi se sikurse edhe në rrethin e parë të zgjedhjeve, ashtu edhe në rrethin e dytë Maqedonia ka pasur zgjedhje të suksesshme dhe i karakterizoi si zgjedhje të qeta, të ndershme dhe demokratike. Në fjalën e tij, Gruevski i përgëzoi qytetarët për ditën e qetë të zgjedhjeve, ndërsa fitoren e VMRO-DPMNE dhe Koalicionit "Për Maqedoni më të Mirë" e karakterizoi si të dyfishtë – të siguruar edhe në zgjedhjet presidenciale edhe në zgjedhjet parlamentare.<sup>78</sup> Gjorge Ivanov nënvizoi se në zgjedhje "fitoi demokracia, qytetarët, Maqedonia. Patëm zgjedhje të qeta, të ndershme dhe demokratike, ashtu siç i kanë hije Maqedonisë, Maqedonisë evropiane".<sup>79</sup>

Menjëherë pas mbylljes së vendeve të votimit dhe para se të numëroheshin votat e rrethit të dytë, kryetari i LSDM-së opozitare, Zoran Zaev, e paraqiti para publikut qëndrimin e LSDM-së dhe opozitës së bashkuar për ditën e zgjedhjeve. Zaev vuri në pah keqpërdorimin e sistemit shtetëror në shërbim të interesave partiake të partisë në pushtet, uzurpimin e së drejtës së qytetarëve për shprehje të lirë të vullnetit, mitosje të votuesve, presione mbi punonjësit e administratës publike, pranuesve të asistencës sociale dhe firmave, votim të të ashtuquajturve "votues fantazma", agjitim të liderëve fetar, keqpërdorim të servisit radiodifuziv dhe dezinformim

<sup>74</sup> Popovski: OPQM (GROM) tregoi se është faktor në skenën politike. "Radio Evropa e Lirë" në gjuhën maqedonase, 13 prill 2014, <http://www.makdenes.org/archive/news/20140413/428/428.html?id=25331803> (vizituar më 7 maj 2014).

<sup>75</sup> Përgëzime nga OPQM (GROM) për Ivanovin dhe Pendarovskin. TV "Sitel", 13 prill 2014, <http://www.sitel.com.mk/mk/chestitki-od-grom-za-ivanov-i-pendarovski> (vizituar më 7 maj 2014).

<sup>76</sup> Reagimet e partive për zgjedhjet parlamentare janë të aksesshme në Manualin për Zgjedhjet Parlamentare të Republikës së Maqedonisë 2014.

<sup>77</sup> VMRO-DPMNE: Fituan qytetarët, patëm zgjedhje të qeta dhe të ndershme. "Dnevnik", 27 prill 2014, i aksesshëm në: <http://www.dnevnik.mk/default.asp?ItemID=FCA9C798EE508648B7BAE3B60B977D83> (vizituar më 5 maj 2014).

<sup>78</sup> Gruevski dhe Ivanov: Fitues më i madh është Maqedonia. "Nova TV", 28 prill 2014, <http://novatv.mk/index.php?navig=8&cat=23&vest=13677> (vizituar më 7 maj 2014).

<sup>79</sup> Ivanov: Në këto zgjedhje fitoi demokracia, qytetarët, Maqedonia. Ueb-faqja e Gjorge Ivanov për zgjedhjet, 28 prill 2014: <http://ivanov.mk/web/?p=1326> (vizituar më 5 maj 2014).

të publikut nga ana e mediave private proqeveritare. Në kontekst të zbatimit të procesit zgjedhor, Zaev lëshoi akuza edhe për ekzistimin e fletëvotimeve të dyfishta, fotografimin e fletëvotimeve, fshirjen e bojës nga gishti, votimin grupor, si dhe shumë parregullsi të tjera. Lideri i LSDM-së tha se zgjedhjet presidenciale dhe parlamentare nuk do të njihen nga ana e LSDM-së dhe opozitës së bashkuar dhe kërkoi formimin e qeverisë teknike e cila do ta zbatonte procesin zgjedhor.<sup>80</sup>

Në një konferencë të veçantë, më 28 prill, një ditë pas mbajtjes së rrethit të dytë të zgjedhjeve presidenciale, kandidati për president i LSDM-së, Stevo Pendarovski, shprehu qëndrimin e tij për zgjedhjet presidenciale. Në fjalën e tij, drejtuar publikut, Pendarovski akuzoi për shkeljen e të drejtës së shprehjes së lirë të vullnetit të qytetarëve, për mitosje dhe presione mbi votuesit, por iu falënderua atyre qytetarëve të cilët e kanë dhënë votën e tyre për kandidatin e opozitës duke e barazuar të njëjtën me "akt të guximit personal". Kandidati presidencial shprehu mbështetje të plotë sa u përket kualifikimeve të procesit zgjedhor të cilët një ditë më parë i komunikoi lideri i LSDM. Pendarovski e komentoi edhe sjelljen e përfaqësuesve të bashkësisë ndërkombëtare për të cilët tha se "janë vetëm vëzhgues pasiv të proceseve retrograde politike në Republikën e Maqedonisë" dhe kërkoi nga ata që resurset, angazhimet dhe kohën e tyre ta orientojnë kah pushteti aktual si gjenerator i krizës në politikën maqedonase. Pendarovski vuri në pah se bashkësia ndërkombëtare më pak duhet të interesohet për veprimin e opozitës, përkatësisht vëmendjen duhet ta përqendrojë tek veprimet e partive në pushtet.<sup>81</sup>

Më 2 maj, kur KSHZ-ja ia dorëzoi certifikatën për zgjedhje të Presidentit Gjorgje Ivanovit, LSDM doli para publikut me komunikatë, me ç'rast zgjedhjen e Ivanovit e karakterizoi si "i zgjedhur në funksionin President i Republikës së Maqedonisë në zgjedhje kriminale, të pandershme dhe jodemokratike". Përmes komunikatës së njëjtë, LSDM-ja u prononcua

se nuk e njeh zgjedhjen e Ivanovit për President të Republikës së Maqedonisë.<sup>82</sup>

## KONKLUZIONE

Zgjedhjet Presidenciale të vitit 2014 në Maqedoni, në përgjithësi kaluan në atmosferë të qetë dhe pa incidente të mëdha. Fushata u karakterizua me promovim pozitiv të kandidatëve por edhe me një dozë të caktuar të ashtuquajtur fushatë "negative", përmes së cilës kandidatët përpiqeshin të prezantohen si antipod të oponentëve të tyre politikë. Gjorge Ivanov, i cili sërish u zgjodh në funksionin e Presidentit, fushatën e tij e orientoj kah çështjet kombëtare, siç janë ruajtja e emrit kushtetues të vendit dhe mbrojtja e identitetit maqedonas. Ai, në fushatën e tij, nënvizoi se midis institucioneve të shtetit duhet të ketë bashkëpunim dhe unitet gjë që, siç e shpjegonte ai, është dëshmuar në punën e tij dhe punën e Qeverisë, si një përqasje e cila ka dhënë rezultate. Kandidati i partisë opozitare LSDM, Stevo Pendarovski, përmes fushatës së tij e sfidonte konceptin e partisë në pushtet VMRO-DPMNE dhe përpiqej që të prezantohet para votuesve si Presidenti ardhshëm i cili do të ishte një kundërbalancë i politikave të partisë në pushtet. Fushata e Pendarovskit, në një masë të caktuar, u orientua edhe në drejtim të bashkësive të tjera etnike, përveç asaj maqedonase. Shqiptari i vetëm në garën presidenciale, Iljaz Halimi, nga partia opozitare PDSH, tërë fushatën e tij e orientoj në drejtim të shqiptarëve etnik dhe u fokusua mbi çështjet e rëndësishme për këtë bashkësi etnike. Zoran Popovski, kandidat i partisë jashtëparlamentare OPQM, u prezantua si kandidat i cili nuk do të lejojë shpenzime të papërgjegjshme të parave të popullit, do të promovojë kushte më të mira për bizneset vendore dhe për të rinjtë dhe se do të jetë avokati i qytetarëve. Paralelisht me fushatat e katër kandidatëve presidencial, partia më e madhe e shqiptarëve etnikë, pjesë e koalicionit qeveritar, BDI, zbatoi fushatë në të cilën apelonte deri te shqiptarët etnikë t'i bojkotojnë zgjedhjet dhe e promovoi idenë për të ashtuquajturin "President konsensual", përkatësisht president të

<sup>80</sup> Zaev: Nuk e njohim procesin zgjedhor, qeveri teknike për zgjedhje të ndershme. Konferencë për shtyp, 27 prill 2014, i aksesshëm në ueb-faqen e LSDM: <http://sdsm.org.mk/default.aspx?mId=55&agId=5&articleId=10576> (vizituar më 5 maj 2014).

<sup>81</sup> Pendarovski: Synoj që pa rëterime ta mbroj konceptin për një Maqedoni të lirë. Konferencë për shtyp, 28 prill 2014, i aksesshëm në ueb-faqen e LSDM: <http://sdsm.org.mk/default.aspx?mId=55&agId=5&articleId=10580> (vizituar më 5 maj 2014).

<sup>82</sup> LSDM nuk e njeh Gjorge Ivanov-in për President të Republikës së Maqedonisë. Komunikatë për publikun, 2 maj 2014, i aksesshëm në ueb-faqen e LSDM: <http://sdsm.org.mk/default.aspx?mId=55&agId=2&articleId=10589> (vizituar më 5 maj 2014).

pranueshëm për të gjithë qytetarët e Maqedonisë pa dallim të përkatësisë etnike.

Prej të gjithë kandidatëve presidencial, fushatë më të kushtueshme zgjedhore zbatoi Gjorge Ivanov, i cili deri në fund të rrethit të dytë shpenzoi 47.394.082 denarë (766.895 euro). Oponenti i tij kryesor Stevo Pendarovski zbatoi një fushatë me vlerë prej 9.392.108 denarë (151.976 euro). Kandidatët, të cilët nuk hynë në rrethin e dytë, Iljaz Halimi dhe Zoran Popovski shpenzuan 509.226 denarë (8.240 euro) dhe 830.000 denarë (13.430 euro), në mënyrë përkatëse.

Ashtu sikurse edhe në ciklet paraprak zgjedhor, mediat kishin një rol të rëndësishëm në krijimin e opinionit publik. Raportet e aksesshme nga monitorimi i mediave në ciklin zgjedhor treguan mospasje të balancit gjatë raportimeve mediatike, që është në kundërshtim me kërkesat e kuadrit ligjor. Edhe pse shumica e mediave, nga aspekti kuantitativ i përmbushnin kriteret ligjore për raportimin e kandidatëve, nga aspekti kualitativ raportimi shënon mangësi serioze. Mediat, në kuadër të servisit publik radiodifuziv, raportonin në mënyrë të theksuar dhe pozitive për fushatën e partive në pushtet VMRO-DPMNE dhe BDI, ndërkaq në mënyrë neutrale për aktorët e tjerë në ciklin zgjedhor. Mediat komerciale në përgjithësi raportonin në favor të partisë në pushtet VMRO-DPMNE, duke pasur një qëndrim negativ për aktivitetet e Stevo Pendarovskit dhe partisë opozitare LSDM. Megjithatë, disa media arritën të kenë qëndrime neutrale gjatë raportimeve dhe prezantimeve të kandidatëve. Edhe ky cikël zgjedhor tregoi se raportimi mediatik është objekt i mangësive serioze dhe se edhe më tutje mbetet një sfidë serioze për demokracinë maqedonase.

Zgjedhjet u karakterizuan me një dalje të ulët në zgjedhje në rrethin e parë, më të ulët në historikun e zgjedhjeve presidenciale. Kjo pjesërisht ka të bëjë me bojkotin e zgjedhjeve nga një pjesë e votuesve shqiptarë etnik, i iniciuar nga BDI. Në rrethin e parë të votimit dolën 48.86% nga zgjedhësit e regjistruar. Në rrethin e dytë të votimeve dalja në zgjedhje u përmirësua dhe arriti në 54.38% që është më shumë nga dalja në

rrethin e dytë të Zgjedhjeve Presidenciale nga viti 2009. Mbivendosja e rrethit të dytë të zgjedhjeve presidenciale me zgjedhjet e parakohshme parlamentare pati ndikim pozitiv mbi daljen e votuesve. Votimi jashtë vendit nuk zgjoi interesim të madh tek qytetarët të cilët një kohë të gjatë qëndrojnë jashtë kufijve të Republikës së Maqedonisë.

Në rrethin e parë më së shumti vota fitoi Gjorge Ivanov, 51.69% të fletëvotimeve dhe Stevo Pendarovski i cili fitoi 37.51%. Iljaz Halimi fitoi 4.48%, ndërsa Zoran Popovski 3.61%. 2.72% të fletëvotimeve u shpallën për të pavlefshme. Në rrethin e dytë më së shumti vota fitoi Gjorge Ivanov, gjithsej 55.28% nga fletëvotimet. Stevo Pendarovski fitoi 41.14% të votave. 3.58% të fletëvotimeve u shpallën për të pavlefshme.

Gjorge Ivanov, në rrethin e dytë, u zgjodh me votat e 30.06% nga numri i përgjithshëm i votuesve të regjistruar në Listën unike të Zgjedhësve.

Pranë Komisionit Shtetëror të Zgjedhjeve (KSHZ) në afatet e parashikuara nuk arriti asnjë kundërshtim për shkelje të të drejtës së zgjedhjes, as nga paraqitësit e listave të kandidatëve për president, dhe as nga qytetarët – votues.

Rrethin e parë të zgjedhjeve presidenciale e monitoruan gjithsej 9.197 vëzhgues vendor dhe 489 vëzhgues të huaj, ndërsa në rrethin e dytë të zgjedhjeve presidenciale, i cili u mbajt njëkohësisht me zgjedhjet e parakohshme parlamentare, numri i vëzhguesve vendor u rrit në 10.013, ndërsa numri i vëzhguesve të huaj u rrit në 610.

Vlerësimi i përgjithshëm i misioneve monitoruese, veçanërisht ato të OSBE/ODIHR dhe i Asociacionit vendor MOST, konsiston me atë se zgjedhjet janë zbatuar në mënyrë efikase, me ç'rast kandidatët kanë mundur lirshëm ta zhvillojnë fushatën. Megjithatë, misionet monitoruese nënvizuan disa mangësi, siç është ekzistimi i votimit grupor, mosrespektimi të instruksioneve të KSHZ nga ana e këshillave zgjedhore, leximi me zë të emrave të votuesve, prezencë të personave të cilët i kanë evidentuar

votuesit para vendeve zgjedhore, si dhe tentativa për të ndikimin e këshillave zgjedhorë mbi votuesit – në cilin proces zgjedhor të marrin pjesë në ditën e zgjedhjes – 27 prill.

Puna e KSHZ-së, nga ana e monitoruesve, u vlerësua si efikase dhe transparente me disa vërejtje sa i përket transparencës së këtij organi. Vëzhguesit e vërejtën ndarjen partiake tek anëtarët e KSHZ-së gjatë miratimit të vendimeve, përkatësisht gjatë votimit në bazë partiake. Raporti i OSBE/ODIHR e nënvizoi komunikimin e dobët të KSHZ-së me komisionet komunale të zgjedhjeve në të dy rrethet zgjedhore, e që ka rezultuar me konfuzione sa u përket procedurave.

Delegacioni i Bashkimit Evropian dhe Ambasada e SHBA-së në Republikën e Maqedonisë dhanë deklaratë të përbashkët me vlerësime dhe komente për zgjedhjet. Deklarata përmban mirënjohje për qytetarët të cilët e shfrytëzuan të drejtën e tyre të votës dhe e përsëritën vlerësimin e OSBE/ODIHR sa i përket efikasitetit të zgjedhjeve, njëanshmërisë mediatike, si dhe bashkimi i shtetit dhe aktiviteteve partiake si mangësi më të mëdha të procesit zgjedhor.

Partitë politike u prononcuan me vlerësime të ndryshme sa i përket zbatimit të procesit zgjedhor. Partia në pushtet VMRO/DPMNE i vlerësoi zgjedhjet si të qeta, të ndershme dhe demokratike. Partia opozitave LSDM u prononcua me akuza për “vjedhje sistematike të votave” dhe publikoi se nuk e njeh legjitimitetin e presidentit të rizgjedhur Gjorge Ivanov. PDSH vlerësoi se presioni mbi votuesit shqiptarë etnik nga ana e BDI-së ka qenë faktori kryesor për daljen e dobët në zgjedhje të elektoratit shqiptar. OPQM zgjedhjet i vlerësoi si “relativisht të ndershme dhe demokratike”, megjithatë shprehu dyshime për ekzistimin e një numri të madh të fletëvotimeve të pavlefshme në rrethin e parë.

Gjorge Ivanov u inaugurua në funksionin e Presidentit më 12 maj të vitit 2014. Në seancën e inaugurimit të tij nuk morën pjesë përfaqësuesit e zgjedhur të partive LSDM, BDI dhe RDK. LSDM dhe RDK publikisht u

prononcuan se nuk i njohin proceset zgjedhore të zgjedhjeve presidenciale dhe zgjedhjeve të parakohshme parlamentare dhe se nuk do t'i pranojnë mandatet e deputetëve të tyre, me çka u bë e sigurt se na paraprinë zbatimi i zgjedhjeve plotësuese të parakohshme parlamentare për plotësimin e vendeve vakante të deputetëve, përkatësisht për mandatet e papranuara të deputetëve. Qëndrimi zyrtar i BDI-së është se zgjedhja e Ivanovit është legale por jo legjitime, meqë nuk e pasqyron vullnetin e shqiptarëve etnik. Në këtë mënyrë mandati i dytë i Gjorge Ivanov në funksionin President i Republikës së Maqedonisë fillon me “mosnjohjen” e tij nga ana e një pjese të subjekteve politike vendore, si dhe në një kohë të krizës së mundshme politike që paraprinë, nëse mospjesëmarrja e një pjese të partive opozitare efektuohet në Parlament.

Në ditët pas zgjedhjeve, zgjedhja e Ivanovit u shënua dhe u përshëndet nga shefat e shteteve dhe qeverive të më shumë vendeve evropiane. Deri te Presidenti i rizgjedhur arritën urime nga presidentët e disa shteteve: Vladimir Putin (nga Federata Ruse), Joachim Gauk (Gjermani), Abdulla Gjyl (Turqi), Janosh Ader (Hungari), Millosh Zeman (Çeki), si dhe nga burrështetas të tjerë. Përgëzime arritën edhe nga presidentët e vendeve të rajonit dhe fqinjëve: Rosen Plevneliev (Bullgari), Borut Pahor (Slloveni), Ivo Josipović (Kroaci), Tomislav Nikolić (Serbi), Filip Vujanović (Mali i Zi) dhe Bakir Izetbegović (BeH). Urime për rizgjedhjen e Ivanovit në emër të Komisionit Evropian dërgoi edhe Kryetari i Komisionit, Hoze Manuel Baroso.





## REFERENCA

## REFERENCA

Ueb-faqja e Komisionit Shtetëror të Zgjedhjeve për Zgjedhjet Presidenciale 1999:

[http://www.sec.mk/arhiva/1999\\_pretsdatelski/](http://www.sec.mk/arhiva/1999_pretsdatelski/)  
(vizita e fundit: 11 shkurt 2014).

Ueb-faqja e Presidentit të Republikës së Maqedonisë:

<http://www.president.gov.mk/>  
(vizita e fundit: 11 shkurt 2014).

Komisioni Shtetëror i Zgjedhjeve. Zgjedhjet Presidenciale 2009. Komunikatë për rezultatet përmblendhëse nga votimi në rrethin e parë. I aksesshëm në:

[http://www.sec.mk/arhiva/2009\\_pretsdatelskiIlokalni/2009/fajlovi/rezultati/konecni/PretsdatelDrzava.pdf](http://www.sec.mk/arhiva/2009_pretsdatelskiIlokalni/2009/fajlovi/rezultati/konecni/PretsdatelDrzava.pdf)  
(pasqyra e fundit më 11 shkurt 2014).

Komisioni Shtetëror i Zgjedhjeve. Zgjedhjet Presidenciale 2009. Komunikatë për rezultatet përmblendhëse zgjedhore nga votimi në rrethin e dytë. I aksesshëm në:

[http://www.sec.mk/arhiva/2009\\_pretsdatelskiIlokalni/2009/fajlovi/rezultati2/konecnipret/Predsdatel\\_konecni.pdf](http://www.sec.mk/arhiva/2009_pretsdatelskiIlokalni/2009/fajlovi/rezultati2/konecnipret/Predsdatel_konecni.pdf)  
(pasqyra e fundit më 11 shkurt 2014).

Ligji për plotësimin e Kodit Zgjedhor, "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 31/2013.

Ligji për zgjedhjen e Presidentit të Republikës së Maqedonisë, "Gazeta Zyrtare e RM"-së nr. 20/94.

Ligji për ndryshimin dhe plotësimin e Kodit Zgjedhor, "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" 142/2012.

Ligji për ndryshimin dhe plotësimin e Kodit Zgjedhor, "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" 14/2014. I aksesshëm në <http://www.pravo.org.mk/documentDetail.php?id=665> (vizita e fundit: 15 shkurt 2014).

Kodi Zgjedhor (tekst i spastruar) "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 32/2014.

Ministria e Financave e Republikës së Maqedonisë, shpenzime buxhetore në periudhën parazgjedhore, i aksesshëm në: <http://www.finance.gov.mk/trosoci> (vizita e fundit: 13 mars 2014).

Ministria e Financave e Republikës së Maqedonisë, Raport financiar parazgjedhor, 17 shkurt 2014, i aksesshëm në: [http://www.finance.gov.mk/files/u12/Predizboren\\_finansiski\\_izvestaj.pdf](http://www.finance.gov.mk/files/u12/Predizboren_finansiski_izvestaj.pdf) (vizita e fundit: 13 mars 2014).

OSBE Zyra për Institucione Demokratike dhe të Drejtat e Njeriut. Republika e Maqedonisë, Zgjedhjet Lokale 24 mars dhe 7 prill 2013, Raporti përfundimtar, Varshavë 9 korrik 2013. I aksesshëm në: <http://www.osce.org/mk/odihr/elections/103832> (vizita e fundit: 15 shkurt 2014).

OSBE Zyra për Institucione Demokratike dhe të Drejtat e Njeriut. Republika e Maqedonisë, Zgjedhjet Presidenciale, 31 tetor dhe 14 nëntor 1999, Raporti përfundimtar. Varshavë, 31 janar 2000. I aksesshëm në: <http://www.osce.org/mk/odihr/elections/fyrom/15910> (vizita e fundit: 11 shkurt 2014).

OSBE Zyra për Institucione Demokratike dhe të Drejtat e Njeriut, Republika e Maqedonisë, Zgjedhjet Presidenciale, 14 dhe 28 prill 2004, Raporti i përfundimtar, Varshavë 13 korrik 2004. I aksesshëm në: <http://www.osce.org/mk/odihr/elections/fyrom/35248> (vizita e fundit: 11 shkurt 2014).

Komisioni Republikan (Shtetëror) i Zgjedhjeve. Raport për zbatimin e zgjedhjes të Presidentit të Republikës së Maqedonisë në vitin 1994. Numër 30-282. 8 nëntor 1994.

Vendim për shpalljen e zgjedhjes së Presidentit të Republikës së Maqedonisë nr. 08-608/1, 1 shkurt 2014 Shkup, i aksesshëm në: [http://www.sec.mk/index.php?option=com\\_content&view=article&id=214:resenie-za-izbor&catid=29&Itemid=1278&lang=mk](http://www.sec.mk/index.php?option=com_content&view=article&id=214:resenie-za-izbor&catid=29&Itemid=1278&lang=mk) (vizita e fundit: 13 mars 2014).

Kalendari i afateve për kryerjen e veprimeve zgjedhore për zbatimin e zgjedhjeve për President të Republikës së Maqedonisë, Komisioni Shtetëror i Zgjedhjeve, 13 prill 2014, i aksesshëm në: <http://sec.mk/images/izbori2014/rokovnik.pdf> (vizita e fundit: 10 mars 2014).

Shënime stenografike nga Seanca e Pestë e Kuvendit të Republikës Socialiste të Maqedonisë, të mbajtur më 27 janar 1991. Shkup, 27 janar 1991. I aksesshëm në: <http://sobranie.mk/WBStorage/Files/05sed27jan91god.pdf> (vizita e fundit: 11 shkurt 2014).

Agjencia për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizive (2014). Raport nga monitorimi i mbulimit mediatik të zgjedhjeve presidenciale dhe zgjedhjeve të parakohshme parlamentare. Shkup, maj. I aksesshëm në: [http://www.avmu.mk/images/Finalen\\_Izvestaj\\_Izbori\\_2014\\_-\\_nacionalni\\_mediumi.pdf](http://www.avmu.mk/images/Finalen_Izvestaj_Izbori_2014_-_nacionalni_mediumi.pdf) (vizituar më 13 maj 2014)

Ambasada e Shteteve të Bashkuara të Amerikës, Shkup, Maqedoni, Komunikatë për media 2014, Deklaratë e përbashkët e Delegacionit të BE-së dhe Ambasadës së SHBA-së, 29 prill 2014. I aksesshëm në: <http://photos.state.gov/libraries/macedonia/8573/ArchivePDFsApril2014/pr04292014mac.pdf> (vizituar më 2 maj 2014)

Asociacioni Qytetar MOST, Deklaratë preliminare-12.30-14.04.2014. I aksesshëm në:  
<http://www.most.org.mk/index.php/mk/ongoing-projects/-2014/307--1230-14042014>  
(vizituar më 14 prill 2014)

Asociacioni Qytetar MOST, Zgjedhje presidenciale dhe zgjedhje të parakohshme parlamentare 2014, Deklaratë preliminare 28.04.2014, Shkup. I aksesshëm në:  
[http://most.org.mk/images/MOST/Preliminarna%20izjava\\_vtor%20krug\\_28%2004%202014\\_MKD.pdf](http://most.org.mk/images/MOST/Preliminarna%20izjava_vtor%20krug_28%2004%202014_MKD.pdf)  
(vizituar më 28 prill 2014)

Dimevski, Jane (2014) Manual për Zgjedhjet Parlamentare në Republikën e Maqedonisë 2014, KAS dhe IDSCS, Shkup, prill  
Komisioni Shtetëror i Zgjedhjeve të Republikës së Maqedonisë  
<http://217.16.84.23/index.php?lang=mk>

Komisioni Shtetëror i Zgjedhjeve, Zgjedhje të Parakohshme Parlamentare dhe Zgjedhje Presidenciale 2014, Zgjedhje Presidenciale - rrethi i parë. I aksesshëm në:  
<http://rezultati.sec.mk/President/Results?cs=mk-MK&r=1&rd=r&eu=All&m=All&ps=All>  
(vizituar më 15 prill 2014)

Komisioni Shtetëror i Zgjedhjeve, Zgjedhje të Parakohshme Parlamentare dhe Zgjedhje Presidenciale 2014, Zgjedhje Presidenciale - rrethi i dytë. I aksesshëm në:  
[http://rezultati.sec.mk/President/Results\\_R2?cs=mk-MK&r=3&rd=r&eu=All&m=All&ps=All](http://rezultati.sec.mk/President/Results_R2?cs=mk-MK&r=3&rd=r&eu=All&m=All&ps=All)  
(vizituar më 29 prill 2014)

Komisioni Shtetëror i Zgjedhjeve, Zgjedhje Presidenciale 2014, Zgjedhje të Parakohshme Parlamentare 2014. I aksesshëm në:

[http://217.16.84.23/files/izbori2014/2\\_tabela\\_akreditirani\\_nabljuduvaci.pdf](http://217.16.84.23/files/izbori2014/2_tabela_akreditirani_nabljuduvaci.pdf) dhe  
[http://217.16.84.23/files/izbori2014/21Tabela\\_na\\_akreditirani\\_nabljuduvaci.pdf](http://217.16.84.23/files/izbori2014/21Tabela_na_akreditirani_nabljuduvaci.pdf)  
(vizituar më 24 prill 2014)

Komisioni Shtetëror i Zgjedhjeve, Zgjedhje Presidenciale 2014, Raporte financiare të kandidatëve për President të Republikës së Maqedonisë. I aksesshëm në:  
[http://217.16.84.23/index.php?option=com\\_content&view=article&id=305:fin\\_izv&catid=29&Itemid=1278&lang=mk](http://217.16.84.23/index.php?option=com_content&view=article&id=305:fin_izv&catid=29&Itemid=1278&lang=mk)  
(vizituar më 27 prill 2014)

Komisioni Shtetëror i Zgjedhjeve, Komunikatë nga Seanca e 78 e Komisionit Shtetëror të Zgjedhjeve. I aksesshëm në:  
<http://217.16.84.23/index.php?limitstart=32&lang=mk>

Gjorge Ivanov, profili Tuitër. I aksesshëm në:  
<https://twitter.com/gjorgeivanov>  
(vizituar më 11 prill 2014)

Gjorge Ivanov, faqja Fejsbuk. I aksesshëm në:  
<https://www.facebook.com/macedonianpresident>  
(vizituar më 11 prill 2014 dhe 27 prill 2014)

Zoran Popovski – Kandidat për President të Republikës së Maqedonisë, faqja Fejsbuk:  
<http://goo.gl/VN2yMa>  
(vizituar më 11 prill 2014)

Zoran Popovski, profili Tuitër:  
<https://twitter.com/popovskiz>  
(vizituar më 11 prill 2014)

Iljaz Halimi, faqja Fejsbuk: Iljaz Halimi Për President,  
<https://www.facebook.com/iljazhalimiofficial>  
(vizituar më 11 prill 2014)

Ministria e Punëve të Brendshme e Republikës së Maqedonisë, 25.04.2014  
Shtabi Operativ pranë MPB-së për nevojat e zgjedhjeve, Në krahasim me ciklet paraprak zgjedhor deri më tani me numër më të vogël të incidenteve dhe prishjes së RQP:

<http://www.mvr.gov.mk/ShowAnnouncements.aspx?ItemID=13451&mid=1367&tabId=358&tabindex=0>  
(vizituar më 25 prill 2014)

OSBE/ODIHR, Misioni Vëzhgues Ndërkombëtar për Zgjedhjet në Republikën e Maqedonisë, Zgjedhje Presidenciale 13 prill 2014. (2014) Deklaratë për të dhënat preliminare dhe konkluzione. Shkup, prill, i aksesshëm në:  
<http://www.osce.org/mk/odihr/elections/117647?download=true>  
(vizituar më 13 maj 2014)

OSBE/ODIHR, Misioni Vëzhgues Ndërkombëtar për zgjedhjet në Republikën e Maqedonisë, Zgjedhje Presidenciale dhe Zgjedhje të Parakohshme Parlamentare 27 prill 2014. (2014) Deklaratë për të dhënat preliminare dhe konkluzione. Shkup, prill, i aksesshëm në:  
<http://www.osce.org/mk/odihr/elections/fyrom/118079?download=true>  
(vizituar më 13 maj 2014)

Stevo Pendarovski, profili Tuitur:  
<https://twitter.com/SPendarovski>  
(vizituar më 27 prill 2014)

Stevo Pendarovski, faqja Fejsbuk:  
<https://www.facebook.com/SPendarovski>  
(vizituar më 11 prill 2014 dhe 27 prill 2014)

## MEDIA

Gjithsej 63.253 nënshkrime për Ivanov-in, "Telegraf", 04.03.2014, i aksesshëm në:  
<http://www.telegraf.mk/aktuelno/114187-vkupno-63-253-potpisi-za-ivanov>  
(vizita e fundit: 04 mars 2014).

VMRO-DPMNE shkon në zgjedhje të parakohshme parlamentare, "Radio Evropa e Lirë" në gjuhën maqedonase, 01.03.2014, i aksesshëm në:  
<http://www.makdenes.org/archive/news/20140301/428/428.html?id=25281463>  
(vizita e fundit: 10 mars 2014).

PDSH e mblodhi numrin e nevojshëm të nënshkrime për Iljaz Halimin, TV "Telma", 01.03.2014, i aksesshëm në:  
<http://telma.com.mk/index.php?task=content&cat=1&rub=15&item=35438>  
(vizita e fundit: 10 mars 2014).

BDI decid: President konsesual i shtetit, "24 Vesti", 09.01.2014, i aksesshëm në:  
<http://24vesti.mk/dui-decidni-konsenzualen-pretседател-na-drzhavata>  
(vizita e fundit: 10 mars 2014).

BDI paraqiti propozim për zgjedhje të parakohshme, "Dojçe Vele" servisi në gjuhën maqedonase, 01.03.2014, i aksesshëm në:  
<http://www.dw.de/%D0%B4%D1%83%D0%B8-%D0%BF%D0%BE%D0%B4%D0%BD%D0%B5%D1%81%D0%B5-%D0%BF%D1%80%D0%B5%D0%B4%D0%BB%D0%BE%D0%B3-%D0%B7%D0%B0-%D0%BF%D1%80%D0%B5%D0%B4%D0%B2%D1%80%D0%B5%D0%BC%D0%B5%D0%BD%D0%B8-%D0%B8%D0%B7%D0%B1%D0%BE%D1%80%D0%B8/a-17466769>  
(vizita e fundit: 10 mars 2014).

Gjorge Ivanov zgjidhet kandidat për President të Republikës së Maqedonisë nga VMRO-DPMNE, Ueb-faqja e VMRO-DPMNE-së, 01.03.2014, i aksesshëm në:

<http://vmro-dpmne.org.mk/?p=21701>

(vizita e fundit 13 mars 2014).

Iljaz Halimi kandidat për President i PDSH-së, TV "Alfa", 26.02.2014, i aksesshëm në:

<http://www.alfa.mk/News.aspx?ID=72039#.UxXuTM51DiA>

(vizita e fundit: 10 mars 2014).

Pendarovski zyrtarisht kandidat presidencial i LSDM-së, "Dojçe Vele" servisi në gjuhën maqedonase, 05.03.2014, i aksesshëm në:

<http://www.dw.de/%D0%BF%D0%B5%D0%BD%D0%B4%D0%B0%D1%80%D0%BE%D0%B2%D1%81%D0%BA%D0%B8-%D0%BE%D1%84%D0%B8%D1%86%D0%B8%D1%98%D0%B0%D0%BB%D0%BD%D0%BE-%D0%BF%D1%80%D0%B5%D1%82%D1%81%D0%B5%D0%B4%D0%B0%D1%82%D0%B5%D0%BB%D1%81%D0%BA%D0%B8-%D0%BA%D0%B0%D0%BD%D0%B4%D0%B8%D0%B4%D0%B0%D1%82-%D0%BD%D0%B0-%D1%81%D0%B4%D1%81%D0%BC/a-17476530>

(vizita e fundit: 10.03.2014).

Janë mbledhur 10.000 nënshkrime për kandidaturën e Zoran Popovski-t, TV "Telma", 17.02.2014, i aksesshëm në:

<http://www.telma.com.mk/index.php?task=content&cat=1&rub=15&item=35041>

(vizita e fundit: 10 mars 2014).

VMRO-DPMNE: "Fituan qytetarët, patëm zgjedhje të qeta dhe të ndershme". "Dnevnik", 27 prill 2014. I aksesshëm në:

<http://www.dnevnik.mk/default.asp?ItemID=FCA9C798EE508648B7BAE3B60B977D83>

(vizituar më 5 maj 2014)

OPQM: Zgjedhje relativisht të ndershme dhe demokratike. TV Alfa, 13 prill 2014,

<http://www.alfa.mk/News.aspx?ID=74995#.U2oJD1cj7To>

(vizituar më 7 maj 2014)

OPQM: Njollë e zgjedhjeve janë fletëvotimet e pavlefshme. Lokalno.mk., 14.04.2014,

<http://lokalno.mk/grom-damka-na-izborite-se-nevazhechkite-livchinja/>

(vizituar më 7 maj 2014)

Gruevski: Popullit tregoi se çfarë vlerash mbështet. TVM1, 13 prill 2014,

<http://www.mrt.com.mk/node/7544>

(vizituar më 7 maj 2014)

Gruevski dhe Ivanov: Fitues më i madh është Maqedonia. TV Nova, 28 prill 2014,

<http://novatv.mk/index.php?navig=8&cat=23&vest=13677>

(vizituar më 7 maj 2014)

Pranë KSHZ-së nuk janë paraqitur kundërshtime për rrethin e parë të zgjedhjeve. Radio Evropa e Lirë në gjuhën maqedonase, 16 prill 2014,

<http://www.makdenes.org/content/news/25351553.html>

(vizituar më 7 maj 2014);

Ivanov edhe zyrtarisht e mori mandatin e dytë Presidencial. TVM1, 30 prill 2014, <http://www.mrt.com.mk/node/8362>

(vizituar më 7 maj 2014)

PDSH: Vazhdojmë me aktivitetet për fitore në zgjedhjet parlamentare. TVM1, 14 prill 2014,

<http://www.mrt.com.mk/node/7569>

(vizituar më 7 maj 2014)

Zaev:Nuk e njohim procesin zgjedhor, qeveri teknike për zgjedhje të ndershme. Konferencë për shtyp, 27 prill 2014, i aksesshëm në ueb-



faqen e LSDM: <http://sdsm.org.mk/default.aspx?mId=55&agId=5&articleId=10576>  
(vizituar më 5 maj 2014)

Zaev:Ky nuk është vullneti i popullit, këtë do ta kuptojnë më 27 prill. Deklaratë, 13 prill 2014, i aksesshëm në ueb-faqen e LSDM: <http://sdsm.org.mk/default.aspx?mId=55&agId=5&articleId=10456>  
(vizituar më 7 maj 2014)

Ivanov: Maqedonia është fituesi më i madh. Ueb-faqja e Gjorge Ivanov për zgjedhjet, 14 prill 2014: <http://ivanov.mk/web/?p=949>  
(vizituar më 7 maj 2014)

Ivanov: Në këto zgjedhje fitoi demokracia, qytetarët, Maqedonia Ueb-faqja e Gjorge Ivanov, 28 prill 2014: <http://ivanov.mk/web/?p=1326>  
(vizituar më 5 maj 2014)

Pendarovski: Lufta nuk ka përfunduar. Deklaratë për media, 13 prill 2014, i aksesshëm në ueb-faqen e LSDM: <http://sdsm.org.mk/default.aspx?mId=55&agId=5&articleId=10455>  
(vizituar më 7 maj 2014)

Pendarovski:Synoj që pa reterime ta mbroj konceptit për një Maqedoni të lirë. Konferencë për shtyp, 28 prill 2014, i aksesshëm në ueb-faqen e LSDM: <http://sdsm.org.mk/default.aspx?mId=55&agId=5&articleId=10580>  
(vizituar më 5 maj 2014)

Popovski:OPQM tregoi se është faktor në skenën politike. Radio Evropa e Lirë në gjuhën maqedonase, 13 prill 2014, <http://www.makdenes.org/archive/news/20140413/428/428.html?id=25331803>  
(vizituar më 7 maj 2014)

Radio Evropa e Lirë, OSBE – Zgjedhje të zhvilluara në mënyrë efikase, por problemet mbeten, e mërkurë 30 prill 2014 <http://www.makdenes.org/content/article/25365682.html>  
(vizituar më 28 prill 2014)

LSDM nuk e njeh Gjorge Ivanov për President të Republikës së Maqedonisë. Komunikatë për publikun, 2 maj 2014, i aksesshëm në ueb-faqen e LSDM: <http://sdsm.org.mk/default.aspx?mId=55&agId=2&articleId=10589>  
(vizituar më 5 maj 2014)

Thaçi:Zero dalje në disa vende është pasqyrë e diktaturës. Utrinski vesnik, 13 prill 2014, <http://www.utrinski.mk/default.asp?ItemID=A18BD7D10D49B6458CE36841CBFE657B>  
(vizituar më 7 maj 2014)

Përgëzime nga OPQM për Ivanovin dhe Pendarovskin. TV Sitel, 13 prill 2014, <http://www.sitel.com.mk/mk/chestitki-od-grom-za-ivanov-i-pendarovski>  
(vizituar më 7 maj 2014)



## **Fondacioni Konrad Adenauer**

### **Zyra në Maqedoni**

rr. "Maksim Gorki" 16 / kati i 3  
MK – Shkup

Tel: +389 2 323-1122  
Faks: +389 2 313-5290  
E-mail: Skopje@kas.de

[www.kas.de/macedonia](http://www.kas.de/macedonia)  
[www.idscs.org.mk](http://www.idscs.org.mk)